LIBRI I ABSTRAKTEVE

KONGRESI I I-RË KOMBËTAR I MAMIVE

# “Mamia si figurë thelbësore e kujdesit shëndetësor në Shqipëri: Inovacioni dhe lidershipi për shëndetin e nënës dhe të fëmijës”

TIRANË SHQIPËRI

5 MAJ, 2025

Hotel Tirana International

URDHËRI I INFERMIERËVE TË SHQIPËRISË

# ABSTRACT BOOK

## 1st NATIONAL CONGRESS OF MIDWIVES

## "Midwifery as an essential figure of health care in Albania: Innovation and leadership for mother and child health"

**TIRANA, ALBANIA**

**MAY 5, 2025**

**Hotel Tirana International**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

CIP Katalogimi në botim BK

Tiranë Urdhri i Infermierit i

Shqipërisë
Mamia si figurë thelbësore e kujdesit shëndetësor në Shqipëri : inovacioni dhe lidershipi për shëndetin e nënës dhe të fëmijës : Kongresi i I-rë Kombëtar i Mamive : Tiranë, Shqipëri, 5 maj, 2025 : libri i abstrakteve = Midwifery as an essential figure of health care in Albania : innovation and leadership for mother and child health : 1 st National Congress of Midwives : Tirana, Albania May 5, 2025 : abstract book / Urdhëri i Infermierëve të Shqipërisë . - Elbasan : PENK Print, 2025.
... f. ; ... cm.
ISBN 9789928485120
1.Infermieria 2.Kujdesi

mjekësor 616 -083

BKSH

Adresa: Sheshi Skenderbej, Tirane
Tel. +355 422 238 43/+355422 57 670
www.bksh.al

# PËRMBAJTJA

Rreth UISH ........ 7
Informacione të përgjithshme rreth Kongresit ........ 8
Fjala Përshëndetëse ........ 9
Komiteti shkencor ........ 10
Komiteti Organizativ ........ 11
Programi i Kongresit ........ 15
Sesioni 1 ........ 16
Sesioni 2 ........ 19
Sesioni 3 ........ 21
Ndikimi i burimeve spitalore dhe disponueshmëria e mbështetjes profesionale të laktacionit në Kliniken e Neonatologjise: Rezultatet e anketave të ushqyerjes me gji 2023-2024 ........ 24
Nexhmije Gori[1]
Studim mbi zbatimin e protokollit të ndjekjes së të porsalindurit, barrierat në implementimin e tij ...... 27
Zamira Çabiri[1], Shkëlqim Hidri, Gazment Koduzi, Rustem Celami, Jonila Cela, Ilda Taka, Elona Dybeli, Florenc Piligriu
Kujdesi infermieror në hipoterminë neonatale në maternitetin e Elbasanit për periudhën Janar-Dhjetor 2022- 2023 ........ 29
Shqipe Luta[1] , Albana Sula[1], Rajmonda Hida[1], Elona Dybeli[1], Juxhin Luta[2], Esmeralda Vreto [2]
Përmirësimi i kurrikulave dhe përcaktimi i standardeve të praktikës profesionale për të rritur vetëbesimin dhe kompetencën te studentët e programit të studimit mami ........ 31
Elena Drenesku[1], Emisa Velo[1], Stela Muça[2], Delantina Mulla[3]
Rëndësia dhe përshtatja e protokolleve sipas nevojave dhe evidencave më të mira për kujdes adekuat të gruas ........ 33
Albana Poloska[1], Risida Gjonej[1], Blerina Duka[2]
Menaxhimi infermieror i problemeve të shëndetit mendor te prinderit pas lindjes së foshnjës së tyre .35
Gentjana Shembitraku[1]
Roli i mamive në parandalimin dhe menaxhimin e fibromiomave uterine: qasje të reja dhe praktika klinike ........ 37
Emisa Velo[1], Elena Drenesku[2], Delantina Mulla[3], Stela Muça[4]
Ndikimi i suplementeve në jetën e një gruaje fertile me PCOS. Studim rasti ........ 39
Lejdi Fetahu[1], Bruna Subashi[2], Erlini Kokalla[3]
Kujdesi infermieror për fëmijët e lindur parakohe në njësinë intensive ........ 41
Afërdita lahu [1] , Çlirim Lahu [1] , Lirie Hasani [2]
Roli i mamive në promovimin e inovacionit në kujdesin shëndetësor për nënat dhe fëmijët ........ 43
Besarta Pelaj[1], Dijana Beqa[2] , Fatime Zeneli [3], Kumrije Emra [4]

Sfidat e ushqyerjes me gji sot. Mbështetja dhe edukimi nga profesionistët e shëndetësisë .................. 45
Anjeza Kolaneci[1]
Menaxhimi i lindjeve emergjente në kujdesin paraspitalor: Një analizë praktike dhe strategji ndërhyrjeje ..................... 47
Indrit Jaupaj[1] , Skënder Brataj[2]
Kujdesi i personelit infermieror në reanimacion për gruan shtatzëne ..................... 49
Eugen Ismolli[1]
Infeksionet e lidhura me kujdesin shëndetësor në njësine e kujdesit intensiv neonatal: Një rishikim i shpejtë sistematik i literaturës ..................... 51
Behrije Halilaj-Vishi [1], Imri Vishi [1], Minire Alilaj-Beqiraj [2]
Perceptimi i mamive mbi rolin e tyre në kujdesin shëndetësor..................... 53
Fatime Zeneli[1], Besarta Pelaj[2]
Vlerësimi infermieror i simptomave menopauzale, praktikave të vetëkujdesit dhe ndikimi i tyre në produktivitetin në punë të grave në rrethin e Vlorës ..................... 55
Entela Haxhillari[1]
Rëndësia e depistimit të hershëm të HPV për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe përmirësimin e shëndetit publik. Studim në rrethin e Korçës ..................... 57
Mimoza Isufi[1], Delantina Mulla[2]
Roli dhe përgjegjësitë e infermieres në vaksinimin e fëmijeve..................... 59
Babeta Rexhepi [1]
Shkaqet amtare dhe prevenimi i komplikacioneve neonatale ne pacientet me Iugr ..................... 61
Florentina Idrizaj[1]
Studimi mbi ecurinë e metroragjisë në spitalin e Korcës, në 5 vitet e fundit..................... 63
Delantina Mulla[1]
Rezonanca magnetike gjatë shtatzanisë ..................... 65
Alket Çollaku [1], Elona Dybeli [2]
Roli i infermiereve në promovimin e ushqyerjes me gji pas daljes nga materniteti. Rëndesia e ushqyerjes me gji dhe ndikimi..................... 67
Emrije Gjata[1]
Shtazania ektopike-Menaxhimi dhe Kujdesi ..................... 69
Mirela Xherri[1], Miranda Azisllari[1], Sidorela Gega[1], Malvina Muca[1]
Sindromi i preeklampsisë ..................... 71
Andia Pelari[1]
Menaxhimi i hemorragjisë postpartum dhe roli i mamive ..................... 73
Aida Abdurrahmani[1]
Komplikacionet obstetrike gjatë tremujorit të tretë të shtatzanisë – Një këndvështrim ndërkombëtar 75
Eljo Paja[1], Elca Noni[2]

Roli i mamisë në sallën operatore në obstetrikë – gjinekologji. Detyrat dhe përgjegjësitë .................... 77
Rigerta Janaqi[1] , Anjeza Kolaneci [1]
Kujdesi infemieror në trajtimin e depresionit post-partum ................................................................ 79
Ledia Shorja[1]
Faktorët e riskut për komplikime të astmës në shtatzani..................................................................... 81
Brikena Duka[1], Behije Gollobërda[1], Elona Dybeli[1], Andja Lala[1]
Hipertensioni – patologjia më e përhapur në shtatëzani ..................................................................... 83
Fasela Ibrahimi[1]
Monitorimi i gruas shtatzënë dhe përgatitja e gruas për procesin e lindjes. ......................................... 85
Eglantina Cufaj[1]
Njohuritë, vlerësimi dhe niveli i burnout te infermieret- mami në spitalin rajonal Shkodër ................ 87
Silvana Belisha[1], Valbona Dibra[2], Elsiona Qallia[3], Vera Gjinaj[4], Arta Zogu[5]
Roli i mamive në promovimin e një stili jetese të shëndetshme gjatë shtatzanisë në Shqipëri............. 89
Shpresa Molla[1]
Rëndësia e ushqyerjes me gji, përfitimet shëndetësore dhe sfidat e zbatimit në Shqipëri ..................... 91
Anila Janeva[1]
Ndikimi i burimeve spitalore dhe disponueshmeria e mbështetjes profesionale të epiziotomisë në maternitetin e Durrësit. Rezultatet e sondazheve të epiziotomisë 2024-2025....................................... 93
Sidorela Hasani Fezga[1]
Raporti midis obezitetit dhe shëndetit riprodhues femëror ................................................................. 95
Ivia Elezi[1]
Ikteri i të porsalindurit ......................................................................................................................... 97
Abla Çuko[1], Mirela Meta[2], Elisabeta Rista[3]
Vlerësimi i barrierave me të cilat përballen mamitë në ofrimin e kujdesit pre dhe postnatal ................ 99
Eglantina Haxhiaj[1]
Kujdesi i plagëve post-operatore pas lindjes ....................................................................................... 101
Elvira Qosja [1], Adrian Beti [2]
Roli i mamive në edukimin e grave për një ushqyerje të shëndetshme gjatë shtatzanisë .................... 103
Alma Imami – Lelçaj[1], Alketa Dervishi[2], Miranda Çela[3]
Njohja e figurës profesionale të mamisë në Republikën e Shqipërisë ................................................ 105
Blerina Duka[1]
Karcinoma mamare: Një shqyrtimi literaturës dhe case report. ......................................................... 107
File Bracja[1], Luiza Lushi[2], Svetllana Bitincka [3]
Menaxhimi i ushqyerjes oro/nazogastrike te neonati prematur në kujdesin intensiv........................... 109
Arjona Rakipi[1], Blerina Duka[2]

Lindja natyrale dhe avantazhet e saj për nënën dhe fëmijën ........................................................... 111
Nina Nasafuga[1]
Roli i mamive në trajtimin e urgjencave menjëherë pas lindjes........................................................ 113
Fjorida Senja[1]
Roli i mamive në promovimin e vaksinimit të grave shtatzanë dhe foshnjave: Një rishikim literature i bazuar në evidenca ............................................................................................................. 115
Anduela Vaso[1] , Ediona Kola[2]
Roli i kujdesit të mamive në mbështetje të ushqyerjes me gji pas lindjes ......................................... 117
Arjeta Bajraktari[1]
Menaxhimi dhe trajtimi i anafilaksisë/shokut anafilaktik në gruan shtatzënë .................................... 119
Elisabeta Rista[1], Shpresa Molla[1], Delantina Mulla[1], Shpresa Bici[1]
Vlerësimi i njohurive për Ist-të tek studentët e fakultetit të shëndetit publik (FSHP) dhe fakultetit të shkencave humane (FSHH)................................................................................................... 121
Majlinda Rakipaj[1], Rudina Çerçizaj[2], Ferolinda Kodheli, Emirjona Kiçaj[4], Neada Çakërri[5], Deona Taraj[6], Entela Haxhillari[7]
Monitorizimi fetal i ritmit kardiak: Interpretimi grafik i kardiotokografisë (Ctg).............................. 123
Vangjeli Lice[1], Blerina Bracellari[2]
Fizioterapia mbeshtet mamitë ne edukimin dhe monitorimin e shtatzënise problematike ................. 125
Fatjon Hajdari [1], Lorenc Çili [2]
Vlerësimi fillestar i neonatit .................................................................................................. 127
Joniada Kalthi[1]
Gabimet në proçedurat infermierore ........................................................................................ 129
Vjollca Qatipi[1], Gentjana Shembitraku[1]
Evolucioni i rolit të mamisë në kujdesin gjatë shtatëzanisë: Risitë globale dhe aplikimi i tyre në Shqipëri për një shtatëzani më të shëndetshme dhe të sigurtë ......................................................... 131
Marinela Sema[1], Ester Hoti[2]
Roli infermieror në teknologjinë e riprodhimit të asistuar .............................................................. 133
Valbona Lici [1], Denisa Koçi [1]
Abdominoplastika pas lindjes cezariane: Përvoja e pacientëve dhe roli i infermierëve në rikuperim. 135
Mario Golemi[1] , Enis Zorba[2]
Roli i ekografisë gjatë ndjekjes së shtatzanisë ........................................................................... 137
Elona Dybeli [1], Alket Çollaku [2], Rudina Deliallisi [3], Armela Kapaj[1], Albana Sula [1], Brikena Duka [1]
Rëndësia e kujdesit parësor antenatal në parandalimin e komplikimeve të shtatzënisë......................138
Rinora Fetahu[1]
Falenderime.......................................................................................................................... 140

# Rreth UISH

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë (UISH) është Ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve: infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laboratori, teknik/e imazherie, logopedist/e si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut, është i pavarur, profesional, i depolitizuar, i hapur për të gjithë anëtarët, pavarësisht nga përkatësitë e tyre racore, etnike, fetare apo politike.

**Vizioni i UISH:**

**Mbështet, investon** për të udhëhequr profesionet e kujdesit shëndetësor, duke ofruar shëndet për të gjithë.

**Impakti Global** - Siguron ekspertizë, në mënyrë aktive dhe të rregullt, në nivele të larta globale ose rajonale shëndetësore, arsimore, sociale, rregullore.

**Fuqizimi i anëtarësisë** – në tre shtylla:

- Praktika Profesionale;
- Edukimi në Vazhdim;
- Kodi Etik.

**Lidershipi strategjik** - Siguron udhëheqje strategjike për të avancuar profesionet e kujdesit për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme të popullatës, sistemeve shëndetësore si dhe për të adresuar sfidat në nivel vendor dhe kombëtar.

**Rritja innovative** - Identifikon, siguron dhe zgjeron kompetencat duke rritur të ardhurat nga gjenerimi i mundësive, në përputhje me vlerat tona, për të arritur qëllimet e UISH-së.

**Website**: https://urdhriinfermierit.org/

# Informacione të përgjithshme rreth Kongresit

**KONGRESI I I-RË KOMBËTAR I MAMIVE**, i organizuar nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë (UISH), do të zhvillohet më 5 Maj 2025, në Tiranë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Mamive.

**ARSYET PËR TË MARRË PJESË:**

Ky kongres do të jetë një ngjarje madhore profesionale dhe shkencore, që synon të nxjerrë në pah rolin qendror të mamive në sistemin shëndetësor shqiptar, duke vënë theksin në inovacionin, lidershipin dhe përkushtimin për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Me temën qëndrore:

**"MAMIA SI FIGURË THELBËSORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI: INOVACIONI DHE LIDERSHIPI PËR SHËNDETIN E NËNËS DHE TË FËMIJËS"**

Ky Kongres synon të krijojë një platformë për diskutim profesional dhe shkëmbim përvojash midis mamive, profesionistëve të tjerë të shëndetit, akademikëve dhe politikëbërësve nga Shqipëria.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të ndajnë rezultatet e kërkimeve të tyre shkencore dhe praktikat më të mira në fushat e kujdesit obstetrik, neonatologjisë, edukimit shëndetësor, lidershipit profesional, digjitalizimit të shërbimeve, dhe më gjërë. Po ashtu, do të trajtohen edhe aspektet etike, puna ndërdisiplinare dhe sfidat aktuale të profesionit të mamisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ky aktivitet do të shërbejë si një tryezë e hapur bashkëpunimi dhe ndërveprimi profesional, ku do të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve akademike dhe shëndetësore nga e gjithë Shqipëria.

Përmes prezantimeve orale dhe poster, do të mundësohet shkëmbimi i njohurive dhe përvojave konkrete të praktikës klinike, me qëllim fuqizimin e rolit të mamisë dhe avancimin e standardeve të kujdesit shëndetësor për gratë dhe fëmijët.

Ky Kongres do të theksojë gjithashtu unitetin, solidaritetin, përkushtimin profesional dhe rolin vendimtar të mamisë si një figurë kyçe për të ardhmen e shëndetit publik në Shqipëri.

## Pikat Kyçe që do të Diskutohen :

- Roli qendror i mamisë në sistemin shëndetësor shqiptar
- Inovacioni në praktikat obstetrike dhe të kujdesit për nënën dhe fëmijën
- Lidershipi i mamive në kujdesin shëndetësor
- Edukimi shëndetësor dhe roli i mamisë në promovimin e shëndetit
- Praktikat më të mira në kujdesin obstetrik dhe neonatologji
- Digjitalizimi i shërbimeve të kujdesit mjekësor
- Etika profesionale në praktikën e mamisë
- Bashkëpunimi ndërdisiplinar në kujdesin për nënën dhe fëmijën
- Sfidat aktuale të profesionit të mamisë në Shqipëri dhe në nivel ndërkombëtar
- Roli i mamisë në politikëbërjen shëndetësore dhe zhvillimin e standardeve të reja

# Fjala përshëndetëse



Të nderuar kolegë,

Kam nderin dhe kënaqësinë t'ju ftoj në **Kongresin e Mamive të Shqipërisë**, i cili do të mbahet më **5 Maj 2025**, në **Hotel Tirana International**. Ky event do të bashkojë mamitë dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor nga Shqipëria dhe më gjerë për të ndarë njohuritë, shkëmbyer eksperienca, për të eksploruar praktika inovative dhe për të krijuar një rrjet më të gjërë profesionistësh të cilët punojnë për të njëjtin qëllim: ofrimin e një kujdesi shëndetësor cilësor ndaj foshnjeve dhe nënave.

Në Shqipëri, mamitë luajnë një rol thelbësor në ofrimin e kujdesit të plotë, të përqendruar te gruaja, nga mbështetja para lindjes, në lindje dhe pas lindjes. Angazhimi ynë për praktika holistike dhe të bazuara në evidenca siguron që nënat të marrin një kujdes cilësor, falë zhvillimit profesional të figurisë së mamive në vendin tonë dhe t'i përshtasin me praktikat dhe protokollet më të mira ndërkombëtare.

Përmes sesioneve të ndryshme, diskutimeve dhe punimeve shkencore, do të trajtohen tema kyçe mbi shëndetin riprodhues, mirëqenien e nënave dhe zhvillimet më të fundit në fushën e mamive. Ky Kongres përbën gjithashtu një event të diversitetit, fuqizimit dhe rritjes profesionale. Duke përqafuar perspektiva të ndryshme dhe duke mësuar nga njëri-tjetri, ne do të vazhdojmë të përparojmë në misionin tonë të përbashkët për të përmirësuar kujdesin për nënat dhe të porsalindurit.

Ju ftojmë me kënaqësi të na bashkoheni në Tiranë për një event frymëzues dhe të pasur me njohuri. Le të bashkohemi për të formësuar më tej të ardhmen e mamive në Shqipëri!

*Me respekt,*

*Blerina Duka*

*President i Urdhrit të Infermierëve të Shqipërisë*

# KOMITETI SHKENCOR

Blerina Duka

Nexhmie Gori

Albana Poloska

Arjona Rakipi

Vjollca Qatpi

Anjeza Kolaneci

Besarta Pelaj

Emisa Velo

Elena Drenesku

Silvana Belisha

Alma Imami Lelçaj

Joniada Kalthi

# KOMITETI ORGANIZATIV

**Blerina Duka**

Presidente – Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

**Xhemajl Dugolli**

Oda e Infermierëve Kosovë

**Lutfi Lami**

Zv. President - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

**Arjona Rakipi**

Specialiste Edukimit në Vazhdim - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

**Elona Dybeli**

Pedagoge - Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan

**Shkëlqim Zeqiri**

President - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Vlorë

**Shpresa Molla**

Presidente - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Lezhë

**Shpresa Bici**

Presidente - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Dibër

**Elisabeta Rista**

Presidente - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Fier

**Alion Sejdini**

President - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Elbasan

**Delantina Mulla**

Presidente - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Korçë

**Anduela Vaso**

Presidente - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Tiranë

**Artan Molla**

President - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Shkodër

**Ermioni Dabaj**

Presidente - Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Durrës

# SCIENTIFIC COMMITTEE

Blerina Duka
Nexhmie Gori
Albana Poloska
Arjona Rakipi
Vjollca Qatpi
Anjeza Kolaneci
Besarta Pelaj
Emisa Velo
Elena Drenesku
Silvana Belisha
Alma Imami Lelçaj
Joniada Kalthi

# ORGANISING COMMITTEE

**Blerina Duka**

President of the Order of Albanian Nurses

**Xhemajl Dugolli**

Kosovo Chamber of Nurses

**Lutfi Lami**

Vice President of the Order of Albanian Nurses

**Arjona Rakipi**

Continuing Education Specialist of the Order of Albanian Nurses

**Elona Dybeli**

Pedagogue “Aleksandër Xhuvani” University of Elbasan

**Shkelqim Zeqiri**

President of Vlorë Region of the Order of Albanian Nurses

**Shpresa Molla**

President of Lezhë District, Order of the Albanian Nurse

**Shpresa Bici**

President of Dibër District, Order of the Albanian Nurse

**Elisabeta Rista**

President of Fier District, Order of the Albanian Nurse

**Alion Sejdini**

President of Elbasan District, Order of the Albanian Nurse

**Delantina Mulla**

President of Korçë District, Order of the Albanian Nurse

**Anduela Vaso**

President of Tirana District, Order of the Albanian Nurse

**Artan Molla**

President of Shkodër District, Order of the Albanian Nurse

**Ermioni Dabaj**

President of Durrës District, Order of the Albanian Nurse

# KONGRESI I I-$^{RË}$ KOMBËTAR I MAMIVE

***"Mamia si Figurë Thelbësore e Kujdesit Shëndetësor në Shqipëri: Inovacioni dhe Lidershipi për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës"***

# PROGRAMI

**Vëndi:** **Hotel Tirana International , Tiranë Shqipëri**

**Data:** **5 MAJ, 2025**

# PROGRAMI I KONGRESIT

DATA 05 Maj 2025

Hotel Tirana Internacional, Tiranë

| SALLA BALSHA | |
|---|---|
| **Ora** | |
| **08:30- 09:30** | **REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE**<br><br>SALLA BALSHA - 100 Pjesëmarrës<br>SALLA ABRET - 100 Pjesëmarrës<br>SALLA ONUFER -100 Pjesëmarrës |
| **09:30-10:00** | **HAPJA E KONGRESIT**<br>**Video : "Mamia në Shqipëri :Dritë për Jetën"** |
| | Fjala e mirëseardhjes nga Presidenti i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë ***znj. Blerina Duka*** |
| | Fjala përshëndetëse e Presidentes së Odës së Infermierëve të Kosovës ***znj. Nexhmije Gori*** |
| | Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Spitalit Universitar "Koço Glozheni" ***z. Genci Hyska*** |
| | Fjala përshëndetëse e Drjtueses së Departamentit të Kujdesit Shëndetësor ***znj. Rezarta Lalo*** |
| | Fjala përshëndetëse e Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ***znj. Albana Koçiu*** |
| | **PUSHIM KAFE NE HOLL** |

| SESIONI 1 | MAMI SALLA : BALSHA |
|---|---|
| *Moderatorë : **Juljana Xhindoli , Albana Poloska , Delantina Mulla*** | |
| **ORA**<br><br>**SESION PARALEL 1** | **TEMA** |
| **10:00-10:20** | "Ndikimi i burimeve spitalore dhe disponueshmëria e mbështetjes profesionale të laktacionit në Kliniken e Neonatologjise: Rezultatet e anketave të ushqyerjes me gji 2023-2024"<br>**Nexhmije Gori** |
| **10:20-10:40** | "Studim mbi zbatimin e protokollit te ndjekjes se te porsalindurit, barrierat ne implementimin e tij"<br>**Zamira Çabiri** |
| **10:40-11:00** | "Kujdesi infermieror ne hipotermine neonatale ne maternitetin e Elbasanit për periudhën Janar-Dhjetor 2022- 2023"<br>**Shqipe Luta** |
| **11:00-11:20** | "Përmirësimi i kurrikulave dhe përcaktimi i standardeve të praktikës profesionale për të rritur vetëbesimin dhe kompetencën tek studentët e programit të studimit mami"<br>**Elena Drenesku** |
| **11:20-11:40** | "Rëndësia dhe përshtatja e prrotokolleve sipas nevojave dhe evidencave më të mira për kujdes adekuat të gruas"<br>**Albana Poloska** |
| **11:40-12:00** | "Menaxhimi infermierorë i problemeve të shëndetit mendor tek prinderit pas lindjes së foshnjës së tyre"<br>**Gentjana Shembitraku** |
| **12:00-12:15** | "Roli i mamive në parandalimin dhe menaxhimin e fibromiomave uterine: qasje të reja dhe praktika klinike"<br>**Emisa Velo** |
| **12:15-12:30** | "Ndikimi i suplementeve në jetën e një gruaje fertile me pcos. Studim rasti"<br>**Lejdi Fetahu** |

| | |
|---|---|
| **12:30-12:45** | "Kujdesi infermieror për fëmijët e lindur parakohe në njësinë intensivë"<br>**Afërdita Lahu** |
| **12:45-13:00** | **"**Roli i Mamive në Promovimin e Inovacionit në Kujdesin Shëndetësor për Nënat dhe Fëmijët**"**<br>**Besarta Pelaj** |
| **13:00-14:00** | **PUSHIM DREKE** |
| *Moderatorë : **Nexhmije Gori , Anjeza Kolaneci , Delantina Mulla*** | |
| **14:00-14:15** | "Sfidat e ushqyerjes me gji sot! Mbështetja dhe edukimi nga profesionistët e shëndetësisë"<br>**Anjeza Kolaneci** |
| **14:15-14:30** | "Menaxhimi i Lindjeve Emergjente në Kujdesin Paraspitalor: Një Analizë Praktike dhe Strategji Ndërhyrjeje"<br>**Indrit Jaupaj** |
| **14:30-14:45** | "Kujdesi i personelit infermieror ne reanimacion i gruas shtatzane"<br>**Eugen Ismolli** |
| **14:45-15:00** | "Infeksionet e lidhura me kujdesin shëndetësor në njësine e kujdesit intenziv neonatal: Një rishikim i shpejtë sistematik i literaturës"<br>**Behrije Halilaj Vishi** |
| **15:00-15:15** | "Perceptimi i mamive mbi rolin e tyre në kujdesin shëndetësor"<br>**Fatime Zeneli** |
| **15:15-15:30** | "Vlerësimi infermieror i simptomave menopauzale, praktikave të vetëkujdesit dhe ndikimi i tyre në produktivitetin në punë"<br>**Entela Haxhillari** |
| **15:30-15:45** | "Rëndësia e depistimit të hershëm të HPV për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe përmirësimin e shëndetit të gruas. Studim në rrethin e Korçës"<br>**Mimoza Isufi** |
| **15:45-16:00** | "Roli dhe përgjegjësite e infermieres ne vaksinimin e fëmijeve"<br>**Babeta Rexhepi** |

| | |
|---|---|
| **16:00 -16:15** | Shkaqet amtare dhe prevenimi i komplikacioneve neonatale ne pacientet me IUGR<br>**Florentina Idrizaj** |
| **16:15-16:30** | "Studimi mbi ecurinë e metroragjisë në spitalin e korcës,në 5 vitet e fundit"<br>**Delantina Mulla** |
| **16:30-16:45** | **"**Rezonanca magnetike gjatë shtatzanisë **"**<br>**Alket Collaku** |
| **16:45-17:00** | **PYETJE. DISKUTIME. KONKLUZIONET E KONGRESIT** |

| SESIONI 2 | MAMI | SALLA : ABRET |
|---|---|---|

*Moderatorë* : ***Elona Dybeli , Elena Drenesku , Ermioni Dabaj***

| **ORA**<br><br>**SESION PARALEL 2** | **TEMA** |
|---|---|
| | **Hapja e Sesionit te Referimeve**<br>Video e Studentëve Dega Mami, Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë,<br>**Rudina Cercizaj** |
| **10:00-10:20** | “Roli i infermiereve ne promovimin e ushqyerjes me gji pas daljes nga materniteti qrendesia e ushqyerjes me gji dhe ndikimi”<br>**Emrije Gjata** |
| **10:20-10:40** | “Shtazania ektopike-menaxhimi dhe kujdesi”<br>**Mirela Xherri** |
| **10:40-11:00** | “Sindromi i Preeklampsise”<br>**Andia Pelari** |
| **11:00-11:15** | “Menaxhimi i hemoragjisë postpartum dhe roli i mamive”<br>**Aida Abdurahmani** |
| **11:15-11:30** | “Komplikacionet obstetrike gjatë tremujorit të tretë të shtatzënisë – Një këndvështrim ndërkombëtar”<br>**Eljo Paja** |
| **11:30-11:45** | **“**Roli i mamise ne sallen operatore ne obstetrike gjinekologji. Detyrat dhe pergjegjesite**”**<br>**Rigerta Janaqi** |
| **11:45-12:00** | “Kujdesi infermieror tek pacientet me depresion postpartum dhe mbeshtetja për nënat e reja”<br>**Ledia Shorja**” |
| **12:00-12:15** | **“**Faktorët e riskut për komplikime të astmës në shtatzani **”**<br>**Brikena Duka** |
| **12:15-12:30** | “Hipertensioni – patologjia me e perhapur ne shtatezani”<br>**Fasela Ibrahimi** |

| | |
|---|---|
| **12:30-12:45** | “Monitorimi i gruas shtatzene dhe pergatitja e gruas per procesin e lindjes” **Eglantina Cufaj** |
| **12:45-13:00** | “Njohuritë, vlersimi dhe niveli i burnout tek infermieret -mami ne spitalin rajonal Shkoder” **Silvana Belisha** |
| **13:00-14:00** | **PUSHIM DREKE** |
| *Moderatorë : **Alma Imami Lelcaj , Lutfi Lami , Shpresa Molla*** | |
| **14:00-14:15** | “Roli i mamive në promovimin e një stili jetese të shëndetshme gjatë shtatzanisë në Shqipëri” **Shpresa Molla** |
| **14:15-14:30** | **“**Rëndësia e ushqyerjes me gji, përfitimet shëndetësore dhe sfidat e zbatimit në Shqipëri**”** **Anila Janeva** |
| **14:30-14:45** | “Ndikimi i burimeve spitalore dhe disponueshmeria e mbeshtetjes profesionale të epiziotomisë në maternitetin e durrësit rezultatet e sondazheve të epiziotomisë 2024-2025” **Sidorela Fezga (Hasani)** |
| **14:45-15:00** | “Raporti midis obezitetit dhe shëndetit riprodhues femëror” **Ivia Elezi** |
| **15:00-15:15** | “Ikteri i të porsalindurit” **Abla Çuko** |
| **15:15-15:30** | **“**Vlerësimi i barrierave me të cilat përballen mamitë në ofrimin e kujdesit pre dhe postnatal” **Eglantina Haxhiaj** |
| **15:30-15:45** | **“**Kujdesi i plagëve post-operatore pas lindjes **”** **Elvira Qosja** |
| **15:45- 16:00** | **“**Roli i mamive ne edukimin e grave per nje ushqyerje te shendetshme gjate shtatzanise**”** **Alma Imami Lelcaj** |
| **16:00-16:15** | **“**Njohja e figurës profesionale të Mamisë në Republikën e Shqipërisë **”** **Blerina Duka** |

| | |
|---|---|
| **16:15-16:30** | "Karcinoma mamare: nje shqyrtimi literatures dhe case report"<br>**File Bracja , Luiza Lushi** |
| **16:30-16:45** | "Menaxhimi i Ushqyerjes Oro/Nazogastrike tek Neonati Prematur në Kujdesin Intensive"<br>**Arjona Rakipi** |
| **16:45-17:00** | **PYETJE. DISKUTIME. KONKLUZIONET E KONGRESIT** |

| **SESIONI 3** | **MAMI SALLA ONUFER** |
|---|---|
| *Moderatorë : **Elisabeta Rista , Anduela Vaso , Shpresa Bici*** | |
| **ORA**<br><br>**SESION PARALEL 3** | **TEMA** |
| **10:00-10:20** | **“**Lindja Natyrale dhe avantazhet e saj për nënën dhe fëmijën**”**<br>**Nineta Nasufaga** |
| **10:20-10:40** | Demostrim praktik i lindjes natyrale nepermjet manekinit<br>**( Vlonitë Ballaj & Dea Vrapi** ) |
| **10:40-11:00** | “Roli i mamive në trajtimin e urgjencave menjëherë pas lindjes”<br>**Fjorida Senja** |
| **11:00-11:20** | Demostrim praktik / Reanimimi respirator / kardiak i infantit menjëherë pas lindjes<br>**( Blerina Bracellari & Malvina Mucaj )** |
| **11:20-11:40** | “Roli i mamive në promovimin e vaksinimit të grave shtatzanë dhe foshnjave: një rishikim literature i bazuar në evidenca”<br>**Anduela Vaso** |
| **11:40-12:00** | **“**Roli i kujdesit të mamive në mbështetje të ushqyerjes me gji pas lindjes**”**<br>**Arjeta Bajraktari** |
| **12:00-12:20** | Demostrim praktik / rreth mënyrës adekuate të ushqyerjes me gji<br>**( Shpresa Ballgjini & Ester Hoti )** |
| **12:20-12:40** | **“**Menaxhimi dhe trajtimi i anafilaksisë/shokut anafilaktik në gruan shtatzënë**”**<br>**Elisabeta Rista** |
| **12:40-13:00** | Demostrim praktik / Reanimimi i gruas shtatzënë gjatë shokut anafilaktik<br>**( Edlira Arapaj & Sidorela Gega)** |
| **13:00-14:00** | **PUSHIM DREKE** |

| *Moderatorë : **Mimoza Llavdaniti , Besarta Pelaj , Vjollca Qatipi*** | |
|---|---|
| **14:00-14:15** | "Vlerësimi i njohurive për ist-të tek studentët e fakultetit të shëndetit publik ( FSHP) dhe fakultetit të shkencave humane( FSHH)" **Majlinda Rakipaj** |
| **14:15-14:30** | "Monitorizimi Fetal i Ritmit Kardiak: Interpretimi Grafik i Kardiotokografisë" **Vangjeli Lice** |
| **14:30-14:50** | "Fizioterapia mbeshtet mamit ne edukimin dhe monitorimin e shtatzenise problematike" **Fatjon Hajdari** |
| **14:50-15:10** | "Vleresimi fillestar i neonatit" **Joniada Kalthi** |
| **15:10-15:30** | "Gabimet në proçedurat infermierore" **Vjollca Qatipi , Gentjana Shembitraku** |
| **15:30-15:50** | "Evolucioni i rolit të mamies në kujdesin gjatë shtatëzanisë: risitë globale dhe aplikimi i atyre në Shqipëri për një shtatëzani më të shëndetshme dhe të sigurt" **Marinela Sema** |
| **15:50-16:10** | "Roli infermieror në teknologjinë e rriprodhimit të asistuar" **Valbona Grori Lici** |
| **16:10-16:30** | "Abdominoplastika pas lindjes cezariane: përvoja e pacientëve dhe roli i infermierëve në rikuperim " **Mario Golemi** |
| **16:30-16:45** | "Roli i ekografisë gjatë ndjekjes së shtatzanisë" **Elona Dybeli** |
| **16:45-17:00** | **PYETJE. DISKUTIME. KONKLUZIONET E KONGRESIT** |

**"MAMIA NË SHQIPËRI : DRITË PËR JETËN"**

**URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË**

# Sesionet paralele Abstraktet

# NDIKIMI I BURIMEVE SPITALORE DHE DISPONUESHMËRIA E MBËSHTETJES PROFESIONALE TË LAKTACIONIT NË KLINIKEN E NEONATOLOGJISE: REZULTATET E ANKETAVE TË USHQYERJES ME GJI 2023-2024

**NEXHMIJE GORI** [1]

[1]*Kryetare e Odës së infermierëve,mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë të Kosovës*

[1]*Klinika e Neonatologjisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës*

**Hyrje**: Studimet dhe kërkimet shkencore theksojnë rëndësinë e qumështit të gjirit për shëndetin e foshnjës, duke e konsideruar atë si ushqimin ideal që përshtatet me nevojat e ndryshueshme të fëmijës. Përbërja e tij e ekuilibruar në proteina, lipide dhe karbohidrate ka bërë që shkencëtarët dhe organizatat ndërkombëtare, si OBSH dhe UNICEF, të rekomandojnë gjidhënien dhe të inkurajojnë vendet anëtare të adoptojnë strategji dhe ligje për promovimin e saj. Kosova ka miratuar një ligj për gjidhënien në vitin 2013, në përputhje me direktivat e BE-së dhe strategjitë kombëtare, duke e bërë atë një dokument modern dhe të mirëstrukturuar.

**Qellimi i punimit:** Ky punim ka per qellim te identifikoje barrierat dhe ndikimin e burimeve spitalore, organizative,per mbeshtetjen profesionale te laktacionit

**Metodologjia:** Studimi është prospektiv, është realizuar ne Klinikën e neonatologjisë të Qendrës Klinike Universitare te Kosovës dhe është i bazuar në një anketë, modifikim i anketës se standardizuara të Iowa-s, e cila është dizajnuar ne mënyrë të posaçme për ketë qellim. Janë anketuar infermierë (40) dhe nëna (50) të porsalindurve, periudha 01.2024-12.2024; Subjekt i anketës kane qenë njohuritë e te anketuarve për rëndësinë e gjidhënies dhe vetë gjidhënien si dhe promovimin dhe organizimin e gjidhënies brenda institucionit. Të dhënat e fituara janë përpunuar në mënyrë statistikore.

**Rezultatet dhe Përfundimet :** Kosova ka miratuar një ligj të veçant për gjidhënien. Ky ligj promovon të ushqyerit me qumësht gjiri dhe kufizon marketingun e qumështit komercial. Ai konsiderohet një prej ligjeve më të avancuara në regjion. Periudha e përpilimit të Ligjit, sidomos ajo e drejtpërdrejt para miratimit të tij, kanë qenë përplot aktivitete dhe kampanja vetëdijësuese të cilat, me një intensitet.Njohuritë e nënave dhe të infermiereve për rëndësinë e gjidhënies janë të larta. Barierat janë kryesisht të organizimit.

Klinika do të duhej ti pajiste nënat me material të shkruar dhe audiovizual qysh në kohën e shtatzënësisë dhe të përcjellë njohuritë e tyre menjëherë pas lindjes dhe në mënyrë periodike për periudhën sa praktikojnë gjidhënien

**Fjalë kyçe:** *Gjidhënia, barrierat, nënat, personeli shëndetësor, mbështetja profesionale institucionale; laktacioni.*

# THE IMPACT OF HOSPITAL RESOURCES AND AVAILABILITY OF PROFESSIONAL LACTATION SUPPORT IN THE NEONATOLOGY CLINIC: RESULTS OF THE BREASTFEEDING SURVEYS 2023-2024

**NEXHMIJE GORI, MA[1]**

[1]*President of the Chamber of Nurses, Midwives and Other Health Professionals of Kosovo*

[1]*Neonatology Clinic, University Clinical Center of Kosovo*

**Introduction:** Studies and scientific research emphasize the importance of breast milk for infant health, considering it as the ideal food that adapts to the changing needs of the child. Its balanced composition in proteins, lipids and carbohydrates has led scientists and international organizations, such as WHO and UNICEF, to recommend breastfeeding and encourage member states to adopt strategies and laws to promote it. Kosovo adopted a law on breastfeeding in 2013, in line with EU directives and national strategies, making it a modern and well-structured document.

**Purpose of the paper**: This paper aims to identify barriers and the impact of hospital, organizational resources, on professional lactation support

**Methodology:** The study is prospective, was conducted at the Neonatology Clinic of the University Clinical Center of Kosovo and is based on a survey, a modification of the standardized Iowa survey, which was specially designed for this purpose. Nurses (40) and mothers (50) of newborns were surveyed, period 01.2024-12.2024; The subject of the survey was the knowledge of the respondents about the importance of breastfeeding and breastfeeding itself as well as the promotion and organization of breastfeeding within the institution. The data obtained were statistically processed.

**Results:**

**Conclusion**: Kosovo has adopted a special law on breastfeeding. This law promotes breastfeeding and limits the marketing of commercial milk. It is considered one of the most advanced laws in the region. The period of drafting the Law, especially the one immediately before its adoption, has been full of awareness-raising activities and campaigns which, with an intensity.Mothers' and nurses' knowledge of the importance of breastfeeding is high. Barriers are mainly organizational.

The clinic should provide mothers with written and audiovisual material from the time of pregnancy and convey their knowledge immediately after birth and periodically for the period they practice breastfeeding

**Keywords:** *Breastfeeding, barriers, mothers, health personnel, professional institutional support; lactation.*

# STUDIM MBI ZBATIMIN E PROTOKOLLIT TË NDJEKJES SË TË PORSALINDURIT, BARRIERAT NË IMPLEMENTIMIN E TIJ

**ZAMIRA ÇABIRI, SHKËLQIM HIDRI, GAZMENT KODUZI, RUSTEM CELAMI, JONILA CELA, ILDA TAKA, ELONA DYBELI, FLORENC PILIGRIU**

[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"*

**Hyrje**: Standardizimi i shërbimeve sipas protokollit për të sapolindurit ndikon në cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor duke siguruar rritjen e duhur të fëmijëve dhe duke reduktuar shkallën e vdekshmërisë foshnjore. Që nga viti 2014, Shqipëria zbaton një protokoll kombëtar që standardizon ndjekjen e fëmijëve nga konsulentët e kujdesit shëndetësor. Ky studim vlerëson respektimin e këtij protokolli në qarkun e Elbasanit.

**Qëllimi** i këtij studimi ishte të vlerësonte kujdesin pas lindjes, barrierat në cilësinë e shërbimit dhe kapacitetin e sistemit parësor për ofrimin e kujdesit cilësor.

**Metodologjia.** Ky është një studim ndërseksional sasior, i kryer përmes një pyetësori të përgatitur në Google Forms dhe i shpërndarë tek personeli shëndetësor që punon në qendrat e këshillimit të fëmijëve (115 profesionistë të kujdesit shëndetësor, përfshirë mjekë dhe infermierë). Të dhënat u përpunuan duke përdorur SPSS 27.

**Rezultate.** Sfidat në ndjekjen e të porsalindurve lindin nga vizitat fillestare të vonuara. Dorëzimi manual i të dhënave (89.6%) dhe vështirësia në gjetjen e adresave (62.6%) kontribuojnë në vonesa, ku 58.6% raportuan se vizitat e para në shtëpi ndodhin pas dy ditësh, duke shkelur protokollet. Për më tepër, 74.8% e personelit të kujdesit shëndetësor besojnë se të dhënat elektronike mjekësore do të ishin shumë të dobishme, pasi të dhënat në letër shkaktojnë vonesa dhe shpesh nuk kanë informacion thelbësor për nënën dhe fëmijën. Gjithashtu, mungojnë protokollet dhe materialet e shtypura, 35.7% nuk kanë pasur trajnime, dhe 94.8% kanë shprehur nevojën për edukim të vazhdueshëm.

**Konkluzione.** Vonesat në marrjen e të dhënave mjekësore nga maternitetet pengojnë vizitat në kohë në shtëpi. Vështirësia në gjetjen e adresave dhe mungesa e protokolleve ose e trajnimit ndikojnë më tej në ndjekjen efektive dhe monitorimin e zhvillimit të fëmijëve. Mungesa e protokolleve të printuara dhe mungesa e trajnimit e pengojnë personelin e kujdesit shëndetësor të respektojë në mënyrë adekuate kriteret e ndjekjes dhe të monitorojë në mënyrë efektive zhvillimin e fëmijëve.

**Fjalë kyçe**: *protokoll, periudhë pas lindjes, konsultë, kartelë elektronike mjekësore, ndjekje.*

# STUDY ON THE IMPLEMENTATION OF THE NEWBORN FOLLOW-UP PROTOCOL AND BARRIERS ON IT'S IMPLEMENTATION

**ZAMIRA ÇABIRI[1], SHKËLQIM HIDRI, GAZMENT KODUZI, RUSTEM CELAMI, JONILA CELA, ILDA TAKA, ELONA DYBELI, FLORENC PILIGRIU**

[1]*Faculty of Medical and Technical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani".*

**Background:** The standardization of services according to newborn follow-up protocols plays a crucial role in ensuring the quality of healthcare services, contributing to proper child growth and reducing infant mortality rates. Since 2014, Albania has implemented a national protocol that standardizes the follow-up of children by healthcare consultants. This study evaluates compliance with this protocol in the Elbasan region.

**Objective:** The aim of this study was to assess postnatal care, barriers affecting service quality, and the capacity of the primary healthcare system to provide quality care.

**Methodology:** This is a cross-sectional quantitative study conducted through a questionnaire prepared in Google Forms and distributed to healthcare personnel working in child counseling centers (115 healthcare professionals, including doctors and nurses). Data were processed using SPSS 27.

**Results:** Challenges in newborn follow-up arise due to delayed initial visits. Manual data entry (89.6%) and difficulties in locating addresses (62.6%) contribute to these delays, with 58.6% of respondents reporting that initial home visits occur after two days, violating protocol requirements. Furthermore, 74.8% of healthcare personnel believe that electronic medical records would be highly beneficial, as paper-based records cause delays and often lack essential information about the mother and child. Additionally, printed protocols and materials are scarce, 35.7% of respondents had not received training, and 94.8% expressed the need for continuous education.

**Conclusions:** Delays in receiving medical records from maternity hospitals hinder timely home visits. Address location difficulties and the lack of protocols or training further impact effective follow-up and child development monitoring. The absence of printed protocols and training prevents healthcare personnel from adequately adhering to follow-up criteria and effectively monitoring child development.

**Keywords:** *protocol, postnatal period, consultation, electronic medical record, follow-up.*

# KUJDESI INFERMIEROR NË HIPOTERMINË NEONATALE NË MATERNITETIN E ELBASANIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2022- 2023

**SHQIPE LUTA[1], ALBANA SULA[1], RAJMONDA HIDA[1], ELONA DYBELI[1], JUXHIN LUTA[2], ESMERALDA VRETO [2]**

[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".*
[2] *Infermierë*
Email: shqipeluta@yahoo.com

**Hyrje:** Hipotermia është një ndryshim i zakonshëm i fiziologjisë termorregulluese tek i porsalinduri dhe ndodh kur temperatura trupore (aksilare) bie nën vlerën 36.5°C. Hipotermia neonatale lidhet me faktorë të ndryshëm, duke përfshirë kushtet mjedisore, aspektet fiziologjike të të porsalindurit, sjelljen dhe faktorët socio-ekonomikë. Mosidentifikimi dhe trajtimi në kohë i hipotermisë mund të çojë në rritjen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë neonatale, si dhe në ndërlikime të rënda shëndetësore. Kujdesi infermieror luan një rol kyç në monitorimin, identifikimin dhe trajtimin e hershëm të hipotermisë për të siguruar një trajtim efektiv dhe për të parandaluar ndërlikimet e mundshme.

**Objektivat:** Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i hipotermisë neonatale lidhur me identifikimin e faktorëve rriskues dhe menaxhimi infermieror në neonatët e lindur në maternitetin e Elbasanit në periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022-2023.

**Metodologjia.** Për kryerjen e këtij studimi janë shfrytëzuar kartelat/regjistra të vitit 2022-2023 në periudhën Janar-Dhjetor në Reanimacionin e Neonatologjisë në Spitalin Rajonal të Elbasanit. Popullata e marrë në studim janë neonatët e shtruar në Reanimacionin e Neonatologjisë nga 0-28 ditësh.

**Rezultatet:** Nga studimi u vu re se të porsalindurit në periudhat e ftohta Dhjetor-Shkurt dhe Mars-Maj kanë zhvilluar më shumë hipotermi. Nga këto përmenden, prematuranca,hypotrofia, diagnoza e paspecifikuar dhe ata që kanë marrë antipiretik të padozuar saktë. Studimi nxorri në pah se në neonatët 0-1 ditësh, dhe 3-21 ditë janë më të prirur të zhvillojnë hipotermi për shkak të dozës së pa saktë të antipiretikëve ose nga kondicione të tjera.

**Rekomandime:** Edukimi i stafit shëndetësor si edhe nënat e reja, duke filluar nga kujdesi neonatal e deri tek dozimi i duhur i medikamentëve. Shfletimi i vazhdueshëm i literaturës nga stafi mjekesor dhe zhvillimi i seminareve me tematika mbi problemet e neonatëve. Fëmija ka nevojë për një trajtim më specifik, ai duhet të ndjekë një rradhë hierarkike duke filluar nga kontakti lëkurë me lëkurë me nënën, vendosja në incubator. (ndjekja e "zinxhirit të ngrohtë" pavarësisht nga stadi i hipotermisë)

**Fjalë kyçe:** *hipotermi, neonat, ngrohje, termorregullim, zinxhir i ngrohtë*

# NURSING CARE IN NEONATAL HYPOTHERMIA IN ELBASAN MATERNITY FOR THE PERIOD JANUARY-DECEMBER 2022- 2023

**SHQIPE LUTA[1], ALBANA SULA[1], RAJMONDA HIDA[1], ELONA DYBELI[1], JUXHIN LUTA[2], ESMERALDA VRETO [2]**

[1]*Faculty of Medical and Technical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani".*

[2] *Nurses*

Email: shqipeluta@yahoo.com

**Introduction:** Hypothermia is a common alteration of thermoregulatory physiology in the newborn and occurs when the body temperature (axillary) falls below 36.5°C. Neonatal hypothermia is associated with various factors, including environmental conditions, physiological aspects of the newborn, behavior, and socioeconomic factors. Failure to identify and treat hypothermia in a timely manner can lead to increased neonatal morbidity and mortality, as well as serious health complications. Nursing care plays a key role in monitoring, identifying, and early treatment of hypothermia to ensure effective treatment and prevent possible complications.

**Objectives:** The aim of this study is to identify neonatal hypothermia in relation to the identification of risk factors and nursing management in neonates born in the Elbasan maternity hospital in the period January-December 2022-2023.

**Methodology.** To conduct this study, the 2022-2023 cards/registers in the January-December period in the Neonatology Intensive Care Unit at the Elbasan Regional Hospital were used. The population studied are neonates admitted to the Neonatology Intensive Care Unit from 0-28 days old.

**Results:** The study found that newborns in the cold periods of December-February and March-May developed more hypothermia. These include prematurity, hypotrophy, unspecified diagnosis and those who received incorrectly dosed antipyretics. The study highlighted that neonates 0-1 days old, and 3-21 days old are more likely to develop hypothermia due to incorrect doses of antipyretics or other conditions.

**Recommendations:** Education of healthcare staff as well as new mothers, starting from neonatal care to the correct dosage of medications. Continuous literature review by medical staff and development of seminars on thematic issues of neonates. The child needs a more specific treatment, he should follow a hierarchical order starting from skin-to-skin contact with the mother, placement in the incubator. (following the "warm chain" regardless of the stage of hypothermia).

**Keywords:** *hypothermia, neonate, warming, thermoregulation, warm chain.*

# PËRMIRËSIMI I KURRIKULAVE DHE PËRCAKTIMI I STANDARDEVE TË PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR TË RRITUR VETËBESIMIN DHE KOMPETENCËN TE STUDENTËT E PROGRAMIT TË STUDIMIT MAMI

**ELENA DRENESKU[1], EMISA VELO[1], STELA MUÇA[2], DELANTINA MULLA[3]**

[1]*Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli", Departamenti i Infermierisë, Korçë*
[2] *Pedagoge, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë,*
[3] *Presidente e Urdhrit të Infermierit Qarku Korçë, Kryeinfermiere, Materniteti Korçë,*
***Email:*** *elenadrenesku@yahoo.com*

**Hyrje**:Mamitë, si profesioniste shëndetësore, luajnë një rol kyç në promovimin e shëndetit, autonomisë dhe besimit të grave gjatë shtatzënisë, lindjes dhe pas saj. Përafrimi i kurrikulave me standardet ndërkombëtare dhe nevojat rajonale të kujdesit shëndetësor, duke theksuar rolin e praktikave të bazuara në raste klinike, bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe korniza etike janë elementë të rëndësishëm në rritjen e vetëbesimit dhe të kompetencës tek studentet e programit të studimit Mami.

**Qëllimi** është të përcaktojë zhvillimin e vetëbesimit dhe kompetencës të cilat janë thelbësore për një studente që ndjek një karrierë në mami, në përmbushjen e aftësive të kërkuara klinike.Studimi arriti në përfundime dhe nxorri rekomandime të vlefshme që do të ndihmojnë në përmirësimin e përgatitjes së profesionisteve shëndetësore, mami dhe do të shërbejnë si pikënisje e punimeve të tjera shkencorenë këtë fushë.

**Metodologjia :** Metoda e përdorur është kulitative dhe në veçanti kërkimi etnografik si një metodë në zhvillim për të mbështetur përmirësimin e aftësive të kujdesit shëndetësor.

Nëpërmjet vëzhgimit dhe ndërveprimit të drejtpërdrejtë me studentet e Programit të Studimit Bachelor në Mami, Departamenti i Infermierisë, të përfshira në studim dhe stafi mami në Shtëpinë e Lindjes Korçë, u vlerësua vetëbesimi, aftësitë praktike, dhe ndërveprimet profesionale të cilat ndikojnë në kujdesin shëndetësor për gratë, nënat dhe foshnjat si dhe për zhvillimin e modeleve të përshtatura të kujdesit. Të dhënat u mblodhën përmes shtatë diskutimeve në fokus grupe me 37 studente të vitit të tretë të Programit të Studimit Bachelor në Mami dhe 10 mami që ushtrojnë profesionin .

**Rezultatet:** Analizimi i të dhënave rezultoi në grupimin e katër koncepteve, zhvillimi i kompetencës në praktikën profesionale të studenteve mami, pengesat për zhvillimin e kompetencës dhe rëndësia e vetëbesimit për të qenë kompetent. Pjesëmarrësit në fokus grupet ranë dakord me idenë se dija dhe kompetenca fillojnë me arsimimin e forcohen me edukimin në vazhdimësi. Zhvillimi i vetëbesimit dhe kompetencës fitohet nëpërmjet kurrikulave të strukturuara që fokusohen në zhvillimin e aftësive, vendimmarrjen etike dhe kujdesin ku në qendër është pacienti e kjo i përgatit studentet me vetëbesim për të përmbushur standardet profesionale.

**Fjalët kyçe:** *mami, kurrikul, vetëbesim, kompetencë, kujdes shëndetësor*

# IMPROVING CURRICULUM AND DETERMINING PROFESSIONAL PRACTICE STANDARDS TO INCREASE SELF-CONFIDENCE AND COMPETENCE AMONG STUDENTS OF THE MIDWIFERY STUDY PROGRAM

**ELENA DRENESKU[1], EMISA VELO[2], STELA MUÇA[3], DELANTINA MULLA[4]**

*[1]Pedagogue, "Fan S. Noli" University, Department of Nursing, Korça*
*[2]Pedagogue, Faculty of Medical and Technical Sciences, Tirana,*
*[3]President of the Albanian Order of Nurses Korça District, Chief Nurse, Korça Maternity Hospital,*
***Email**: elenadrenesku@yahoo.com*

**Introduction:** Midwives, as essential healthcare professionals, play a key role in promoting women's health, autonomy, and confidence throughout pregnancy, childbirth, and the postpartum period. Aligning midwifery curricula with international standards and regional healthcare needs - while emphasizing case-based learning, interdisciplinary collaboration, and ethical frameworks - is crucial in fostering students' self-confidence and competence.
**The main aim** of this study is to assess the development of self-confidence and competence, critical attributes for midwifery students in achieving the required clinical skills. The study reached conclusions and produced valuable recommendations that will help improve the training of midwives and other healthcare professionals, serving as a foundation for future research in this field.

**Methodology:** This study employs a qualitative approach, specifically ethnographic research, as an emerging method to enhance healthcare skills.

Through observation and direct interaction with students from the Bachelor in Midwife Nursing, Department of Nursing, and midwifes of Korça maternity hospital, key aspects such as self-confidence, practical skills, beliefs, and professional interactions influencing healthcare for women, mothers, and infants were assessed. Additionally, the study contributed to the development of adapted care models. Data were obtained through seven focus group discussions involving 37 third-year midwifery students and 10 practicing midwives.
**Results:** The data analysis identified four key concepts: competence, the development of competence in midwifery students' professional practice, barriers to competence development, and the crucial role of self-confidence in achieving competence. Focus group participants agreed that knowledge and competence begin with education and are reinforced through continuous learning. They emphasized that self-confidence and competence develop through structured curricula that prioritize skill-building, ethical decision-making, and patient-centered care, ultimately equipping students with the confidence to meet professional standards.
**Keywords:** *midwifery, curriculum, self-confidence, competence, health care.*

# RËNDËSIA DHE PËRSHTATJA E PROTOKOLLEVE SIPAS NEVOJAVE DHE EVIDENCAVE MË TË MIRA PËR KUJDES ADEKUAT TË GRUAS

**ALBANA POLOSKA[1], RISIDA GJONEJ[1], BLERINA DUKA[2]**

*[1]Lektore Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*
*[2]Presidente e Urdhrit Infermierit*
*Adres email:albana.poloska@yahoo.com*

**Hyrje:** shkenca dhe arti i "Mamisë" karakterizohet nga: njohja, promovimi dhe mbrojtja e shëndetit të gruas gjatë gjithë etapave të jetës së saj.Përgjegjësitë profesionale të mamisë përfshijnë:njohuri mbi bazën ligjore dhe cështjet e kujdesit të gruas,pabarazitë,politikat etike, përdorimi i teknologjisë në funksion të përmirësimit të cilësisë së shëndetit, sigurisë së gruas dhe familjes. Gjithashtu, bashkëpunimi me kolegët, të bazuarit në evidencat më të mira,ekspertizën klinike, të mësuarit gjatë gjithë jetës,promovimi i këtij profesioni dhe respektimi i preferencave të pacientëve janë detyrime të mamisë.

**Qëllimi:** është observimi i protokolleve të mamisë në shërbimin parësor dhe në maternitet për të theksuar rëndësinë dhe vlerësimin e përshtatjes së tyre sipas nevojave dhe trendeve të reja me fokus kujdesin adekuat ndaj shëndetit të gruas.

M**etodologjia*:*** Rishikimi i literaturave të huaja dhe protokolleve ekzistuese në vend në shërbim parësor dhe maternitet. Specifikisht kemi kërkuar literature në (WHO, PubMed, CINAHL, Scopus, Web of Science) të viteve 2023-2024.

**Rezultatet*:*** Shyrtimi i literaturave të huaja të fokusuara sipas nevojave të vendeve dhe trendeve të reja bazuar në standartet e OBSH vendosin theksin në rëndësinë e hartimit të protokolleve dhe përditësimin e tyre duke u bazuar në praktikat dhe ekspertizat më të mira.Observimi i protokolleve në vend nxorri në pah se në shërbimin parësor ekzistojnë protokollet për shëndetin e nënës dhe fëmijës por kanë nevojë imediate për përditësimin e tyre.

**Konkluzione:** Protokollet janë vlerësuar mjaft të rëndësishmë për maminë.Rëndësia e hartimit dhe përditësimit të tyre kur ato janë present bën që të kemi një staf më të kualifikuar i cili sjell shërbim më cilësor dhe në kohë duke reduktuar sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e pacienteve.

**Rekomandimet*:*** politikat duhet të fokusohen në rritjen e përpjekjeve të hartimit të protokolleve nëse nuk ofrohen në shërbimin parësor dhe maternitet dhe përditësimin e tyre duke u bazuar në të dhënat dhe ekspertizat më të mira,përshtatjen e tyre sipas nevojave dhe specifikave të kujdesit në vend.Njohja e protokolleve dhe trajnimi i stafit është detyrim i institucioneve shëndetësore që të këmi shërbim cilësor efikas dhe pacientë të kënaqur.

**Fjalë kyçe*:*** *mami,protokolle, kujdes,grua, qasje,cilësi,sistem shëndetësor*

# THE IMPORTANCE AND ADAPTATION OF PROTOCOLS ACCORDING TO THE NEEDS AND BEST EVIDENCE FOR ADEQUATE CARE OF WOMEN

**ALBANA POLOSKA[1], RISIDA GJONEJ[1], BLERINA DUKA[2],**

[1]*Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana*
[2] *President-Albanian Order of Nurses*
*Email:albana.poloska@yahoo.com*

**Introduction:** The science and art of “Midwifery” is characterized by recognizing, promoting and protecting women’s health throughout all stages of their lives. The professional responsibilities of the midwife include knowledge of the legal basis and issues of women’s care, inequalities, ethical policies, the use of technology in order to improve the quality of health, the safety of women and their families. Also, collaboration with colleagues, based on the best evidence, clinical expertise, lifelong learning, promoting this profession and respecting patients’ preferences are the obligations of the midwife.

**Purpose:** is to observe midwifery protocols in primary care and maternity to emphasize the importance and evaluate their adaptation according to new needs and trends with a focus on adequate care for women’s health.

**Methodology:** Review of foreign literature and existing protocols in the country in primary care and maternity. Specifically, we searched for literature in (WHO, PubMed, CINAHL, Scopus, Web of Science) for the years 2023-2024.

**Results:** The review of foreign literature focused on the needs of countries and new trends based on WHO standards emphasizes the importance of drafting protocols and updating them based on best practices and expertise. Observation of protocols in the country highlighted that protocols for maternal and child health exist in primary care but are in immediate need of updating.

**Conclusions:** Protocols are considered very important for midwifery. The importance of drafting and updating them when they are present allows us to have a more qualified staff who provide better quality and timely service, reducing patient morbidity and mortality.

**Recommendations:** policies should focus on increasing efforts to draft protocols if they are not offered in primary and maternity services and updating them based on the best data and expertise, adapting them to the needs and specifics of care in the country. Knowledge of protocols and training of staff is an obligation of health institutions to have efficient quality service and satisfied patients.

**Keywords:** *midwife, protocols, care, woman, access, quality, health system*

# MENAXHIMI INFERMIEROR I PROBLEMEVE TË SHËNDETIT MENDOR TE PRINDERIT PAS LINDJES SË FOSHNJËS SË TYRE

**GENTJANA SHEMBITRAKU[1]**

[1]*SUOGJ Koço Gliozheni*

**Hyrje :** Periudha pas lindjes është një fazë kritike për shëndetin mendor të prindërve, veçanërisht të nënave, të cilat përballen me ndryshime të mëdha fizike, emocionale dhe sociale. Ndryshimet hormonale, lodhja e vazhdueshme, stresi i kujdesit për foshnjën dhe përgjegjësitë e reja mund të çojnë në probleme serioze të shëndetit mendor, si depresioni pas lindjes, ankthi, çrregullimet e humorit dhe, në raste më të rënda, psikozën pas lindjes. Këto gjendje jo vetëm që ndikojnë në mirëqenien e prindërve, por gjithashtu mund të kenë pasoja në lidhjen prind-fëmijë dhe në zhvillimin e shëndetshëm të foshnjës. Për këtë arsye, menaxhimi infermieror i këtyre problemeve përmes monitorimit, këshillimit dhe mbështetjes së vazhdueshme është thelbësor për të siguruar një periudhë pas lindjes sa më të shëndetshme dhe të qëndrueshme për prindërit dhe fëmijën e tyre.
**Qëllimi:** Ky studim synon të identifikojë rolin e infermierëve në menaxhimin e problemeve të shëndetit mendor tek prindërit pas lindjes dhe të vlerësojë ndikimin e ndërhyrjeve infermierore në parandalimin dhe trajtimin e këtyre problemeve.
**Metodologjia :** Një studim përshkrues u realizua për të analizuar qasjet infermierore në kujdesin e shëndetit mendor pas lindjes. Të dhënat u mblodhën nga literatura shkencore, protokollet infermierore dhe intervista me infermierë të përfshirë në kujdesin pas lindjes. U përdor një analizë krahasuese për të vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve infermierore në përmirësimin e mirëqenies psikologjike të prindërve.
**Rezultatet :** Gjetjet treguan se ndërhyrjet infermierore, duke përfshirë edukimin shëndetësor, dhe mbështetjen emocionale, kanë një ndikim pozitiv në reduktimin e simptomave të depresionit dhe ankthit pas lindjes. Prindërit që përfituan nga këto ndërhyrje raportuan një përmirësim të ndjeshëm të gjendjes së tyre psikologjike dhe një rritje të aftësisë për të menaxhuar stresin prindëror.
**Përfundimi :** Infermierët luajnë një rol kyç në identifikimin dhe menaxhimin e problemeve të shëndetit mendor tek prindërit pas lindjes. Ndërhyrjet e bazuara në mbështetje psikologjike dhe edukim shëndetësor janë të efektshme për të përmirësuar mirëqenien e prindërve dhe për të siguruar një mjedis të shëndetshëm për rritjen e foshnjës. Rekomandohet që këto ndërhyrje të integrohen në praktikat standarde të kujdesit pas lindjes.
**Fjalët kyçe:** *shëndeti mendor, prindërit pas lindjes, depresioni pas lindjes, mbështetja psikologjike*

# NURSING MANAGEMENT OF MENTAL HEALTH PROBLEMS IN PARENTS AFTER THEIR BABY'S BIRTH

**GENTJANA SHEMBITRAKU[1]**

[1]*SUOGJ Koço Gliozheni*

**Introduction:** The postpartum period is a critical phase for the mental health of parents, especially mothers, who face major physical, emotional and social changes. Hormonal changes, constant fatigue, the stress of caring for the baby and new responsibilities can lead to serious mental health problems, such as postpartum depression, anxiety, mood disorders and, in more severe cases, postpartum psychosis. These conditions not only affect the well-being of the parents, but can also have consequences for the parent-child bond and the healthy development of the baby. For this reason, nursing management of these problems through monitoring, counseling, and ongoing support is essential to ensure a healthy and stable postpartum period for parents and their child.

**Purpose:** This study aims to identify the role of nurses in managing mental health problems in parents after birth and to evaluate the impact of nursing interventions in preventing and treating these problems.

**Methodology:** A descriptive study was conducted to analyze nursing approaches to postpartum mental health care. Data were collected from scientific literature, nursing protocols, and interviews with nurses involved in postpartum care. A comparative analysis was used to evaluate the effectiveness of nursing interventions in improving the psychological well-being of parents.

**Results:** The findings showed that nursing interventions, including health education, and emotional support, have a positive impact on reducing symptoms of postpartum depression and anxiety. Parents who benefited from these interventions reported a significant improvement in their psychological state and an increase in the ability to manage parental stress.

**Conclusion:** Nurses play a key role in identifying and managing mental health problems in parents after birth. Interventions based on psychological support and health education are effective in improving the well-being of parents and ensuring a healthy environment for the baby to grow. It is recommended that these interventions be integrated into standard postpartum care practices.

**Keywords:** *mental health, postpartum parents, postpartum depression, psychological support.*

# ROLI I MAMIVE NË PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E FIBROMIOMAVE UTERINE: QASJE TË REJA DHE PRAKTIKA KLINIKE

**EMISA VELO[1], ELENA DRENESKU[2], DELANTINA MULLA[3], STELA MUÇA[4]**

*[1]Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli", Departamenti i Infermierisë, Korçë.*
*[2] Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli", Departamenti i Infermierisë, Korçë*
*[3]Presidente e Urdhrit të Infermierit Qarku Korçë, Kryeinfermiere, Materniteti Korçë*
*[4] Pedagoge, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë*
*Email: veloemisa20@gmail.com*

**Hyrje** Fibromiomat uterine të njohura gjithashtu si myomat e mitrës, fibroide, leiomioma ose polipe të mitrës, janë neoplazi beninje të zakonshme që rrjedhin nga muskujt e lëmuar të mitrës dhe indi lidhës në të. Tre të katërtat e të gjitha grave mund të preken nga tumori fibroz, sidomos gjatë moshës së riprodhimit. Megjithëse fibromiomat janë zakonisht të padëmshme, ato mund të ndikojnë në cilësinë e jetës dhe mund të kërkojnë trajtim të specializuar. Në këtë kontekst, roli i mamive është thelbësor, pasi ato mund të identifikojnë shenjat e hershme, të ndihmojnë në përgatitjen e pacienteve për teste diagnostikuese dhe të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për menaxhimin dhe përmirësimin e kujdesit për pacientet.

**Qëllimi** i studimit është njohja e shkaqeve, simptomave, metodave diagnostikuese dhe trajtuese të fibromiomave si edhe shqyrtimi i rolit të mamive në parandalimin, diagnostikimin dhe menaxhimin e tyre, duke u fokusuar në praktikat e reja.

**Metodologjia:** Hulumtimi është i tipit deskriptiv, sasior. Mostra e marrë në studim i takon vetëm rasteve të shtruara dhe trajtuara në Maternitetin e Korçës, gjatë vitetve 2023-2024, gjithsej 70 paciente. Për efekt studimi janë përdorur edhe të dhëna dytësore të marra nga kartelat mjekësore të pacienteve me miomë. Përveç të dhënave demografike, analizohen ndikimet e faktorëve të jashtëm, si stili i jetesës dhe hormonet, në zhvillimin dhe përparimin e fibromiomeve, dhe si mund të kontribuojnë strategjitë e parandalimit në reduktimin e incidencës së tyre.

**Rezultatet:** Mamitë që shpesh janë të angazhuara në menaxhimin e shëndetit riprodhues të grave mund të luajnë një rol kyç në diagnostikimin, trajtimin dhe edukimin e pacienteve me Fibromioma Uterine. Edukimi i vazhduar i tyre lidhur me patologji të ndryshme dhe mundësitë e reja të trajtimit është thelbësor. Kjo mund të përmirësojë rezultatet klinike dhe të rrisë trajtimin efektiv. Kërkime më të thella dhe studimet afatgjata janë të nevojshme për të vërtetuar efektivitetin dhe sigurinë e këtyre qasjeve.

**Fjalët kyçe:** *Fibromioma uterine, parandalim, menaxhim, mami, praktika klinike*

# THE ROLE OF MIDWIVES IN THE PREVENTION AND MANAGEMENT OF UTERINE FIBROMIAS: NEW APPROACHES AND CLINICAL PRACTICES

**EMISA VELO[1], ELENA DRENESKU[2], DELANTINA MULLA[3], STELA MUÇA[4]**

*[1] Lecturer, "Fan S. Noli" University, Department of Nursing, Korça*
*[2] Lecturer, "Fan S. Noli" University, Department of Nursing, Korça*
*[3] President of Albanian Order of Nurses, Korça District, Chief Nurse, Korça Maternity*
*[4] Lecturer, Faculty of Medical and Technical Sciences, Tirana*
*Email: veloemisa20@gmail.com*

**Introduction**: Uterine fibroids, also known as uterine myomas, fibroids, leiomyomas or uterine polyps, are common benign neoplasms arising from the smooth muscles of the uterus and its connective tissue. It is estimated that three-quarters of women worldwide have or will be affected by fibroid tumors, especially during their reproductive years. Although fibroids are generally harmless, they can impact quality of life and may require specialized treatment. In this context, midwives play a crucial role in identifying early signs, preparing patients for diagnostic tests, and providing essential support for effective management and improved patient care.

**The main aim** of this paper is to identify the causes, symptoms, diagnostic methods, and treatment options for uterine fibroids while highlighting the role of midwives in prevention, early detection, and management, with a focus on emerging best practices.

**Methodology:** The research follows a descriptive, quantitative approach, analyzing a sample of 70 patients diagnosed and treated for fibroids at Korça Maternity Hospital between 2023 and 2024. Secondary data obtained from patient medical records were also utilized. In addition to demographic data, the influences of external factors, such as lifestyle and hormones, on the development and progression of fibroids are analyzed, and how prevention strategies can contribute to reduce incidence rates.

**Results:** Midwives, who are deeply involved in managing women's reproductive health, play a key role in diagnosis, treatment, and patient education on uterine fibroids. Ongoing education on various pathologies and emerging treatment options is crucial, as it can enhance clinical outcomes and improve treatment effectiveness. Further research and long-term studies are needed to confirm the safety and efficacy of these approaches.

**Keywords:** *Uterine fibroids, prevention, management, midwife, clinical practice*

# NDIKIMI I SUPLEMENTEVE NË JETËN E NJË GRUAJE FERTILE ME PCOS. STUDIM RASTI

**LEJDI FETAHU[1], BRUNA SUBASHI[2], ERLINI KOKALLA[3]**

*[1]Drejtuese teknike/Farmaciste në Farmaci Unica, Vlorë*
*[2]Qendra Kërkimore Shkencore për Shëndetin Publik, Fakuletit i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.*
*[3]Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali".*
*Email: lejdifetahu@gmail.com*

**Hyrje** : Sindroma e vezoreve polikistike (PCOS) është një çrregullim hormonal i zakonshëm tek gratë në moshën riprodhuese, i karakterizuar nga cikle menstruale të çrregullta dhe nivele të larta të androgjeneve. Shfaqja e kësaj sindrome lidhet me prani të mikrokisteve në vezore, të cilat mund të çojnë në mungesë ovulacioni. Shkaqet e sakta të PCOS-së mbeten të panjohura, por diagnoza dhe trajtimi i hershëm mund të ndihmojnë në reduktimin e komplikacioneve afatgjata si diabeti i tipit 2 dhe sëmundjet kardiovaskulare.

**Qëllimi:** Ky studim ka për qëllim të ndërgjegjësojë gratë e reja për rëndësinë e monitorimit të simptomave të PCOS-së, kryerjen e kontrolleve të rregullta mjekësore dhe adoptimin e strategjive të duhura për menaxhimin e kësaj sindrome. Gjithashtu, synohet të vlerësohet efekti i një diete të personalizuar dhe përdorimi i suplementeve specifike në përmirësimin e simptomave dhe rritjen e mundësisë për shtatzëni.

**Metodologjia** : Ky studim rasti përfshin një paciente 31-vjeçare e diagnostikuar me PCOS një vit më parë. Pacientja, e cila dëshiron të mbetet shtatzënë, ka ndjekur për tre muaj një regjim të rekomanduar nga mjeku specialist, i cili përfshin:

- Një dietë të pasur me proteina, perime dhe karbohidrate me indeks të ulët glicemik.
- Aktivitet fizik të moderuar pa sforcime të tepërta.
- Përdorimin e suplementeve: Inositol (Myo Inositol + D-chiro-Inositol), Vitaminë D, Acid folik dhe Omega-3.

**Rezultatet dhe konkluzionet** : Pas tre muajsh trajtimi, ekzaminimet mjekësore treguan përmirësim të gjendjes së mikrokisteve në vezore dhe stabilizim të ciklit menstrual. Mjeku rekomandoi vazhdimin e këtij regjimi për tre muaj të tjerë, duke sugjeruar se pacientja mund të tentojë për një shtatzëni gjatë kësaj periudhe.

Sindroma e vezoreve polikistike është një gjendje që kërkon një qasje të integruar për menaxhimin efektiv, duke përfshirë dietën, aktivitetin fizik dhe suplementet e duhura. Ndërgjegjësimi dhe trajtimi i hershëm janë thelbësore për përmirësimin e shëndetit riprodhues dhe uljen e rreziqeve të ndërlikimeve afatgjata.

**Fjalë kyçe**: *sindroma e ovarit policistik, inositol, dietë, shtatzëni*

# THE IMPACT OF SUPPLEMENTS ON THE LIFE OF A FERTILE WOMAN WITH PCOS. CASE STUDY

**LEJDI FETAHU[1], BRUNA SUBASHI[2], ERLINI KOKALLA[3]**

[1]*Technical Manager/Pharmacist at Unica Pharmacy, Vlora.*
[2]*Scientific Research Center for Public Health, Faculty of Health, "Ismail Qemali" University, Vlora.*
[3]*Department of Health Care, Faculty of Health, "Ismail Qemali" University of Vlora.*
Email: lejdifetahu@gmail.com

**Introduction:** Polycystic ovary syndrome (PCOS) is a common hormonal disorder in women of reproductive age, characterized by irregular menstrual cycles and high levels of androgens. The occurrence of this syndrome is associated with the presence of microcysts in the ovaries, which can lead to anovulation. The exact causes of PCOS remain unknown, but early diagnosis and treatment can help reduce long-term complications such as type 2 diabetes and cardiovascular disease.

**Objective:** This study aims to raise awareness among young women about the importance of monitoring PCOS symptoms, undergoing regular medical check-ups, and adopting appropriate strategies for managing this syndrome. It also aims to evaluate the effect of a personalized diet and the use of specific supplements in improving symptoms and increasing the chance of pregnancy.

**Methodology:** This case study involves a 31-year-old patient diagnosed with PCOS a year ago. The patient, who wants to become pregnant, has followed a regimen recommended by her specialist doctor for three months, which includes:

• A diet rich in proteins, vegetables, and carbohydrates with a low glycemic index.
• Moderate physical activity without excessive exertion.
• Use of supplements: Inositol (Myo Inositol + D-chiro-Inositol), Vitamin D, Folic Acid and Omega-3.

**Results and conclusions:** After three months of treatment, medical examinations showed improvement in the condition of microcysts in the ovaries and stabilization of the menstrual cycle. The doctor recommended continuing this regimen for another three months, suggesting that the patient could try for a pregnancy during this period.

Polycystic ovary syndrome is a condition that requires an integrated approach for effective management, including diet, physical activity and appropriate supplements. Early awareness and treatment are essential for improving reproductive health and reducing the risks of long-term complications.

**Keywords:** *polycystic ovary syndrome, inositol, diet, pregnancy.*

# KUJDESI INFERMIEROR PËR FËMIJËT E LINDUR PARAKOHE NË NJËSINË INTENSIVE

**AFËRDITA LAHU [1] ÇLIRIM LAHU [1] LIRIE HASANI [2]**

*[1] Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca", Kosovo*
*[1] Çlirim Lahu, RN; [2] Lirie Hasani ,RN*
*E-mail: aferdita.lahu@rezonanca-rks.com*

**Hyrje:** Foshnjat e lindura para kohe paraqesin një sfidë për stafin infermieror dhe kërkojnë kujdes të veçantë për mbijetesë. Foshnjet e lindura para kohe janë një nga çështjet më delicate me të cilat ballafaqohet stafi i infermierëve brenda spitaleve. Lindjent e parakohshme mund të vijnë si pasoj e shumë indikatorëve dhe komplikimeve gjatë shtatëzanisë, por foshnjet të cilat i mbijetojnë lindjes së parakohëshme duhet të trajtohen me një kujdes të veçant dhe shumë përgjegjësi.
**Qëllimi:**Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtohen detyrat dhe përgjegjësitë e stafit infermieror në ofrimin e kujdesit intenziv për foshnjat e lindura prematur, si dhe të theksohet rëndësia e këtij kujdesi për shëndetin e foshnjave.
**Materialet dhe Metodat:** Ky hulumtim shkencor do të shkruhet duke përdorur metodologjinë shkencore të kërkimit kuantitativ.
Ky hulumtim do të përdorë metodologjinë kuantitative, duke mbledhur të dhëna përmes anketave me infermierët e gjinekologjisë në QKUK. Formulari përfshin 9 pyetje, 4 demografike dhe 6 profesionale. Studimi do të përfshijë 15 infermierë të neonatologjisë.
**Rezultatet:** Ky hulumtim ka për qëllim të ofrojë rezultate që do të mundësojnë të vlerësohet se stafi infermieror në Kosovë është i kualifikuar për detyrat që kryen, megjithatë ka sfida të mëdha për sa i përket mungesës së pajisjeve mjekësore, dhe shpesh janë të detyruar të improvizojnë me resurset që kanë.
**Diskutimi:** Rëndësia e kujdesit infermieror për foshnjat e lindura para kohe është diskutuar, duke theksuar vështirësitë që has stafi infermieror gjatë këtij procesi. Gjithashtu, janë shqyrtuar modelet që mund të jenë më të suksesshme për përmirësimin e kujdesit ndaj foshnjave të lindura prematur.
**Përfundimet:** Nga shqyrtimi i literaturës dhe nga studimi në terren, mund të thuhet se përgjegjësitë e stafit infermieror në klinikën e neonatologjisë janë të ndërlidhura ngushtë me nevojat e pacientëve. Infermierët ofrojnë gjithashtu mbështetje emocionale për familjarët dhe prindërit, edhe pse ky shërbim nuk është i detyrueshëm nga kontrata e punës.
**Fjalët kyçe:** *Kujdesi intensiv, infermierët, foshnjat, premature*

# NURSING CARE FOR PREMATURELY BORN CHILDREN IN THE INTENSIVE CARE UNIT

**AFËRDITA LAHU[1], ÇLIRIM LAHU[1], LIRIE HASANI[2]**

*[1] Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca," Kosovo: PhD Can*

*[1]Çlirim Lahu, RN; [2]Lirie Hasani, RN*

*[1]Corresponding Author: aferdita.lahu@rezonanca-rks.com*

**Introduction:** Premature babies present a challenge for nursing staff and require special care for survival. Premature babies are one of the most delicate issues faced by nursing staff within hospitals. Premature births can occur as a result of many indicators and complications during pregnancy, but babies who survive premature birth should be treated with special care and great responsibility.

**Objective:** The purpose of this research is to examine the duties and responsibilities of nursing staff in providing intensive care for premature babies, as well as to emphasize the importance of this care for the health of babies.

**Materials and Methods:** This scientific research will be written using the scientific methodology of quantitative research.This research will use the quantitative methodology, collecting data through surveys with gynecology nurses at UCCK. The form includes 9 questions, 4 demographic and 6 professional. The study will include 15 neonatology nurses.

**Results:** This research aims to provide results that will allow us to assess whether the nursing staff in Kosovo is qualified for the tasks they perform, however, there are major challenges in terms of the lack of medical equipment, and they are often forced to improvise with the resources they have.

**Discussion:** The importance of nursing care for premature babies is discussed, highlighting the difficulties that nursing staff encounter during this process. Also, models that may be more successful for improving care for premature babies are examined.

**Conclusions:** From the literature review and the field study, it can be said that the responsibilities of nursing staff in the neonatology clinic are closely related to the needs of patients. Nurses also provide emotional support to family members and parents, although this service is not mandatory by the employment contract.

**Keywords:** *Intensive care, nurses, infants, premature*

# ROLI I MAMIVE NË PROMOVIMIN E INOVACIONIT NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PËR NËNAT DHE FËMIJËT

**BESARTA PELAJ[1], DIJANA BEQA[2], FATIME ZENELI [3], KUMRIJE EMRA [4]**

*Profesor Ass. Dr. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Mjekësisë[1]*
*Ass. Praktikë Klinike, Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë, Fakulteti i Mjekësisë, Gjakovë, Kosovë[2],*
*Spitali Rajonal ''Isa Grezda" Gjakovë, Kosovë[2]*
*Qendra Klinike Universiotare- Klinika Gjinekologjisë- Prishtinë[3]*
*Spitali Rajonal- Pejë, Kosovë[4]*

**Hyrje:** Mamiat luajnë një rol kyç në sistemin shëndetësor, duke ofruar kujdes thelbësor për gratë shtatzëna, nënat dhe foshnjat. Përveç ndihmës gjatë lindjes, ato ofrojnë këshillim, mbështetje emocionale dhe edukim për shëndetin riprodhues. Përveç ofrimit të kujdesit klinik, mamitë janë gjithashtu lidere të inovacionit, duke ndihmuar në zhvillimin dhe zbatimin e praktikave të reja për të përmirësuar shëndetin maternalë dhe neonatal.

**Qëllimi**: Ky studim ka si qëllim të analizojë rolet dhe përgjegjësitë e mamive në promovimin dhe implementimin e inovacioneve në kujdesin shëndetësor për nënat dhe foshnjat. Gjithashtu, synon të identifikojë sfidat dhe mundësitë që ato hasin gjatë procesit të inovacionit.

**Metodologjia**: Studimi do të ndjekë një qasje të kombinuar duke përfshirë analizën e literaturës, administrimin e një pyetësori me mamitë për të vlerësuar rolin dhe kontributin e tyre në kujdesin dhe inovacionin shëndetësor**.**

**Diskutim**: ky hulumtim ofron një analizë të detajuar mbi rolin e mamive në përmirësimin e kujdesit për nënat dhe foshnjat përmes inovacionit dhe lidershipit. Pavarësisht rëndësisë së tyre, ato shpesh përballen me mungesë burimesh dhe mbështetje institucionale, çka ndikon në efektivitetin e punës së tyre.

**Rezultatet:** tregojnë se mamitë luajnë një rol kyç si në promovimin, kujdesin ndaj foshnjës dhe nënës, poashtu edhe ne inovacion, edhe përkundër asaj se ato po përballen me mungesa dhe sfida të shumta, gjatë keti hulumtimi u identifikua mungesë të mbështetjes profesionale, por një numer i madh i të anketuarve konsiderojnë rolin e mamive shumë të rëndësishëm në promovim të inovacionit në kujdesin për nënat dhe foshnjat**.**

**Përfundim:** Rritja e investimeve në arsimimin, trajnimet dhe mbështetjen e mamiave mund të përmirësojë ndjeshëm kujdesin shëndetësor për gratë dhe foshnjat. Politikat e duhura dhe kushtet më të mira të punës do të ndihmojnë në rritjen e cilësisë së shërbimeve që ato ofrojnë.

**Fjalë kyçe:** *Mamiat, kujdesi shëndetësor, shëndeti i nënës dhe fëmijes, inovacioni*

# THE ROLE OF MIDWIFE IN PROMOTING INNOVATION IN MATERNAL AND CHILD HEALTH CARE

**BESARTA PELAJ[1], DIJANA BEQA[2], FATIME ZENELI[3], KUMRIJE EMRA[4]**

*Ass. Professor Dr. University of Prishtina "Hasan Prishtina" Faculty of Medicine[1]*
*Ass. Clinical Practice, "Fehmi Agani" University Gjakova, Faculty of Medicine, Gjakova, Kosovo[2],*
*Regional Hospital ''Isa Grezda" Gjakova, Kosovo[2]*
*University Clinical Center- Clinic of Gynecology- Prishtina[3]*
*Regional Hospital- Peja, Kosovo[4]*

**Introduction:** Midwives play a key role in the health system, providing essential care for pregnant women, mothers and babies. In addition to assisting during childbirth, they provide counseling, emotional support and education on reproductive health. In addition to providing clinical care, midwives are also innovation leaders, helping to develop and implement new practices to improve maternal and neonatal health.

**Purpose:** This study aims to analyze the roles and responsibilities of midwives in promoting and implementing innovations in maternal and newborn health care. It also aims to identify the challenges and opportunities they face during the innovation process.

**Methodology:** The study will follow a combined approach including literature review, administering a questionnaire to midwives to assess their role and contribution to health care and innovation.

**Discussion:** This research provides a detailed analysis of the role of midwives in improving maternal and newborn care through innovation and leadership. Despite their importance, they often face a lack of resources and institutional support, which affects the effectiveness of their work.

**Results:** show that midwives play a key role in promoting, caring for babies and mothers, as well as in innovation, and despite the fact that they are facing numerous shortcomings and challenges, during this research a lack of professional support was identified, but a large number of respondents consider the role of midwives very important in promoting innovation in caring for mothers and babies.

**Conclusion**: Increasing investments in the education, training and support of midwives can significantly improve health care for women and babies. The right policies and better working conditions will help increase the quality of the services they provide.

**Keywords:** *Midwives, health care, maternal and child health, Innovation.*

# SFIDAT E USHQYERJES ME GJI SOT. MBËSHTETJA DHE EDUKIMI NGA PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË

**ANJEZA KOLANECI[1]**

*[1] – Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë”" Tirana, Albania*
*[1]Mbikqyrës i Praktikave Klinike, FSHMT, Tirana, Albania*

**Hyrje :**Sfidat e ushqyerjes me gji sot! Mbështetja dhe edukimi nga profesionistët e shëndetësisë" ka për qëllim të ofrojë njohuri dhe mjete praktike për profesionistët e shëndetësisë, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes dhe edukimit në procesin e ushqyerjes me gji**.** Ky trajnim synon të ndihmojë nënat në kapërcimin e sfidave të ndryshme që lidhen me ushqyerjen me gji dhe t’u ofrojë profesionistëve të shëndetësisë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të ofruar mbështetje të efektshme. Duke u fokusuar në rëndësinë e këshillimit profesional, qasjes së individualizuar dhe përdorimit të praktikave të bazuara në prova shkencore, trajnimet do të ndihmojnë në rritjen e besimit të nënave dhe përmirësimin e shëndetit të foshnjave.

Gjithashtu, do të trajtohen tematika të rëndësishme si teknikat e duhura të vendosjes në gji, sfidat e zakonshme si dhimbjet apo mungesa e qumështit të mjaftueshëm, si dhe rëndësia e një mbështetjeje të vazhdueshme nga familja dhe komuniteti. Në këtë mënyrë, profesionistët do të jenë më të përgatitur për të dhënë këshillim cilësor dhe për të inkurajuar një qasje pozitive ndaj ushqyerjes me gji.

**Qëllimi** kryesor i këtij trajnimi është të rrisë ndërgjegjësimin dhe aftësitë e profesionistëve të shëndetësisë në lidhje me sfidat që nënat përballen gjatë ushqyerjes me gji dhe rëndësinë e mbështetjes dhe edukimit për të promovuar ushqyerjen ekskluzive me gji.

**Objektivat :**Të identifikohen sfidat kryesore që lidhen me ushqyerjen me gji në kontekstin e shoqërisë moderne.Të shqyrtohen faktorët që ndihmojnë dhe pengojnë nënat në ushqyerjen me gji, si mbështetja sociale, edukimi dhe disponueshmëria e informacionit.

**Rekomandimet:** Të forcohet mbështetja institucionale dhe shoqërore për nënat, përmes krijimit të grupeve mbështetëse dhe ofrimit të shërbimeve të këshillimit dhe edukimit.Profesionistët e shëndetësisë duhet të promovojnë më shumë edukimin dhe ndërgjegjësimin për përfitimet e ushqyerjes me gji, duke siguruar informacion të saktë dhe të përditësuar për nënat. Të sigurohet që mjedisi shëndetësor ofron mbështetje të vazhdueshme për nënat, përfshirë këshilla praktike dhe ndihmë gjatë periudhës së para dhe pas lindjes.

Të inkurajohen fushatat e ndërgjegjësimit publik për të luftuar mitet dhe pasigurinë që mund të shoqërojnë ushqyerjen me gji, duke promovuar vlera dhe praktika të shëndetshme.

**Fjale kyçe**: *ushqyerjen me gji, nëna, promovim, gjidhënie.*

# CHALLENGES OF BREASTFEEDING TODAY
# SUPPORT AND EDUCATION FROM HEALTH PROFESSIONALS

**ANJEZA KOLANECI[1]**

[1] *Obstetrics & Gynecology University Hospital "Queen Geraldine" Tirana, Albania*
[2] *Nursing/Midwifery Clinical Supervisor, FSHMT, Tirana, Albania*

**Introduction:** Breastfeeding Challenges Today! Support and Education from Health Professionals" aims to provide knowledge and practical tools for health professionals, emphasizing the importance of support and education in the breastfeeding process.

This training aims to help mothers overcome various challenges related to breastfeeding and to provide health professionals with the skills and knowledge necessary to provide effective support. By focusing on the importance of professional counseling, individualized approach and the use of evidence-based practices, the trainings will help increase mothers' confidence and improve infant health.

Important topics such as proper breastfeeding techniques, common challenges such as pain or lack of sufficient milk, as well as the importance of ongoing support from family and community will also be addressed. In this way, professionals will be better prepared to provide quality counseling and encourage a positive approach to breastfeeding.

**Objective:** The primary goal of this training is to raise awareness and enhance the skills of healthcare professionals regarding the challenges mothers face during breastfeeding and the importance of support and education to promote exclusive breastfeeding. To identify the main challenges related to breastfeeding in the context of modern society. To examine the factors that help and hinder mothers in breastfeeding, such as social support, education, and availability of information.

**Recommendations:** Strengthen institutional and societal support for mothers through the creation of support groups and the provision of counseling and educational services.

Healthcare professionals should further promote education and awareness about the benefits of breastfeeding by providing accurate and up-to-date information to mothers.

Ensure that healthcare environments offer continuous support for mothers, including practical advice and assistance during the pre- and postnatal periods.

Encourage public awareness campaigns to combat myths and uncertainties surrounding breastfeeding, promoting healthy values and practices.

**Keywords**: *breastfeeding, mother, promotion, breastfeeding.*

# MENAXHIMI I LINDJEVE EMERGJENTE NË KUJDESIN PARASPITALOR: NJË ANALIZË PRAKTIKE DHE STRATEGJI NDËRHYRJEJE

**INDRIT JAUPAJ[1] , SKËNDER BRATAJ[2]**

[1] *Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Kryeinfermier*
[2] *Drejtor i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore,Mjek*
*Email:indritjaupajij@gmail.com*

**Hyrje:** Lindjet emergjente jashtë spitalit përbëjnë një sfidë të rëndësishme për ekipet paraspitalore, duke kërkuar njohuri të avancuara dhe reagim të shpejtë për të siguruar një rezultat pozitiv për nënën dhe foshnjën. Në situata të tilla, kujdesi i ofruar nga personeli i urgjencës mjekësore duhet të jetë i shpejtë, i koordinuar dhe i bazuar në protokollet më të fundit të trajtimit obstetrik.Komplikacionet obstetrike, si distocia e shpatullës, hemorragjia postpartum, prolabimi i kordonit ombilikal, lindja e parakohshme dhe asfiksia neonatale, mund të jenë kërcënuese për jetën dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe të sakta. Në këto raste, profesionistët e kujdesit paraspitalor duhet të jenë të përgatitur për të identifikuar shpejt gjendjen e pacientit, për të siguruar stabilizimin fillestar dhe për të ndërmarrë masa të duhura për të parandaluar përkeqësimin e situatës.Gjithashtu, koordinimi efektiv me njësitë spitalore dhe transporti i sigurt i pacientes drejt një qendre të specializuar është një element kyç në përmirësimin e rezultateve klinike.

**Qëllimi:** Ky studim synon të analizojë praktikat aktuale të menaxhimit të lindjeve emergjente në kujdesin paraspitalor, të identifikojë sfidat kryesore dhe të propozojë strategji për optimizimin e ndërhyrjeve në terren.

**Metodologjia:** Studimi është hartuar si një studim kros-seksional, duke analizuar të dhënat e rasteve të lindjeve emergjente të menaxhuara nga ekipet e urgjencës paraspitalore. Burimet e të dhënave përfshijnë: Rishikimin e protokolleve ekzistuese për lindjet emergjente.

Analizën e rasteve reale të regjistruara nga qendrat e urgjencës.

Intervistat me personelin e urgjencës për të vlerësuar përvojën dhe sfidat e hasura në terren.

Të dhënat janë analizuar për të identifikuar frekuencën e komplikacioneve, kohën e reagimit dhe efektivitetin e masave të ndërmarra në raport me rezultatet klinike.

**Konkluzionet:** Rezultatet e studimit tregojnë se menaxhimi i suksesshëm i lindjeve emergjente lidhet ngushtë me trajnimin e vazhdueshëm të ekipeve të urgjencës, përdorimin e protokolleve të standardizuara dhe aksesin e shpejtë në pajisje dhe medikamente thelbësore. Disa nga komplikacionet më të shpeshta përfshijnë distocinë e shpatullës, hemorragjinë postpartum dhe asfiksinë neonatale. Një pjesë e konsiderueshme e pacienteve kanë kërkuar transport urgjent në spital për kujdes të mëtejshëm.

**Fjalë kyçe:** *suport gjatë lindjes, kujdes obstetrik, përvoja e lindjes, shëndeti materno-fetal.*

# MANAGEMENT OF EMERGENCY BIRTH IN PREHOSPITAL CARE: A PRACTICAL ANALYSIS AND INTERVENTION STRATEGIES

**INDRIT JAUPAJ[1] , SKËNDER BRATAJ[2]**

*[1]National Emergency Medical Center, Chief Nurse*
*[2] Director of National Emergency Medical Center,Doctor*
*Email:indritjaupajij@gmail.com*

**Introduction:** Emergency births outside the hospital pose a significant challenge for prehospital teams, requiring advanced knowledge and rapid response to ensure a positive outcome for the mother and baby. In such situations, the care provided by emergency medical personnel must be rapid, coordinated and based on the latest obstetric treatment protocols. Obstetric complications, such as shoulder dystocia, postpartum hemorrhage, umbilical cord prolapse, preterm birth and neonatal asphyxia, can be life-threatening and require immediate and accurate interventions. In these cases, prehospital care professionals must be prepared to quickly identify the patient's condition, ensure initial stabilization, and take appropriate measures to prevent the situation from worsening. Also, effective coordination with hospital units and safe transport of the patient to a specialized center is a key element in improving clinical outcomes.

**Purpose:** This study aims to analyze current practices of emergency birth management in prehospital care, identify key challenges, and propose strategies for optimizing interventions in the field.

**Methodology:** The study was designed as a cross-sectional study, analyzing data on emergency birth cases managed by prehospital emergency teams. Data sources include review of existing protocols for emergency births.

Analysis of real cases registered by emergency centers.

Interviews with emergency personnel to assess experience and challenges encountered in the field.

Data were analyzed to identify the frequency of complications, response time, and effectiveness of measures taken in relation to clinical outcomes.

**Conclusions:** The study results show that successful management of emergency births is closely related to continuous training of emergency teams, the use of standardized protocols, and rapid access to essential equipment and medications. Some of the most common complications include shoulder dystocia, postpartum hemorrhage, and neonatal asphyxia. A significant proportion of patients required emergency transport to the hospital for further care.

**Keywords:** *support during labor, obstetric care, birth experience, maternal-fetal health.*

# KUJDESI I PERSONELIT INFERMIEROR NË REANIMACION PËR GRUAN SHTATZËNE

**EUGEN ISMOLLI[1]**
[1]*Kryeinfermier ne Repartin e Terapise Intensive, Spitali Amerikan 3*
eugenismolli9@gmail.com

**Hyrje:** Shtatzania sjell ndryshime fiziologjike të rëndësishme në trupin e gruas, të cilat kërkojnë një vëmendje dhe kujdes të veçantë nga personeli infermieror, veçanërisht kur gruaja shtatzënë ndodhet në terapi intensive. Ky kujdes është thelbësor për ruajtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës, duke u mbështetur në protokolle dhe parime të përcaktuara të trajtimit infermieror.
**Materiali dhe Metoda:** Kujdesi infermieror për gruan shtatzënë në kushte të terapisë intensive mbështetet në protokolle të ngjashme me ato të pacientëve të tjerë në gjendje kritike, por me një fokus të veçantë për ndryshimet fiziologjike që ndodhin gjatë shtatzënisë. Infermierët monitorojnë vazhdimisht parametrat vitalë dhe ndihmojnë në zbatimin e planit të trajtimit të përshtatur për nevojat e gruas shtatzëne.
**Diskutimi:** Shtatzania sjell ndryshime të shumta fiziologjike që ndikojnë në sistemet kardio-vaskulare, respiratore dhe hematologjike. Ndryshimet kardio-vaskulare përfshijnë rritjen e frekuencës kardiake dhe debiti kardiak, si dhe uljen e rezistencës vaskulare periferike, që është pasojë e veprimit të progesteronit. Gjatë shtatzënisë, ka gjithashtu një rritje të konsumit të oksigjenit dhe një mundësi për zhvillimin e alkalozës respiratore për shkak të ndryshimeve në frymëmarrje. Ndryshimet hematologjike, si rritja e volumit të gjakut dhe anemisë dilutive, janë gjithashtu të zakonshme. Ndërsa sistemi nervor ndikon në rritjen e nivelit të endorfinave, ndihmës të cilat ndikojnë në ndjenjat e mirëqenies. Gjatë përdorimit të anestezisë spinale, kujdesi duhet të jetë i veçantë për të siguruar dozën e duhur, pasi distensioni i venave epidurale mund të shkaktojë komplikime. Për më tepër, rritja e presionit intraabdominal dhe fluksi i gjakut në veshka janë faktorë të tjerë që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm.
**Konkluzioni:** Kujdesi infermieror për gratë shtatzëna në terapi intensive është shumë i specifikuar dhe kërkon një vëmendje të veçantë për të menaxhuar komplikimet kryesore që mund të ndodhin, përfshirë hipertensionin, hemoragjinë postpartum, arestin kardiak gjatë shtatzënisë dhe sindromën HELLP. Trajtimi dhe monitorimi i këtyre komplikimeve është thelbësor për ruajtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Për këtë arsye, kujdesi infermieror duhet të jetë i organizuar dhe i detajuar, duke ndjekur protokolle të sakta dhe të përshtatura për çdo rast.
**Fjalët kyçe:** *Terapia intensive, shtatzëni, kujdes infermieror*

# NURSING CARE IN THE INTENSIVE CARE UNIT FOR PREGNANT WOMEN

**EUGEN ISMOLLI**
*Head Nurse, Intensive Care Unit, American Hospital 3*
eugenismolli9@gmail.com

**Introduction**: Pregnancy brings significant physiological changes in a woman's body, which require special attention and care from nursing staff, especially when the pregnant woman is in intensive care. This care is crucial for maintaining the health of both the mother and the baby, relying on established protocols and principles of nursing care.

**Materials and Methods**: Nursing care for pregnant women in intensive care settings follows protocols similar to those for other critically ill patients, but with a specific focus on the physiological changes that occur during pregnancy. Nurses continuously monitor vital parameters and assist in implementing treatment plans tailored to the needs of the pregnant woman.

**Discussion**: Pregnancy causes numerous physiological changes affecting the cardiovascular, respiratory, and hematological systems. Cardiovascular changes include an increase in heart rate and cardiac output, along with a decrease in peripheral vascular resistance due to the action of progesterone. During pregnancy, there is also an increase in oxygen consumption, and a potential development of respiratory alkalosis due to changes in breathing patterns. Hematological changes such as increased blood volume and dilutional anemia are common. The nervous system is affected by elevated endorphin levels, which contribute to a sense of well-being. During spinal anesthesia, care must be taken to administer the correct dosage, as the distention of the epidural veins can lead to complications. Additionally, increased intra-abdominal pressure and blood flow to the kidneys are factors that require continuous monitoring.

**Conclusion**: Nursing care for pregnant women in intensive care is highly specialized and requires particular attention to manage the primary complications that may arise, including hypertension, postpartum hemorrhage, cardiac arrest during pregnancy, and HELLP syndrome. The treatment and monitoring of these complications are essential for preserving the health of both the mother and the baby. Therefore, nursing care must be well-organized and detailed, following accurate and tailored protocols for each case.

**Keywords**: *Intensive care, Pregnancy, Nursing care*.

# INFEKSIONET E LIDHURA ME KUJDESIN SHËNDETËSOR NË NJËSINE E KUJDESIT INTENZ]SIV NEONATAL: NJË RISHIKIM I SHPEJTË SISTEMATIK I LITERATURËS

**BEHRIJE HALILAJ-VISHI [1], IMRI VISHI [1], MINIRE ALILAJ-BEQIRAJ [2]**

*[1] Universiteti AAB, Departmenti i infermierise, Prishtine –Kosove*
*[2] Angela Boškin- Fakulteti i Kujdesit Shëndetësor, Spodnji Plavž 3, 4270 Jesenice, Slloveni*
*[3] Spitali i Pergjithshem Ferizaj-Departamenti i Kirurgjise dhe Gjinekologjise*
*Correspondence: behrije.halilaj-vishi@universitetiaab.com ,infermiere e pergjithshme,Spitali i Pergjithshem Ferizaj.*

**Hyrje:** Rritja e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, kohëzgjatja e qëndrimit dhe rritja e kostove mjekësore tregojnë infeksione të lidhura me kujdesin shëndetësor në njesine e kujdesit intenziv ne neonatologji (NICU). Të porsalindurit janë në rrezik të lartë për marrjen e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor për shkak të mekanizmave të dëmtuar të mbrojtjes, sasive të kufizuara të florës mbrojtëse endogjene në lëkurë dhe sipërfaqet mukozale në lindje, përdorimit të procedurave të ndryshme dhe pajisjeve invazive dhe përdorimit të shpeshtë të antibiotikëve me spektër të gjerë.
**Qëllimi:** Qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë vlerësimi dhe identifikimi i incidencës, vdekshmërisë, faktorëve të rrezikut, organizmave shkaktarë dhe modelet e tyre të ndjeshmërisë antimikrobike në NICU.
**Metodologjia**: U krye një rishikim sistematik i literaturës së kërkimit cilësor. Dokumentet e publikuara në revista shkencore në anglisht nga viti 2012 deri në vitin 2022 u kërkuan në bazat e të dhënave PubMed (MEDLINE), CINAHL dhe ProQuest. Rezultatet u analizuan me një analizë tematike të gjetjeve cilësore të hulumtimit.
**Rezultatet:** Rezultatet e marra tregojnë një incidencë dhe prevalencë të lartë të infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor në njësinë e kujdesit intensiv neonatal. Kohëzgjatja e qëndrimit në spital paraqet rrezik për shfaqjen e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor. Përdorimi i pajisjeve të tilla si ventilatori, vena qendrore, kateteri urinar, si dhe plaget kirurgjikale janë gjithashtu faktorë rreziku për shfaqjen e infeksioneve intraspitalore.
**Konkluzionet**: Prevalenca e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor është një problem i rëndësishëm i shëndetit publik. Prevalenca më e lartë është vërejtur në repartet e kujdesit intensive, në repartin e pediatrisë, në repartin e kirurgjisë dhe atë të obstetrikës. Infeksionet spitalore përbënin një shkallë të lartë të incidencës të cilat lidheshin me pajisjet me të cilat ishin lidhur pacientët, si ventilatori, vena qendrore, kateteri urinar etj. Të porsalindurit përfaqësojnë një popullatë specifike me rrezik më të madh për HCAI. Të gjithë pacientët që kishin qëndruar më gjatë në spital, shfaqja e infeksioneve intraspitalore ishte më e lartë. Politikëbërësit dhe zyrtarët e programit duhet të fuqizojnë dhe kontrollojnë strategjitë në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.
**Fjalëtkyce:***infeksionet,kujdesi shendetesor,kujdesi intenziv,neonatet,incidenca,prevalenca*

# HEALTH CARE-ASSOCIATED INFECTIONS IN NEONATAL INTENSIVE CARE UNIT: A RAPID SYSTEMATIC LITERATURE REVIEW

**BEHRIJE HALILAJ-VISHI PHD.C [1], IMRI VISHI [2],MINIRE ALILAJ-BEQIRAJ [2]**

*[1] AAB University ,Nursing Department ,Prishtina-Kosovo*
*[2] Angela Boškin Faculty of Health Care, Spodnji Plavž 3, 4270 Jesenice, Slovenija*
*[3] General Hospital Ferizaj-Surgery and Gynecology Departament*
*Correspondence: behrije.halilaj-vishi@universitetiaab.com ,RN ,General Hospital Ferizaj*

**Introduction:** Increased morbidity and mortality, length of stay, and increased medical costs indicate healthcare-associated infections in the NICU. Newborns are at high risk for acquiring healthcare-associated infections due to impaired host defense mechanisms, limited amounts of endogenous protective flora on the skin and mucosal surfaces at birth, the use of various procedures and invasive devices, and frequent use of broad-spectrum antibiotic agents.

**Aim:** The aim of this research will be to estimate and identify the incidence, mortality, risk factors, causative organisms and their antimicrobial susceptibility patterns in NICU.

**Methodology**: A systematic literature review of qualitative research was conducted. Documents published in scientific journals in English from 2012 to 2022 were searched in PubMed (MEDLINE), CINAHL and ProQuest databases. The results were analysed with a thematic analysis of qualitative research findings.

**Results:** The obtained results show a high incidence and prevalence of health care-associated infections in the neonatal intensive care unit. The length of stay in the hospital represents a risk for the appearance of health care-associated infections. The use of equipment such as ventilator, central vein and urinary catheter, and surgical are also risk factors for the appearance of Intrahospital infections.

**Conclusions:**The prevalence of healthcare-associated infections is an important public health problem. The highest prevalence was observed in the intensive care wards, the pediatric ward, the surgical ward and the obstetric ward. Hospital infections constituted a high incidence rate which were related to the equipment to which the patients were connected, such as the ventilator, central vein, urinary catheter, etc. Newborns represent a specific population with a greater risk for HCAI. All patients who had stayed longer in the hospital, the occurrence of intrahospital infections was higher. Policymakers and program officials should empower and control strategies at all levels of health care.

**Keywords**: *infections, health care, intensive care, neonates, incidence, prevalence*

# PERCEPTIMI I MAMIVE MBI ROLIN E TYRE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR

**FATIME ZENELI[1], BESARTA PELAJ[2]**

*[1]Lektore e Mamisë dhe Infermierisë - Kolegji i Shkencave Mjekësore "AMECC Rezonanca" Prishtinë*
*[2] Proff.e Asociuar ,Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë*

**Hyrje**: Roli i mamisë në Kosovë nuk është plotësisht i definuar, çfarë ka bërë që efektiviteti i profesionit të zvogëlohet dhe bashkëpunimi brenda ekipit të përballet me sfida. Mungesa e të kuptuarit të rolit të mamisë në Sistemin e Kujdesit Shëndetësor të Kosovës, dhe vlera e tij profesionale ka bërë që profesioni të zvogëlojë vlerat e tij, dhe maminë të mos ketë rol të lartë në krahasim merolin e tyre te pershkruar nga OBSH (2024) dhe ICM (2017).
**Qëllimi:** Të eksplorohet dhe të përshkruhet roli i mamisë në kujdesin për gratë, brenda Sistemit të Kujdesit Shëndetësor të Kosovës
**Metodat**: Për këtë studim u përdor një dizajn kërkimor cilësor përshkrues. Popullata e hulumtimit përfshinte mamitë që punonin në qendrat klinike të kujdesit ndaj grave. Është përdorur kampionimi i rastësishëm dhe është marrë kampion prej 250 mami, që punojnë në shërbimet shëndetësore të grave. Për mbledhjen e të dhënave u zhvillua një pyetësor i strukturuar. Pyetësori përbëhej nga tre seksione: Informacioni demografike te pjesëmarrësve, Perceptimet e pjesëmarrësve për rolin e tyre në kujdesin e grave, Mendimet e pjesëmarrësve mbi barrierat profesionale. Është marrë miratimi etik për kryerjen e hulumtimit.
**Rezultatet:** Përgjigjet e mamive në pyetje treguan se mungesa e përfshirjes së mamive në vendimmarrje në kujdesin ndaj gruas, ku pjesa më e madhe e kujdesit të dhënë është siç përshkruhet nga mjekët, dhe ka përgjigje të vogla që i përshkruajnë mamitë si pjesëmarrje aktive në kujdesin e dhënë. Përgjigjet e mamive të përfshira në studim treguan mungesë të fuqizimit profesional nga politikat politike dhe menaxheriale.
**Konkluzioni:** Roli i mamisë në kujdesin shëndetësor duhet të fuqizohet, duke angazhuar strategji në përmbushjen e kompetencave të tyre si profesionale, përmes trajnimeve të strukturuara, siç jepet nga ICM -ja. Është e rëndësishme të rishikohet rëndësia e profesionit të mamisë, siç njihet në botë, dhe të rritet ndërgjegjësimi për përfitimet e forcimit të rolit të mamisë në kujdesin shëndetësor.
**Fjala kyçe:** *Mami, rol, profesion, kujdes shëndetësor*

# MIDWIFE PERCEPTION ON THEIR ROLE IN HEALTH CARE

**FATIME ZENELI[1], BESARTA PELAJ[2]**

[1]*Lecturer of Midwifery and Nursing - Collage of Medical Science "AMECC Rezonanca "Prishtine*
[2] Prof ass. *University of Prishtina, Medical Faculty*

**Introduction:** The role of midwife in Kosovo is not fully defined, what has led to profession effectiveness to diminish, and collaboration within team to face challenges.The lack of understanding midwife role within Kosovo Health Care System, and its professional value has led to profession diminishing its values, and midwifes lack of their role and integrity in comparison with midwife role as it is highlighted by WHO(2024) and ICM ( 2017).

**Aim:** To explore and describe midwifes role in care for women, within Kosovo Health Care System

**Methods:** A qualitative descriptive research design was used for this study. The research population included the midwives who were working in clinical centers of woman care. Random sampling was used and sample of 250 midwives, working in women health services was obtained. A structured questionnaire was developed to collect the data. The questionnaire consisted of three sections: Participants' demographic information, Participants' perceptions of their role in women's care, Participants' thoughts on professional barriers. Ethical approval to conduct the research was obtained.

**Results:** Midwifes responses to questions showed that lack of involvement of midwifes in decision making in woman care, where most of the care given is as prescribed by physicians, and there is small answers prescribing midwifes as active participation in the care given. Answers of midwifes involved in the study showed lack of professional empowerment by political and managerial policies.

**Conclusion:** Midwife role in Health Care should be empowered, by engaging strategies in fulfilment of their competencies as professional, through structured training, as given by IMC. It is of importance to reconsider importance of midwife profession, as it is known world while, and enhance awareness of benefits of strengthening the role of midwifes in Health Care

**Key word:** *Midwifes role, profession, health care*

# VLERËSIMI INFERMIEROR I SIMPTOMAVE MENOPAUZALE, PRAKTIKAVE TË VETKUJDESIT DHE NDIKIMI I TYRE NË PRODUKTIVITETIN NË PUNË TË GRAVE NË RRETHIN E VLORËS

**ENTELA HAXHILLARI**[1]
[1]*Infermiere-mami*

**Hyrje:** Vitet e fundit, për shkak të rritjes së jetëgjatësisë menopauza dhe simptomat e saj janë më të theksuara te të gjitha gratë mbarë botën. Kërkimet shkencore kanë treguar se praktikat e vetkujdesit dhe përfshirja e grave në zbatimin e tyre sjell një ulje të ndjeshme të ashpërsisë së simptomave dhe përmirësim të dukshëm në kualitetin e jetës.
**Qellimi:** Vleresimi infermieror i simptomave menopauzale dhe impakti i tyre ne cilesine e jetes dhe produktivitetit ne pune te grave ne rrethin e Vlores.
**Metodologjia:** Ky është një studim kros-seksional, i cili përfshiu 126 gra të moshës 40-65 vjeç që vizitonin kujdesin parësor në qendrën shëndetësore nr 4 në qytetin e Vlorës për arsye gjinekologjike dhe jo-gjinekologjike, gjatë periudhës prill-qershor 2023. Në instrumentat matës për matjen e shkallës së ashpërsisë së simptomave dhe cilësinë e jetës u përdor pyetësori i cilësisë së jetës në menopauzë MENQOL. Për vlerësimin e praktikave të vetkujdesit u hartua një listë e përbërë prej 12 pyetjesh lidhur me praktika të ndryshme vetkujdesi që mund të përdorin gratë në periudhën e menopauzës, i adaptuar nga pyetesori i standartizuar i OBSH Menopausal Assessment Tool.
**Rezultatet:** Gjetjet e studimit zbuluan se ka një shkallë të konsiderueshme të ashpërsisë së simptomave menopauzale të përjetuara $3.28 \pm 1.33$ me predominim të afsheve të nxehta dhe skuqjes me 4.8 pikë, ndjenjë ankthi me 4.2 pikë, dhimbje mesi me 4.5 pikë dhe pakësim të dëshirës seksuale me 3.9 pikë. Gratë me nivel të lartë simptomash vasomotore kanë patur dëmtim të lartë në punë, 44.7%, ( $p=0.000$). Gratë më shkallë të lartë të simptomave psikosociale kanë pasur dëmtim të lartë në punë, 50 % ( $p=0.037$). U vu re se ka një përqindje të ulët të grave që përdornin aktivitetin fizik si praktikë vetkujdesi, ndërkohë që dominon dieta e shëndetshme dhe produktet bimore.
**Konkluzione:** Rezultatet e këtij studimi shërbyen si një evidencë që hedh dritë mbi lidhjen që ekziston mes simptomave të menopauzës dhe produktivitetit në punë në rrethin e Vlorës, duke patur parasysh që të dhëna të tilla ne Shqipëri janë të kufizuara.
**Fjalet kyce:** *menopauza, simptomat, cilësia e jetës, praktikat e vetëkujdesit.*

# NURSING ASSESSMENT OF MENOPAUSAL SYMPTOMS, SELF-CARE PRACTICES AND THEIR IMPACT ON WORK PRODUCTIVITY AMONG WOMEN IN THE VLORA REGION

**ENTELA HAXHILLARI**[1]

[1]*Nurse-Midwife*

**Introduction:** In recent years, due to increased life expectancy, menopause and its symptoms are more pronounced in all women around the world. Scientific research has shown that self-care practices and the involvement of women in their implementation lead to a significant reduction in the severity of symptoms and a significant improvement in the quality of life.

**Objective:** Nursing assessment of menopausal symptoms and their impact on the quality of life and work productivity of women in the Vlora district.

**Methodology:** This is a cross-sectional study, which included 126 women aged 40-65 years who visited primary care at health center no. 4 in the city of Vlora for gynecological and non-gynecological reasons, during the period April-June 2023. The MENQOL menopause quality of life questionnaire was used in the measuring instruments for measuring the severity of symptoms and quality of life. To assess self-care practices, a list of 12 questions was developed regarding different self-care practices that women can use during menopause, adapted from the standardized WHO Menopausal Assessment Tool questionnaire.

**Results:** The study findings revealed that there is a significant degree of severity of menopausal symptoms experienced 3.28 ± 1.33 with a predominance of hot flashes and flushing with 4.8 points, anxiety with 4.2 points, back pain with 4.5 points and decreased sexual desire with 3.9 points. Women with high levels of vasomotor symptoms had high work impairment, 44.7%, ( $p = 0.000$). Women with high levels of psychosocial symptoms had high work impairment, 50% ( $p = 0.037$). It was observed that there is a low percentage of women who used physical activity as a self-care practice, while a healthy diet and herbal products dominate.

**Conclusions:** The results of this study served as evidence that sheds light on the relationship between menopause symptoms and work productivity in the Vlora district, considering that such data in Albania are limited.

**Keywords:** *menopause, symptoms, quality of life, self-care practices*

# RËNDËSIA E DEPISTIMIT TË HERSHËM TË HPV PËR PARANDALIMIN E KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS DHE PËRMIRËSIMIN E SHËNDETIT PUBLIK. STUDIM NË RRETHIN E KORÇËS

**MIMOZA ISUFI[1], DELANTINA MULLA[2]**

[1]*Infermiere, NJVKSH Korçë*

[2]*Infermiere , Shtepia e Lindjes, Spitali Rajonal Korçë.*

**Hyrja**: Kanceri i qafës së mitrës është një nga kanceret më të zakonshme tek gratë dhe përbën një problem shëndetësor të rëndësishëm në Shqipëri dhe në shumë shtete të tjera. Shkaku i zhvillimit të këtij kanceri është infektimi nga virusi HPV, i cili përhapet kryesisht përmes kontaktit seksual. Detektimi i infeksionit nëpërmjet testit të HPV dhe depistimi i hershëm përmes Pap testit është shumë sensitiv për të zbuluar fazat prekanceroze dhe kancerin në faza të hershme, kur trajtimi është më efikas. Në këtë studim, fokusohemi në rëndësinë e depistimit të hershëm të HPV dhe ndikimin e tij në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në rrethin e Korçës, një zonë ku ndërgjegjësimi dhe aksesibiliteti ndaj programeve të depistimit mund të kenë nevojë për përmirësim.

**Objektivat**: Edukimi dhe ndërgjegjësimi shëndetësor janë elementë kyç për uljen e incidencës dhe mortalitetit. Objektivat e studimit janë: të informojmë mbi faktorët e riskut të kancerit të qafës së mitrës, shenjat dhe simptomat, parandalimin dhe trajtimin; të japim një pasqyrim të situatës aktuale të incidencës dhe prevalencës së kësaj sëmundjeje; të edukojmë dhe ndërgjëgjësojmë mbi politikat shëndetësore për parandalimin dhe diagnostikimin në kohë.

**Metodologjia:** Për këtë punim është bërë rishikimi i literaturës aktuale mbi kancerin e qafës së mitrës dhe infektimin nga HPV, në libraritë online si PubMed, Cochrane. Për përpunimin e statistikave janë përdorur të dhënat e Regjistrit të Depistimit në Rajonin e Korçës, vitet 2019-2024.

**Rezultatet**: U morën në shqyrtim rezultatet e testimit për antigjenin e HPV-së të 3338 femrave të moshës 22-55 vjeç. Kanë rezultuar pozitive 5.53% e tyre, janë ndjekur me kolposkopi dhe me PAP-test, për të diktuar ndryshimet parakanceroze/kanceroze.

**Konkluzionet:** Testi HPV është një metodë efektive në diagnostikimin e infektimit me virusin shkaktar të kancerit të qafës së mitrës, dhe depistimi i hershëm mundëson trajtimin në kohë dhe uljen e mortalitetit. Edukimi shëndetësor dhe informimi për depistimin dhe vaksinimin rrit shanset e një jete me cilësi më të mirë.

**Fjalët kyce**: *HPV, kancer, PAP-test, depistim i hershëm.*

# THE IMPORTANCE OF EARLY HPV SCREENING FOR THE PREVENTION OF CERVICAL CANCER AND IMPROVING PUBLIC HEALTH. A STUDY IN THE KORÇA REGION

**MIMOZA ISUFI[1], DELANTINA MULLA[2]**

*[1]Nurse, Korça Regional Hospital*
*[2]Nurse, Maternity Home, Korça Regional Hospital*

**Introduction:** Cervical cancer is one of the most common cancers among women and represents a significant health problem in Albania and many other countries. The cause of this cancer's development is infection by the HPV virus, which is primarily spread through sexual contact. Detection of the infection through the HPV test and early screening via the Pap test is highly sensitive in identifying precancerous stages and cancer in its early stages when treatment is more effective. Health education and awareness are key elements in reducing incidence and mortality rates. In this study, we focus on the importance of early HPV screening and its impact on cervical cancer prevention in the Korça district, an area where awareness and accessibility to screening programs may need improvement.

**Study Objectives:** The study aims to inform about the risk factors for cervical cancer, signs and symptoms, prevention, and treatment; to provide an overview of the current incidence and prevalence situation of this disease; and to educate and raise awareness about health policies for prevention and timely diagnosis.

**Methodology:** For this paper, a review of current literature on cervical cancer and HPV infection was conducted in online databases such as PubMed and Cochrane. For statistical processing, data from the Screening Registry in the Korça Region for the years 2019-2024 were used, where results from the HPV antigen test of 3338 women aged 22-55 were examined. Positive cases were followed up with colposcopy and Pap tests to detect precancerous/cancerous changes.

**Results**: The results of HPV antigen testing for 3,338 women aged 22-55 years were reviewed. 5.53% of them tested positive and were followed up with colposcopy and PAP tests to detect precancerous/cancerous changes.

**Conclusions**: The HPV test is an effective method for diagnosing infection with the virus that causes cervical cancer, and early screening allows for timely treatment and a reduction in mortality. Health education and awareness about screening and vaccination increase the chances of a better quality of life.

**Keywords:** *HPV, cancer, Pap test, early screening*.

# ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E INFERMIERES NË VAKSINIMIN E FËMIJEVE

**BABETA REXHEPI [1]**

[1]*Kujdesi Parësor Shëndetësor Nikel, Krujë*

**Hyrje:** Imunizimi është një nga sukseset më të mëdha në historinë e mjekësisë dhe një prej investimeve më domethënëse në Shëndetin Publik. Imunizimi çdo vit parandalon miliona raste vdekjesh prej sëmundjeve të tilla siç janë difteria, tetanusi, pertusis,fruthi gripi etjInfermieri luan një rol shumë të rëndësishëm në Imunizimin e popullatës duke informuar dhe komunikuar me prindërit e fëmijëve mbi vaksinën e rradhës, kohën e kryerjes së saj, cilësine e kryerjes së sherbimit dhe kujdesin pas vaksinimit në mënyrë që fëmijët të jenë më të mbrojtur ndaj sëmundjeve infektive

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë dhe të përshkruajë rëndësinë e rolit te infermierit në Imunizimin e popullates, duke përfshirë monitorimin para, gjate dhe pas imunizimit dhe mbështetjen emocionale të femijëve te vaksinuar edhe prinderve te tyre.

Nëpërmjet këtij materiali synojmë përditësimin dhe përmirësimin e rolit dhe kujdesjeve infermierore para, gjate dhe pas imunizimit si një nga shërbimet bazë në Kujdesin Shendetesor Paresor.

**Burimi i të dhënave:** Informacioni është mbledhur nga literatura shkencore dhe studime klinike të publikuara në lidhje me rolin infermieror ne procesin e Imunizimit. Burimet e përdorura janë selektuar me kujdes për të siguruar bazën e duhur për analizën tonë

**Rezultatet:** Infermierët luajnë një rol të rëndësishëm në Imunizimin e fëmijëve të grupmoshes 0-18 vjeç ndaj Semundjeve Infektive sipas Kalendarit aktual te vaksinimit në Shqipëri. Ata planifikojne kohen e vaksinimit te femijeve, sigurojnë aplikimin e saktë të vaksinave dhe monitorojne gjëndjen e femijeve gjate dhe pas vaksinimit.

**Konkluzioni:** Roli i infermierëve të imunizimit është i ndërthurur me administrimin preciz të vaksinave, edukimin e pacientëve, dhe monitorimin e vazhdueshëm të efekteve te vaksinimit. Infermierët ndihmojnë pacientët dhe familjaret të kuptojne me mire efektet pozitive te vaksinimit dhe menaxhojnë më mirë gjëndjen pas vaksinimit .Përfshirja e tyre aktive ndikohet jo vetem ne rritjen e cilesise se sherbimit por edhe ne perjetimin e nje eksperience me pozitive gjate viteve te imunizimit no vetem ne rritjen e cilesise se sherbimit por edhe ne perjetimin e nje eksperience me pozitive.

**Fjalë kyçe:** *Imunizim, roli i infermierit. vaksina, cilësia e jetës.*

# THE ROLE AND RESPONSIBILITIES OF THE NURSE IN CHILDREN'S VACCINATION

**BABETA REXHEPI[1]**

*[1]Primary Health Care Nikel, Krujë*

**Introduction:** Immunization is one of the greatest successes in the history of medicine and one of the most significant investments in Public Health. Immunization prevents millions of deaths from diseases such as diphtheria, tetanus, pertussis, measles, influenza, etc. The nurse plays a very important role in the immunization of the population by informing and communicating with the parents of children about the next vaccine, the time of its administration, the quality of the service and the care after vaccination so that children are better protected against infectious diseases

**Purpose:** The purpose of this paper is to identify and describe the importance of the role of the nurse in the immunization of the population, including monitoring before, during and after immunization and emotional support of vaccinated children and their parents.

Through this material we aim to update and improve the role and nursing care before, during and after immunization as one of the basic services in Primary Health Care.

**Data source:** Information was collected from scientific literature and published clinical studies regarding the nursing role in the immunization process. The sources used were carefully selected to provide the appropriate basis for our analysis

**Results:** Nurses play an important role in the immunization of children aged 0-18 years against Infectious Diseases according to the current Vaccination Calendar in Albania. They plan the timing of children's vaccination, ensure the correct application of vaccines and monitor the condition of children during and after vaccination.

**Conclusion:** The role of immunization nurses is intertwined with the precise administration of vaccines, patient education, and continuous monitoring of the effects of vaccination. Nurses help patients and families better understand the positive effects of vaccination and better manage the condition after vaccination. Their active involvement is influenced not only by increasing the quality of service but also by experiencing a more positive experience during the years of immunization.

**Keywords:** *Immunization, the role of the nurse. vaccine, quality of life.*

# SHKAQET AMTARE DHE PREVENIMI I KOMPLIKACIONEVE NEONATALE NE PACIENTET ME IUGR

**FLORENTINA IDRIZAJ**[1]

[1]*Mami, S.U.O.GJ.''M.GERALDINE'', TIRANE*

**Hyrje**: Kufizimi i rritjes intrauterine (IUGR) mbetet një nga sfidat e rëndësishme të Obstetrikës dhe Neonatologjisë së kohës moderne. Zhvillimi i teknologjisë në 20 vitet e fundit dhe përmirësimi i shërbimit të neonatologjisë theksojnë kërkesa të reja për specialistët e shërbimit dhe menaxhuesit e protokolleve.

**Qëllimi i studimit:** është përmirësimi i modeleve diagnostikuese, determinimi i kohës së lindjes,kujdesi në pacientet IUGR dhe menaxhimi në spitalet tona obstetrikale duke përdorur protokollet teorike dhe praktike që synojnë diagnostikimin e hershëm të shtatzënive me rrisk të lartë për IUGR.Kohët e fundit është vënë re se zhvillimi i teknologjisë në pajisjet mjekësore ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e kujdesit në pacientet që kanë rrezik të lartë për të pasur një fetus IUGR.

**Objektivat**

- Diagnostikimi i fetuseve të rrezikuar nga IUGR.
- Zbulimi i faktorëve që çojnë në IUGR.
- Realizimi i një plani kujdesi për nënën dhe fetusin.

**Medotologjia:** Ky është një studim retrorospektiv i realizuar në S.U.O.GJ" Mbreteresha Geraldinë" Tiranë, në vitin 2024. Të dhënat e pacienteve,diagnoza përfundimtare dhe koha e lindjes është marrë nga studimi i kartelave. Nga studimi rezultuan 56 raste me diagnozën e IUGR. Nga të cilat 36 raste rezultuan si lindje premature dhe 20 raste lindje në term.Ku 60% e rasteve shfaqën DR si diagnose shoqeruese.Rreth 20% shfaqën Soferencë Fetale.Duke qënë se IUGR është një diagnose multisistemike 20% e rasteve kishin diagnoza të ndryshme shoqërues si: Insufiçiençë Respiratore, problematika të ushqyerjes, hiperbilirubinemi e zgjatur, crregullime metabolike, hypoglicemi, policitemi dhe risk të lartë për infeksion neonatal.

**Rezultate:** Ky studim do te rezultoje ne vlerësimin e gjendjes fetale në mjedisin intrauterin. Zgjatjen e kohëqëndrimit të fetusit në mjedisin IU. Reduktimin e komplikacioneve fetale.

**Konkluzione dhe Përfundime**: Menaxhimi efektiv i IUGR kërkon diagnostikim të hershëm dhe monitorim të vazhdueshëm të shtatzënisë. Përdorimi i ekografisë dhe fluksimetrisë Doppler mundëson vlerësimin e rritjes fetale dhe gjendjes së placentës, duke ndihmuar në përcaktimin e kohës optimale për lindje dhe në reduktimin e komplikacioneve neonatale . Përmirësimi i kujdesit prenatal, duke përfshirë monitorimin e rregullt të shëndetit të nënës dhe fetusit, është thelbësor për të parandaluar dhe menaxhuar IUGR.

**Fjalët kyce**: *IUGR-kufizimi i rritjes intrauterine, FGR- Kufizimi i rritjes së fetusit, detresi respirator*

# MATERNAL CAUSES AND PREVENTION OF NEONATAL COMPLICATIONS IN PATIENTS WITH IUGR

**FLORENTINA IDRIZAJ[1]**

[1]*Midwife, S.U.O.GJ.”M.GERALDINE”, TIRANA*

**Introduction:** Intrauterine growth restriction (IUGR) remains one of the important challenges of modern Obstetrics and Neonatology. The development of technology in the last 20 years and the improvement of the neonatology service highlight new demands for service specialists and protocol managers.

**The purpose of the study:** is to improve diagnostic models, determination of the time of birth, care in IUGR patients and management in our obstetric hospitals using theoretical and practical protocols aimed at early diagnosis of pregnancies at high risk for IUGR. Recently, it has been noted that the development of technology in medical devices has significantly improved the quality of care in patients who have a high risk of having an IUGR fetus.

**Objectives**

• Diagnosing fetuses at risk of IUGR.
• Discovering factors that lead to IUGR.
• Implementing a care plan for the mother and fetus.

**Methodology:** This is a retrospective study conducted at S.U.O.GJ “Queen Geraldina” Tirana, in 2024. Patient data, final diagnosis and time of birth were obtained from the study of the charts. The study resulted in 56 cases with a diagnosis of IUGR. Of which 36 cases resulted in premature birth and 20 cases in term birth. Where 60% of cases showed DR as a concomitant diagnosis. About 20% showed Fetal Suffering. Since IUGR is a multisystem diagnosis, 20% of cases had various concomitant diagnoses such as: Respiratory Insufficiency, Feeding Problems, Prolonged Hyperbilirubinemia, Metabolic Disorders, Hypoglycemia, Polycythemia, High Risk for Neonatal Infection

**Results:** This study will result in: Assessment of fetal condition in the intrauterine environment. Extension of fetal residence time in the IU environment. Reduction of fetal complications.

**Conclusions:** Effective management of IUGR requires early diagnosis and continuous monitoring of pregnancy. The use of ultrasound and Doppler flowmetry allows assessment of fetal growth and placental status, helping to determine the optimal time for delivery and reduce neonatal complications. Improved prenatal care, including regular monitoring of maternal and fetal health, is essential to prevent and manage IUGR.

**Keywords:** *IUGR-Intrauterine Growth Restriction, FGR- Fetal Growth Restriction, DR-Respiratory Distress*

# STUDIMI MBI ECURINË E METRORAGJISË NË SPITALIN E KORÇËS, NË 5 VITET E FUNDIT

**DELANTINA MULLA[1]**

[1]*Kryeinfermieriere, "Shtëpia e Lindjes", Korcë, Shqipëri*

[1]*Presidente e Urdhrit të Infermierit, Qarku Korçë*

**Hyrje:** Metrorrhagia është gjakderdhje vaginale që ndodh jashtë periudhës menstruale, midis cikleve të ndryshme. Në përgjithësi, menstruacionet zgjasin nga 3 deri në 7 ditë dhe ndërmjet secilit rregull, midis 24 dhe 35 ditë, afërsisht.Nëse gjatë kësaj periudhe vuani ndonjë gjakderdhje vaginale, është ajo që njihet si metrorrhagia. Ky çrregullim gjinekologjik mund të shkaktohet nga arsye të ndryshme. Të gjitha gratë me metroragji të papritur duhet të vlerësohen për kancer nëendometrium, sepse kjo semundje potencialisht letale është arsye për 10% të Hemorragjive (nga 1 deri 25%, në varësi të faktoreve të rrezikut). Gjithësesi, shkaku më i shpeshtë për hemorragji në këto gra është atrofia e mukozës vaginale osë të endometriumit. Në vitet e para të menopauzës, arsye të tjera janë hyperplasia endometriale, polipet, fibroidet submukozale.
**Qëllimi:** Vlerësimi i karakteristikave klinike dhe histopatologjike tek pacientet me hemorragji.
**Metodologjia:** Ky studim synon të evidentoje në shkaqet e metroragjise, manifestimet klinike si dhe kujdesin infermieror tek gratë me metroragji. Rastet e mara në studim janë marë në Maternitetin e Korcës për periudhën kohore 2019-2023. Grupmosha e përfshire në këtë studim është 15 vjec deri në moshën mbi 65 vjec. Të dhënat e paraqitura në këtë studim u morën nga dokumentacioni i pavionit të gjinekologjisë dhe obstetrikes.
**Përfundime:** Gjatë studimit të kryer për periudhën kohore 2019-2023 rezultojnë:Numrin më i lartë i pacienteve të shtruara me metroragji është në vitin 2022 me 89 pacientë të paraqitura dhe numrin më të ulët në vitin 2020 me 60 pacientë. Rezulton se numrin më të lartë të pacienteve të paraqitura ishin me vendbanim në qytet dhe më pak me vendbanim në fshat. Gjithashtu, grupmosha më e prirur për metroragji është grupmosha 45-54 vjecare. Grupmoshat më pak të prekura me metroragji është grupmosha 15-24 vjecare dhe mosha mbi 65 vjec. Rastet përgjatë këtij studimi kanë tendencën të vijnë në rritje.

**Fjalë kyce:** *paciente, metroragjia, ecuria, grupmosha*

# STUDY ON THE PROGRESS OF METRORRHAGIA IN THE KORCA HOSPITAL, IN THE LAST 5 YEARS

**DELANTINA MULLA[1]**

*[1]Head Nurse, "Hause of Birth", Korcë, Albania*

*[1]President of the Order of Nurses, Korça Region*

**Introduction:** Metrorrhagia is vaginal bleeding that occurs outside the menstrual period, between different cycles. In general, menstruation lasts from 3 to 7 days, with an interval of approximately 24 to 35 days between each cycle. If vaginal bleeding occurs outside this period, it is referred to as metrorrhagia. This gynecological disorder can be caused by various factors. All women with sudden metrorrhagia should be evaluated for endometrial cancer, as this potentially lethal disease accounts for 10% of hemorrhages (ranging from 1% to 25%, depending on risk factors). However, the most common cause of bleeding in these women is atrophy of the vaginal or endometrial mucosa. In the early years of menopause, other causes include endometrial hyperplasia, polyps, and submucosal fibroids.

**Objective:** To evaluate the clinical and histopathological characteristics of patients with hemorrhage.

**Methodology:** This study aims to identify the causes of metrorrhagia, its clinical manifestations, and the nursing care provided to women with this condition. The cases included in the study were collected from the Maternity Hospital of Korça during the period 2019-2023. The age group involved in this study ranges from 15 years to over 65 years. The data presented in this study were obtained from the documentation of the gynecology ward and the maternity hospital.

**Conclusions:** During the study conducted over the period 2019-2023, the highest number of hospitalized patients with metrorrhagia was recorded in 2022, with 89 cases, while the lowest number was in 2020, with 60 cases. The findings indicate that most of the patients affected were from urban areas, with fewer cases reported from rural areas. Additionally, the most affected age group was 45-54 years. The least affected age groups were 15-24 years and over 65 years. The cases analyzed in this study show a tendency to increase over time.

**Keywords:** *patients, metrorrhagia, progression, age group*

# REZONANCA MAGNETIKE GJATË SHTATZANISË

**ALKET COLLAKU [1], ELONA DYBELI [2]**

[1] *Spitali GVM, Tiranë, Shqipëri*
[2] *Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Shqipëri*

Autori korrespondent: alket_collaku@yahoo.com

**Hyrje:** Rezonanca Magnetike fetale përbën një modalitet diagnostikues të konsideruar si *"gold standart"* për një informacion të detajuar të zhvillimit të fetusit in utero. Kjo teknikë ka revolucionarizuar vlerësimin e rasteve në të cilat fetusi konsiderohet të jetë në rrezik të lartë për jetën, si psh në malformacionet e ndryshme, placenta previa ose akreta etj.

**Qëllimi:** Studimi ka si synim vlerësimin e protokollit aktual dhe rishikimin e tij për të krijuar një protokoll të ri për një paraqitje sa më të mirë të fetusit dhe çrregullimeve neurozhvillimore, tumoret e trurit, anomalitë e ndryshme kongenitale etj.

**Metodat:** Studimi është bazuar mbi rishikimin e literaturës prestigjioze botërore si dhe protokolleve të cilat aplikohen në vëndin tonë.

**Rezultate:** MRI është përdorur gjithnjë e më shumë për vizualizimin e detajuar të fetusit në uterus. MRI fetale është një ekzaminim joinvaziv dhe nuk shoqërohet me rrezatim jonizues. Megjithatë, efektet mbi zhvillimin e fetusit të fushave magnetike statike, zhurmës, impulseve të radiofrekuencës dhe gradientëve që ndryshojnë me shpejtësi nuk janë sqaruar ende plotësisht. Sekuencat bazë të cilat përdoren janë: T2 weighted, T1, T2*, DWI. T2 weighted është më e përdorura zakonisht për shkak të kontrastit indor të shkëlqyer dhe imunitetit që ka ndaj lëvizjeve të fetusit.

**Përfundime:** Sipas rekomandimeve të ACR dhe Shoqatës së Imazherisë pediatrike, nuk lejohet kryerja e MRI-së fetale me injektim të kontrastit intravenoz; në tremujorin e pare si dhe aplikimi i sedacionit.

Pavarësisht nëse familjarizimi i radiologëve dhe klinicistëve me rezonancën magnetike fetale është ende i kufizuar, në ditët e sotme është arritur të krijohen protokolle të cilat janë në gjëndje të zbulojnë anomalitë në faza shumë të hershme, duke krijuar mundësitë e planifikimi të hershëm të trajtimit. MRI fetale është një skanim ndërveprues i fetusit në lëvizje për shkak të përdorimit të sekuencave të shpejta.

**Fjalë kyçe:** *MRI fetale, protokoll, patologji, diagnozë.*

# MAGNETIC RESONANCE IMAGING DURING PREGNANCY

**ALKET COLLAKU [1], ELONA DYBELI [2]**

*[1] GVM Hospital, Tirana, Albania*
*[2] University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Albania*
Email: alket_collaku@yahoo.com

**Introduction**: Fetal Magnetic Resonance constitutes a diagnostic modality considered as the *"gold standard"* for detailed information on the development of the fetus in utero. This technique has revolutionized the evaluation of cases in which the fetus is considered to be at high risk for life, such as in various malformations, placenta previa or accreta, etc.
**Purpose**: The study aims to evaluate the current protocol and revise it to create a new protocol for a better presentation of the fetus and neurodevelopmental disorders, brain tumors, various congenital anomalies, etc.
**Methods**: The study is based on the review of prestigious world literature as well as the protocols that are applied in our country.
**Results**: MRI is increasingly used for detailed visualization of the fetus in the uterus. Fetal MRI is a non-invasive examination and does not involve ionizing radiation. However, the effects on fetal development of static magnetic fields, noise, radiofrequency pulses and rapidly changing gradients have not yet been fully elucidated. The basic sequences used are: T2 weighted, T1, T2*, DWI. T2 weighted is the most commonly used because of its excellent tissue contrast and immunity to fetal movements.
**Conclusions**: According to the recommendations of the ACR and the Society of Pediatric Imaging, it is not allowed to perform fetal MRI with intravenous contrast injections in the first trimester as well as the application of sedation.
Although the familiarity of radiologists and clinicians with fetal magnetic resonance is still limited, nowadays it has been possible to create protocols that are able to detect abnormalities at very early stages, creating the possibility of early treatment planning.
Fetal MRI is an interactive scan of the moving fetus due to the use of fast sequences.
**Keywords:** *Fetal MRI, protocol, pathology, diagnosis.*

# ROLI I INFERMIEREVE NE PROMOVIMIN E USHQYERJES ME GJI PAS DALJES NGA MATERNITETI. RENDESIA E USHQYERJES ME GJI DHE NDIKIMI

**EMRIJE GJATA[1]**

[1] *Infermiere Klinika e Neonatologjisë Spitali Rajonal Durrës*

**Hyrje:** Studimet dhe kerkimet shkencore theksojnë rëndësinë e qumështit të gjirit për shëndetin e femijës, duke e konsideruar atë si ushqim bazë për shëndetin e fëmijës, përberja e tij me proteina, lipide dhe karbohidrate ka bërë që OBSH dhe UNICEF të rekomandojnë ushqyerjen me gji dhe të inkurajojnë vëndet anëtare që të aplikojnë strategji dhe ligje për promovimin e saj. Roli i infermierëve në promovimin e ushqyerjes me gji pas daljes nga materniteti është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shëndetin e fëmijës dhe nënës.

**Qëllimi**: Ky punim ka për qëllim të identifikojë pengesat dhe ndikimet e burimeve spitalore, organizatave për mbarvajtjen profesionale të laktacionit. Ky studim është individual dhe kolektiv dhe është realizuar në klinikën e Neonatologjisë Durrës.

**Metodologjia:** Ky studim përveçse në literaturë është bazuar në punën e përditshme nënë-bebe. Janë përdorur anketa për nënat nga infermierët për eksperiencat e tyre personale.Qëllimi i anketave kanë qënë njohuritë e personelit dhe nënave të reja për rëndësine që ka gjidhënia dhe sidomos orët e para të lindjes për një mbarvajtje më të mirë nënë-foshnje. Gjithashtu mbeshtetja nga institucioni SRD per promovimin e gjidhenies brenda institucionit.

**Rezultatet:** Në Shqipëri ekzistojnë ligje të duhura për gjidhënien (miratuar ne 23 shtator 1999) dhe ky ligj promovon ushqyerjen me gji brënda orës së parë të lindjes së infantit dhe promovimin e tij për të vazhduar të paktën 6 muajt e parë të jetës e deri 2 vjec si dhe kufizimin e marketingut të qumështit artificial. Ligji për ushqyerjen me gji ka qënë një prej më të avancuarve në Shqipëri dhe është pritur me interes të madh, mirëbesim dhe aktivitet nga institucionet përkatëse.

**Konkluzioni:** Institucioni duhet të përkrahi nënat sidomos ato të reja me materiale informuese, video të shkurtra demostruese gjatë periudhës së shtatzanisë si dhe ti percjellë njohurite e tyre menjëherë pas lindjes dhe në mënyrë periodike për të gjithë periudhën e gjidhënies.

**Fjalët Kyçe:** *Gjidhënia, barrierat profesionale, nëna, personeli shëndetësor.*

# THE ROLE OF NURSES IN PROMOTING BREASTFEEDING AFTER DISCHARGING FROM THE MATERNITY. THE IMPORTANCE OF BREASTFEEDING AND IT'S IMPACT

**EMRIJE GJATA**[1]

[1]*Nurse Neonatology Clinic, Durrës Regional Hospital.*

**Introduction:** Studies and scientific research emphasize the importance of breast milk for the health of the child, considering it as a basic food for the health of the child, its composition with proteins, lipids and carbohydrates has led WHO and UNICEF to recommend breastfeeding and encourage member countries to apply strategies and laws for its promotion. The role of nurses in promoting breastfeeding after discharge from maternity is extremely important for the health of the child and the mother.

**Purpose of the topic:** This paper aims to identify the barriers and impacts of hospital resources, organizations for the professional maintenance of lactation. This study is individual and collective and was conducted at the Durrës Neonatology Clinic.

**Methodology:** This study, in addition to the literature, is based on the daily work of mothers and babies. Surveys of mothers by nurses about their personal experiences were used. The purpose of the surveys was the knowledge of the staff and new mothers about the importance of breastfeeding and especially the first hours of birth for better mother-baby survival. Also, support from the SRD institution for the promotion of breastfeeding within the institution.

**Results:** In Albania, there are appropriate laws on breastfeeding (approved on September 23, 1999) and this law promotes breastfeeding within the first hour of the infant's birth and its promotion to continue for at least the first 6 months of life and up to 2 years, as well as the restriction of the marketing of artificial milk. The law on breastfeeding has been one of the most advanced in Albania and has been welcomed with great interest, trust and activity by the relevant institutions.

**Conclusion:** The institution should support mothers, especially new ones, with informative materials, short demonstration videos during the pregnancy period, as well as follow up on their knowledge immediately after birth and periodically for the entire breastfeeding period.

**Keywords:** *Breastfeeding, professional barriers, mother, health personnel.*

# SHTAZANIA EKTOPIKE. MENAXHIMI DHE KUJDESI

**MIRELA XHERRI[1], MIRANDA AZISLLARI[1], SIDORELA GEGA[1], MALVINA MUCA[1]**

[1]*Qendra Universitare Obstetrike Gjinekologjike " Mbretëresha Geraldinë "*

**Hyrje:** Shtazania ektopike ndodh kur embrioni i fertilizuar implantohet dhe zhvillohet jashtë mitrës, zakonisht në një nga tubat e Fallopit (tubat e vezoreve). Kjo gjendje është e rrezikshme dhe shpesh shoqërohet me komplikacione serioze për shëndetin e gruas së prekur. Kjo lloj shtatzanie nuk mund të vazhdojë normalisht pasi veza e fekonduar nuk do mund të mbijetojë dhe indi në rritje mund të shkaktojë gjakderdhje kërcënuese për jetën nëse nuk trajtohet në kohën dhe mënyrën e duhur.

***Metodologjia:*** Studimi është i tipit retrospektiv dhe krahasimor ,duke analizuar të dhëna nga pacientet e trajtuara në një periudhë specifikedhe duke krahasuar rezultatet midis dy metodave të trajtimit. Ky studim është realizuar gjatë periudhës 2019-2020. Për realizimin e këtij studimi morën pjesë 70 paciente pranë SUOGJ Mbretëresha Geraldinë, duke u ndarë në dy grupe: grupi kirurgjikal që do të trajtohen të gjitha shtatzanite ektopike të rupturuara dhe grupi konservativ ku do të bëjnë pjesë pacientet që janë trajtuar me methotraxate, duke shqyrtuar faktorët e riskut, metodat diagnostikuese dhe rezultatet e trajtimeve të aplikuara.

**Rezultatet**: Rezultatet tregojnë se diagnoza e hershme është thelbesore për të reduktuar rezikun e rupturës tabulare dhe për të mundësuar një trajtim më pak invasive.

**Konkluzione:** Diagnoza e hershme e shtatzënisë ektopike do të na krijojë mudësitë të aplikojmë trajtim më të mirë dhe më me pak komplikacione. Trajtimi me Methotraxat është një metodë jo invasive pa komplikacione ku sigurohet dhe ruajtja e fertilitetit. Trajtimi me methotraxat bën të mundur mënjanimin e kirurgjisë si linjë të parë.

Duke pasur parasysh rrezikun e lartë duhet të këshillohen pacientët të konsultohen sa më shpejt me mjekun e tyre me qëllim që të monitorohet sa më shpejt gravidanca me ekografi transvaginale dhe dozimi i BHCG.Në rastin e një gravedance të re tubulare të bëhët një trajtim kirurgjikal i shpjtë me qëllim që të ruhet tubi i ngelur.

**Fjalët kyçe**:*Shtatzani ektopike, diagnoza, methotraxate, trajtim kirurgjikal, fertilitet.*

# ECTOPIC PREGNANCY. MANAGEMENT AND CARE

**MIRELA XHERRI[1], MIRANDA AZISLLARI[1], SIDORELA GEGA[1], MALVINA MUCA[1]**

[1]*University Obstetrics and Gynecology Center "Queen Geraldine"*

**Introduction:** Ectopic pregnancy occurs when a fertilized embryo implants and develops outside the uterus, usually in one of the fallopian tubes (ovarian tubes). This condition is dangerous and is often associated with serious complications for the health of the affected woman. This type of pregnancy cannot continue normally as the fertilized egg will not be able to survive and the growing tissue can cause life-threatening bleeding if not treated in a timely and appropriate manner.

**Methodology:** The study is of a retrospective and comparative type, analyzing data from patients treated in a specific period and comparing the results between the two treatment methods. This study was conducted during the period 2019-2020. For the realization of this study, 70 patients participated at SUOGJ “Mbretëresha Geraldine”, being divided into two groups, the surgical group that will treat all ruptured ectopic pregnancies, and the conservative group that will include patients who have been treated with methotrexate, examining risk factors, diagnostic methods and results of the treatments applied.

**Results:** The results show that early diagnosis is essential to reduce the risk of tabular rupture and to enable a less invasive treatment.

**Conclusions:** Early diagnosis of ectopic pregnancy will create opportunities for us to apply better treatment and with fewer complications. Treatment with Methotrexate is a non-invasive method without complications where fertility preservation is also ensured. Treatment with Methotrexate makes it possible to avoid surgery as a first line. Given the high risk, patients should be advised to consult their doctor as soon as possible in order to monitor the pregnancy as soon as possible with transvaginal ultrasound and BHCG dosing. In the case of a new tubal pregnancy, rapid surgical treatment should be performed in order to preserve the remaining tube.

**Keywords:** *Ectopic pregnancy, diagnosis, methotrexate, surgical treatment, fertility.*

# SINDROMI I PREEKLAMPSISË

**ANDIA PELARI[1]**

[1]*Infermiere, Reparti Obstetrikë-Gjinekologji, Vlorë*

**Hyrje:** Preeklampsia është përshkruar më mirë si një sindromë specifike e barrës që mund të prekë virtualisht cdo sistem dhe organ. Preeklampsia ndahet në vendosje të hershme < 34 javë gestacionale dhe në vendosje të vonshme > 34 jave gestacionale. Përfshirja multiorganore reflektohet nga: trombocitopenia, disfunksioni renal, nekroza hepatocelulare, shqetesime ne SNQ, edemë pulmonare. Dhimbjet e kokës ose crregullimet vizuale mund ti paraprijnë eklampsinë. Konvulsionet e eklampsisë mund të shfaqen para, gjatë ose pas lindjes.

**Qëllimi:** Qëllimi i studimit të sindromit të preeklampsisë është të kuptohet më mirë kjo gjendje shëndetësore, duke identifikuar shkaqet, mekanizmat biologjikë, faktorët e rrezikut, dhe pasojat që mund të ketë për nënën dhe fëmijën gjatë shtatzënisë. Sindroma e preeklampsisë është një gjendje serioze që ndodh zakonisht pas javës së 20-të të shtatzënisë dhe shoqërohet me rritje të presionit të gjakut dhe shenja të dëmtimit të organeve, sidomos të veshkave dhe mëlçisë.

**Metodologjia: Studime të rastit dhe kontrollit (case-control studies):** Ku krahasohen shtatzënat që kanë zhvilluar preeklampsi me ato që nuk kanë, për të identifikuar faktorët që mund të kontribuojnë në zhvillimin e sindromës.

**Rezultate:** Studimet kanë treguar se gratë që kanë pasur preeklampsi janë më të rrezikuara për zhvillimin e sëmundjeve të zemrës dhe hipertensionit pas lindjes. Kjo mund të vlerësohet përmes analizave të rrezikut kardiovaskular dhe monitorimit afatgjatë.

**Konkluzione:** Sindroma e preeklampsisë është një gjendje serioze që mund të ndodhë gjatë shtatzënisë, zakonisht pas javës së 20-të, dhe karakterizohet nga një rritje e papritur e presionit të gjakut dhe shenja të dëmtimit të organeve, kryesisht të veshkave, mëlçisë dhe sistemit nervor qendror. Preeklampsia është një nga komplikimet më të zakonshme të shtatzënisë, e cila mund të ndikojë si në nënën ashtu edhe në fëmijën që ajo mban.Rezultatet nga analizat e sindromës së preeklampsisë ndihmojnë mjekët të përcaktojnë diagnozën, të monitorojnë përparimin e sëmundjes dhe të marrin masa për trajtimin e duhur. Ndërhyrjet e hershme dhe monitorimi i vazhdueshëm janë të domosdoshme për të ulur rrezikun e komplikacioneve të mundshme për nënën dhe fëmijën.

**Fjalë kyç:** *sindroma preeklampsisë, rritje e presionit të gjakut, sistem nervor.*

# PREECLAMATION SYNDROME

**ANDIA PELARI[1]**

[1]*Nurse, Obstetrics-Gynecology Department, Vlora*

**Introduction:** Preeclampsia is best described as a pregnancy-specific syndrome that can affect virtually every system and organ. Preeclampsia is divided into early onset < 34 weeks of gestation and late onset > 34 weeks of gestation. Multiorgan involvement is reflected by thrombocytopenia, renal dysfunction, hepatocellular necrosis, CNS disorders, pulmonary edema. Headaches or visual disturbances may precede eclampsia. Eclampsia seizures may occur before, during, or after delivery.

**Purpose:** The purpose of studying preeclampsia syndrome is to better understand this health condition, by identifying its causes, biological mechanisms, risk factors, and the consequences it may have for the mother and child during pregnancy. Preeclampsia is a serious condition that usually occurs after the 20th week of pregnancy and is associated with high blood pressure and signs of organ damage, especially the kidneys and liver.

**Methodology:** Case-control studies: Comparing pregnant women who have developed preeclampsia with those who do not, to identify factors that may contribute to the development of the syndrome.

**Results:** Studies have shown that women who have had preeclampsia are at higher risk of developing heart disease and hypertension after giving birth. This can be assessed through cardiovascular risk analyses and long-term monitoring.

**Conclusions:** Preeclampsia is a serious condition that can occur during pregnancy, usually after the 20th week, and is characterized by a sudden increase in blood pressure and signs of organ damage, mainly the kidneys, liver and central nervous system. Preeclampsia is one of the most common complications of pregnancy, which can affect both the mother and the baby she is carrying. The results of the preeclampsia syndrome tests help doctors determine the diagnosis, monitor the progression of the disease, and take measures for appropriate treatment. Early interventions and continuous monitoring are necessary to reduce the risk of potential complications for the mother and baby.

**Keywords:** *preeclampsia syndrome, increased blood pressure, nervous system.*

# MENAXHIMI I HEMORRAGJISË POSTPARTUM DHE ROLI I MAMIVE

**AIDA ABDURRAHMANI[1]**

[1]*Materniteti Spitali Rajonal Elbasan*

**Hyrje:** Hemorragjia postpartum është një nga komplikimet më serioze pas lindjes dhe mbetet një shkak kryesor i vdekjeve të nënave në mbarë botën. Mamitë, si linja e parë e kujdesit gjatë dhe pas lindjes, luajnë një rol vendimtar në njohjen e shenjave të hershme të hemoragjisë postpartum dhe marrjen e masave të shpejta për ta menaxhuar atë në mënyrë efektive. Ky studim synon të kuptojë njohuritë dhe gatishmërinë e mamive në trajtimin e hemoragjisë postpartum, duke theksuar rëndësinë e ndërhyrjeve në kohë dhe ndjekjen e protokolleve të standardizuara për të përmirësuar rezultatet e nënës.

**Metodologjia:** Është realizuar një studim i kujdesshëm i literaturës përmes PubMed, Google Scholar, CINAHL etj. Kërkimet u fokusuan në studimet e publikuara në dekadën e fundit duke përfshirë fjalë kyce të tilla si “hemoragjia postpartum”, “mami”, “shëndeti i nënave”. U morën në konsideratë vetëm studime të cilat përmbushnin kriteret e përfshirjes.

**Rezultatet:** Rishikimi i literaturës thekson faktin se mamitë janë shpesh reaguesit e parë në urgjencat e hemoragjisë postpartum, me njohuritë dhe aftësitë e tyre që luajnë një rol vendimtar në rezultatet e shëndetit të nënës. Studimet tregojnë se ndërsa mamitë përgjithësisht njohin shenjat e hershme të hemoragjisë postpartum, respektimi i protokolleve të standardizuara ndryshon. Programet e trajnimit që fokusohen në aftësitë praktike, si masazhi i mitrës, administrimi i medikamenteve dhe komunikimi efektiv me ekipet multidisiplinare, kanë treguar se përmirësojnë kompetencën dhe besimin e mamive në menaxhimin e hemoragjisë postpartum. Për më tepër, edukimi i vazhdueshëm dhe trajnimi i bazuar në simulime janë thelbësore në përforcimin e këtyre aftësive për të shpëtuar jetën.

**Diskutime:** Literatura nënvizon rëndësinë e fuqizimit të mamive nëpërmjet trajnimit të rregullt dhe përforcimit të protokollit për të rritur aftësinë e tyre për të menaxhuar rastet e pacientëve me hemoragji postpartum në mënyrë efektive. Programet e strukturuara të trajnimit përmirësojnë ndjeshëm gatishmërinë e mamive për të kryer ndërhyrje në kohë, duke kontribuar në rezultate më të mira rreth shëndetit të nënës. Studimet e ardhshme duhet të eksplorojnë ndikimin afatgjatë të këtyre nismave të trajnimit dhe integrimin e protokolleve të standardizuara në praktikën rutinë.

***Fjalë kyçe:*** *Hemorragji postpartum, mami, shëndeti i nënës, urgjencë, trajnim*

# MANAGEMENT OF POSTPARTUM HEMORRHAGIA AND THE ROLE OF MIDWIFERIES

**AIDA ABDURRAHMANI**[1]

[1]*Materniteti Spitali Regional Elbasan*

**Introduction:** Postpartum hemorrhage is one of the most serious complications after childbirth and remains a leading cause of maternal death worldwide. Midwives, as the first line of care during and after childbirth, play a crucial role in recognizing early signs of postpartum hemorrhage and taking prompt measures to manage it effectively. This study aims to understand the knowledge and readiness of midwives in the treatment of postpartum hemorrhage, emphasizing the importance of timely interventions and following standardized protocols to improve maternal outcomes.

**Methodology:** A careful literature review was conducted through PubMed, Google Scholar, CINAHL, etc. The searches focused on studies published in the last decade including keywords such as "postpartum hemorrhage", "midwife", "maternal health". Only studies that met the inclusion criteria were considered.

**Results:** The literature review highlights the fact that midwives are often the first responders to postpartum hemorrhage emergencies, with their knowledge and skills playing a crucial role in maternal health outcomes. Studies show that while midwives generally recognize the early signs of postpartum hemorrhage, the adherence to standardized protocols varies. Training programs that focus on practical skills, such as uterine massage, medication administration, and effective communication with multidisciplinary teams, have been shown to improve midwives' competence and confidence in managing postpartum hemorrhage. Furthermore, continuing education and simulation-based training are essential in reinforcing these life-saving skills.

**Discussion:** The literature highlights the importance of empowering midwives through regular training and protocol reinforcement to increase their ability to effectively manage cases of postpartum hemorrhage. Structured training programs significantly improve midwives' readiness to perform timely interventions, contributing to better maternal health outcomes. Future studies should explore the long-term impact of these training initiatives and the integration of standardized protocols into routine practice.

**Keywords:** *Postpartum hemorrhage, midwifery, maternal health, emergency, training.*

# KOMPLIKACIONET OBSTETRIKE GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË SHTATZANISË -NJË KËNDVËSHTRIM NDËRKOMBËTAR

**ELJO PAJA[1], ELCA NONI[2]**

[1]*Universiteti Europian i Tiranës*
[2]*Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"*

**Hyrja:** Komplikacionet obstetrike gjatë tremujorit të tretë të shtatzënisë përbëjnë një faktor kryesor rreziku për shëndetin e nënës dhe foshnjës, duke ndikuar ndjeshëm në normat e morbiditetit dhe mortalitetit maternal dhe perinatal. Këto ndërlikime përfshijnë patologji të tilla si preeklampsia, placenta previa, placenta accreta, hemorragjitë antepartum, lindja e parakohshme dhe diabeti gestacional. Preeklampsia është një nga komplikacionet më të zakonshme dhe më serioze gjatë tremujorit të tretë. Ajo karakterizohet nga hipertensioni dhe proteinuria (prania e proteinave në urinën e gruas shtatzënë). Nëse nuk trajtohet, mund të çojë në eklampsi, një gjendje që mund të jetë vdekjeprurëse për nënën dhe foshnjën. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e preeklampsisë janë historia familjare, shtatzënia e parë, mbipesha dhe mosha më e madhe e nënës.

**Objektivat**

- Të shqyrtojë incidencën dhe faktorët e rrezikut për komplikacionet obstetrike në tremujorin e tretë.
- Të analizojë dallimet ndërkombëtare në menaxhimin dhe trajtimin e këtyre ndërlikimeve.
- Të evidentojë masat parandaluese dhe strategjitë më efektive për reduktimin e rreziqeve obstetrike.

**Metodologjia :** Ky studim bazohet në një rishikim të literaturës ekzistuese mbi komplikacionet obstetrike në tremujorin e tretë të shtatzënisë. Burimet e të dhënave përfshijnë artikuj shkencorë, raporte nga organizata shëndetësore ndërkombëtare dhe studime krahasimore midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim.

**Rezultate:** Analiza tregon se incidenca dhe trajtimi i komplikacioneve obstetrike ndryshon ndjeshëm në varësi të infrastrukturës shëndetësore dhe qasjes në kujdesin antenatal. Në vendet e zhvilluara, monitorimi i rregullt dhe teknologjitë moderne kanë ulur ndjeshëm rreziqet, ndërsa në vendet me burime të kufizuara, vonesat në diagnozë dhe trajtim rrisin rrezikun e ndërlikimeve serioze.

**Konkluzione:** Studimi sugjeron nevojën për politika të integruara globale dhe qasje më të personalizuara në trajtimin e komplikacioneve obstetrike. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe aksesit në kujdesin antenatal janë kyçe për reduktimin e vdekshmërisë obstetrike dhe përmirësimin e shëndetit perinatal.

**Fjalë kyce:** *Komplikacione obstetrike, tremujori i tretë i shtatzënisë, preeklampsia, placenta previa*

# OBSTETRICAL COMPLICATIONS DURING THE THIRD TRIMESTER OF PREGNANCY - AN INTERNATIONAL PERSPECTIVE

**ELJO PAJA[1], ELCA NONI[2]**

[1]*European University of Tirana*
[2]*University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"*

**Introduction:** Obstetric complications during the third trimester of pregnancy constitute a major risk factor for maternal and infant health, significantly affecting maternal and perinatal morbidity and mortality rates. These complications include pathologies such as preeclampsia, placenta previa, placenta accreta, antepartum hemorrhage, preterm labor, and gestational diabetes. Preeclampsia is one of the most common and serious complications during the third trimester. It is characterized by hypertension and proteinuria (the presence of protein in the urine of a pregnant woman). If untreated, it can lead to eclampsia, a condition that can be fatal for both mother and baby. Factors that influence the development of preeclampsia are family history, first pregnancy, obesity, and older maternal age.

**Objectives**

• To review the incidence and risk factors for obstetric complications in the third trimester.
• To analyze international differences in the management and treatment of these complications.
• To identify the most effective preventive measures and strategies for reducing obstetric risks.

**Methodology:** This study is based on a review of the existing literature on obstetric complications in the third trimester of pregnancy. Data sources include scientific articles, reports from international health organizations, and comparative studies between developed and developing countries.

**Results:** The analysis shows that the incidence and treatment of obstetric complications varies significantly depending on the health infrastructure and access to antenatal care. In developed countries, regular monitoring and modern technologies have significantly reduced the risks, while in resource-limited countries, delays in diagnosis and treatment increase the risk of serious complications.

**Conclusions:** The study suggests the need for integrated global policies and more personalized approaches to the treatment of obstetric complications. Improving health services and access to antenatal care are key to reducing obstetric mortality and improving perinatal health.

**Keywords:** *Obstetric complications, third trimester of pregnancy, preeclampsia, placenta previa*

# ROLI I MAMISË NË SALLËN OPERATORE NË OBSTETRIKË - GJINEKOLOGJI. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

**RIGERTA JANAQI [1], ANJEZA KOLANECI [1]**

[1]*Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë”" Tirana, Albania*

**Hyrje:** Roli i mamisë në sallën e operacionit është kyç për sigurinë dhe mirëqenien e pacienteve gjatë dhe pas operacioneve obstetrikë dhe gjinekologjike. Kjo temë gjithashtu thekson rëndësinë e trajnimit dhe përditësimit të njohurive për mamitë për të siguruar një kujdes të sigurt dhe efektiv në sallën operatore. Mamia është një profesionist i specializuar që ndihmon në monitorimin dhe mbështetjen e gruas gjatë procesit të lindjes, por dhe gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale si cezarianet dhe procedurat tjera.
**Rezultatet:** Të sigurohet një kuptim më i thellë dhe i detajuar i përgjegjësive dhe detyrave të mamisë në situata të veçanta operative,te theksohet roli i bashkëpunimit në ekip.
**Metodologjia:** Analizë e dokumenteve dhe udhëzimeve profesionale ku përfshin shqyrtimin e udhëzimeve dhe protokolleve profesionale që rregullojnë aktivitetin e mamisë në sallën operatore, siç janë udhëzimet e spitaleve, protokollet e shërbimit mjekësor dhe standardet e praktikës.
**Rezultatet:** Trajnimi i vazhdueshëm dhe përditësimi i njohurive janë të nevojshme për mamitë që punojnë në sallat operative. Edukimi mbi teknikat më të fundit dhe standardet ndërkombëtare të kujdesit është kyç për të siguruar një trajtim të sigurt dhe efektiv.
**Konkluzionet:** Mamia është një pjesë e pandashme e ekipit kirurgjik dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe mirëqenien e pacienteve gjatë operacioneve. Mamia luan një rol kyc në ekipin shëndetësor, pasi ajo ka një përgjegjësi të madhe për të siguruar që cdogjë të shkojë sipas planit dhe, si fëmija ashtu edhe nëna të jenë të mbrojtura gjatë gjithë. Për të siguruar që mamia të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e saj në mënyrë të duhur, është e nevojshme që ajo të ketë akses në trajnime të vazhdueshme dhe përditësim të njohurive. Mamia mund të marrë pjesë në kurse të specializuara që ofrojnë njohuri të thelluara në menaxhimin e anestezisë dhe kujdesin kirurgjik, mund të marrë pjesë në kurse në mbështetje të jetës dhe menaxhimit të emergjencës etj.
**Fjalë kyce**:*sallë operacioni, kirurgji, mami,ndërhyrje*

# THE ROLE OF THE MIDWIFE IN THE OPERATING ROOM IN OBSTETRICS - GYNECOLOGY. DUTIES AND RESPONSIBILITIES

**RIGERTA JANAQI[1] , ANJEZA KOLANECI [1]**

[1]*Obstetrics & Gynecology University Hospital "Queen Geraldine" Tirana, Albania*

**Introduction:** The role of the midwife in the operating room is crucial for the safety and well-being of patients during and after obstetric and gynecological surgeries. This topic also emphasizes the importance of training and updating knowledge for midwives to ensure safe and effective care in the operating room.

A midwife is a specialized professional who helps monitor and support women during the birth process, but also during surgical interventions such as cesarean sections and other procedures.

**Outcomes:** To provide a deeper and more detailed understanding of the responsibilities and tasks of the midwife in specific operative situations, emphasizing the role of teamwork.

**Methodology:** Analysis of professional documents and guidelines, including the review of professional guidelines and protocols that regulate midwifery activity in the operating room, such as hospital guidelines, medical service protocols and standards of practice.

**Results:** Continuous training and updating of knowledge are necessary for midwives working in operating rooms. Education on the latest techniques and international standards of care is key to ensuring safe and effective treatment.

**Conclusions**: The midwife is an integral part of the surgical team and has a direct impact on the safety and well-being of patients during operations. The midwife plays a key role in the healthcare team, as she has a great responsibility to ensure that everything goes according to plan and that both the baby and the mother are protected at all times.

To ensure that the midwife fulfills her duties and responsibilities properly, it is necessary that she has access to continuous training and updating of knowledge. The midwife may attend specialized courses that provide in-depth knowledge in anesthesia management and surgical care, may attend courses in life support and emergency management, etc.

**Keywords:** *operating room, surgery, midwife, intervention*

# KUJDESI INFEMIEROR NË TRAJTIMIN E DEPRESIONIT POST-PARTUM

**LEDIA SHORJA[1]**

[1]*Infermiere instrumetare, Spitali Rajonal Durrës*
[1]*Sherbimi Obstetrike –Gjinekologji*

**Hyrje:** Depresioni post-partum është një çrregullim mjaft i zakonshëm që ndikon shumë në shëndetin mendor të nënave pas lindjes. Ai mund të ketë ndikim të thellë në kujdesin ndaj fëmijës, marrëdhëniet familjare dhe mirëqenien emocionale të nënës. Kjo është arsyeja pse kujdesi infermieror luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e depresionit post-partum, duke ofruar mbështetje emocionale, edukative dhe praktike për gratë që kalojnë këtë periudhë të vështirë.

**Qëllimi:** Në këtë diskutim, do të shqyrtojmë rëndësinë e kujdesit infermieror për gratë me depresion post-partum, rolin e infermierëve në identifikimin dhe mbështetje, si dhe ndikimin e mbështetjes infermierore në shëndetin mendor të nënave.

**Metodologjia:** Biseda dhe intervista me gruan për të kuptuar emocionet, stresin dhe shqetësimet që mund të ketë pas lindjes. Përdorimi i shkallëve të vlerësimit, si Edinburgh Postnatal Depression Scale (EPDS), për të identifikuar simptomat e depresionit.

**Rezultate:** Bisedat ndihmojnë për të krijuar një hapësirë të sigurt ku gruaja mund të shprehë ndjenjat dhe shqetësimet e saj, duke ndihmuar në përmirësimin e ndjeshmërisë emocionale dhe mbështetjes për shëndetin mendor të nënës. Ky proces mund të kontribuojë në zvogëlimin e ndjenjave të vetmisë dhe izolimit, duke krijuar mundësi për lidhje emocionale më të forta me partnerin, familjen, dhe shoqërinë.

**Konkluzione:** Infermierët janë të pranishëm në disa faza të kujdesit shëndetësor të nënave, duke përfshirë periudhën pas lindjes. Ata janë një burim kyç mbështetjeje për gratë që mund të përjetojnë depresion post-partum, i cili shpesh mund të kalojë pa u vënë re, për shkak të stigmatizimit social dhe shenjave që mund të jenë të padukshme për të tjerët.

Infermierët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe menaxhimin e depresionit post-partum, duke ofruar mbështetje emocionale, edukative dhe trajtim të specializuar. Pavarësisht sfidave që mund të hasen, mbështetje e vazhdueshme dhe udhëzime të kuptueshme mund të bëjnë një ndryshim të madh për gratë që përjetojnë depresion post-partum dhe mund të ndihmojnë në një rikuperim më të shpejtë dhe të qëndrueshëm.

**Fjalë kyç:** *Depresioni post-partum, kujdes infermieror, mbështetje emocionale.*

# NURSING CARE IN THE TREATMENT OF POSTPARTUM DEPRESSION

**LEDIA SHORJA**[1]

[1]*Instrumental Nurse, Durrës Regional Hospital*
[1]*Obstetrics and Gynecology Service*

**Introduction:** Postpartum depression is a very common disorder that greatly affects the mental health of mothers after childbirth. It can have a profound impact on child care, family relationships and the emotional well-being of the mother. This is why nursing care plays an important role in the management of postpartum depression, providing emotional, educational and practical support for women going through this difficult period.

**Purpose:** In this discussion, we will examine the importance of nursing care for women with postpartum depression, the role of nurses in identification and support, as well as the impact of nursing support on the mental health of mothers.

**Methodology:** Conversation and interview with the woman to understand the emotions, stress and concerns that she may have after childbirth. Using assessment scales, such as the Edinburgh Postnatal Depression Scale (EPDS), to identify symptoms of depression.

**Results:** Conversations help to create a safe space where the woman can express her feelings and concerns, helping to improve emotional sensitivity and support for the mother's mental health. This process can contribute to reducing feelings of loneliness and isolation, creating opportunities for stronger emotional connections with the partner, family, and community.

**Conclusions:** Nurses are present at several stages of maternal health care, including the postpartum period. They are a key source of support for women who may experience postpartum depression, which can often go unnoticed, due to social stigma and signs that may be invisible to others.

Nurses can play an important role in identifying and managing postpartum depression, by providing emotional support, education, and specialized treatment. Despite the challenges that may be encountered, ongoing support and understandable guidance can make a big difference for women experiencing postpartum depression and can help them recover more quickly and sustainably.

**Keywords:** *Postpartum depression, nursing care, emotional support.*

# FAKTORËT E RISKUT PËR KOMPLIKIME TË ASTMËS NË SHTATZANI

**BRIKENA DUKA[1], BEHIJE GOLLOBËRDA[1], ELONA DYBELI[1], ANDJA LALA[1]**

*[1] As/Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"*

e-mail: brikena.duka@uniel.edu.al

**Hyrje:** Astma është një gjendje inflamatore kronike që mund të prekë deri në 10% të grave në periudhën e shtatëzanisë. Astma gjatë shtatzanisë është një çështje e rëndësishme e shëndetit publik, sepse përbën një kërcënim të zakonshëm, gjithnjë e më të përhapur për shëndetin e grave dhe fëmijëve të tyre. Astma mund të komplikohet nga ndryshimet normale fiziologjike që ndodhin gjatë shtatzanisë, nga ekspozimi ndaj faktorëve mjedisore (alergjenët) si dhe nga mungesa e kontrollit të sëmundjes e cila mund të ndikojë negativisht si në cilësinë e jetës së nënës por edhe në zhvillimin e fetusit.

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij studimi është shqyrtimi i literaturës ekzistuese për të identifikuar faktorët e rrezikut që mund të çojnë në komplikime të mundshme gjatë shtatzanisë duke përfshirë mënyrën e trajtimit dhe menaxhimit të sëmundjes me qëllim përmirësimin e kujdesit shëndetësor në këtë grup popullate.

**Metodologjia:** Rishikim sistematik i literaturës. Kërkimi u realizua në platforma si: PubMed, Google Scholar, CINAHL dhe ELSEVIER duke përdorur termat kyç në gjuhën angleze "Asthma", "pregnancy", "fetus", "risk factors". Rishikimi i literaturës u fokusua në artikujt e publikuara gjatë 10 viteve të fundit. Fillimisht u përzgjodhën 35 artikuj, por pas aplikimit të kritereve të perfshirjes dhe përjashtimit u përzgjodhën gjithësej 10 artikuj që përmbushnin më së miri qëllimin tonë.

**Rezultati:** Ky rishikim sistematik ka vërtetuar se astma e moderuar ose e rënduar, duhanpirja, obeziteti, infeksionet virale, përkatësia etnike shoqerohen me një rrezik më të lartë për komplikime të astmës në shtatzani. Gjithashtu ky rishikim ka vërtetuar një rrezik të shtuar për komplikime të astmës edhe te grat shtatzena që vuajnë nga ankthi ose depresioni.

**Konkluzione dhe Rekomandime:** Rekomandohet për profesionistët e kujdesit shëndetësor të cilët synojnë reduktimin e komplikimit të astmës gjatë shtatzanisë që të trajtojnë faktorët e modifikueshëm si: duhanpirja dhe obeziteti. Gjithashtu përmirësimet në menaxhimin e astmës për të parandaluar acarimet e sëmundjes mund të çojnë në rezultate më të mira për shëndetin e nënës dhe të fetusit.

**Fjalë kyçe:** *astmë, shtatzani, faktor rrisku, menaxhim.*

# RISK FACTORS FOR ASTHMA COMPLICATIONS IN PREGNANCY

**BRIKENA DUKA[1], BEHIJE GOLLOBËRDA[1], ELONA DYBELI[1], ANDJA LALA[1]**

*[1] As/Lecturer, Faculty of Medical Technical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"*
e-mail: brikena.duka@uniel.edu.al

**Introduction:** Asthma is a chronic inflammatory condition that can affect up to 10% of women during pregnancy. Asthma during pregnancy is an important public health issue, because it constitutes a common, increasingly widespread threat to the health of women and their children. Asthma can be complicated by normal physiological changes that occur during pregnancy, by exposure to environmental factors (allergens) as well as by lack of disease control which can negatively affect both the quality of life of the mother and the development of the fetus.
**Purpose:** The purpose of this study is to review the existing literature to identify risk factors that may lead to potential complications during pregnancy, including the treatment and management of the disease, with the aim of improving healthcare in this population group.
**Methodology:** Systematic literature review. The search was conducted on platforms such as: PubMed, Google Scholar, CINAHL and ELSEVIER using the key terms in English "Asthma", "pregnancy", "fetus", "risk factors". The literature review focused on articles published during the last 10 years. Initially, 35 articles were selected, but after applying the inclusion and exclusion criteria, a total of 10 articles were selected that best met our purpose.
**Results:** This systematic review has confirmed that moderate or severe asthma, smoking, obesity, viral infections, ethnicity are associated with a higher risk of asthma complications in pregnancy. This review also found an increased risk of asthma complications in pregnant women with anxiety or depression.
**Conclusions & Recommendations:** It is recommended that healthcare professionals who aim to reduce asthma complications during pregnancy address modifiable risk factors such as smoking and obesity. Improvements in asthma management to prevent exacerbations may also lead to better outcomes for maternal and fetal health.
**Keywords:** *Asthma, Pregnancy, Risk Factor, Management.*

# HIPERTENSIONI – PATOLOGJIA MË E PËRHAPUR NË SHTATËZANI

**FASELA IBRAHIMI[1]**

[1] *Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik ´´ Mbretëresha Geraldinë `´*

**Hyrje:** Çrregullimet hipertensive të shtatzënisë janë ndër shkaqet kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë maternale dhe fetale në mbarë botën. Gjendje si pre-eklampsia, eklampsia dhe sindroma HELLP përfaqësojnë komplikacione të rënda që kërkojnë diagnozë dhe trajtim në kohë.
**Metodologjia:** Është kryer një rishikim i literaturës së fundit shkencore, udhëzimeve klinike dhe meta-analizave për të përmbledhur njohuritë aktuale dhe perspektivat e reja mbi këto patologji. Matja e presionit të gjakut është metoda më themelore dhe e rëndësishme për diagnostikimin dhe menaxhimin e hipertensionit në shtatzëni. Presioni i gjakut duhet të matet rregullisht gjatë çdo vizite prenatale.
**Rezultatet:** Hipertensioni gjatë shtatzënisë shoqërohet me disfunksion endotelial, zhvillim jonormal placentar dhe inflamacion sistemik, duke kontribuar në përfshirjen e shumë organeve. Pre-eklampsia karakterizohet nga hipertensioni i ri-shfaqur dhe proteinuria, ndërsa eklampsia paraqitet me kriza konvulsive si një ndërlikim i rëndë. Sindroma HELLP përfshin hemolizën, rritjen e enzimave hepatike dhe trombocitopeninë, shpesh duke kërkuar ndërhyrje mjekësore urgjente. Strategjitë e menaxhimit përfshijnë terapi antihipertensive, administrimin e sulfatit të magnezit për parandalimin e krizave konvulsive dhe lindjen në kohën e duhur për të shmangur komplikacionet e rënda.
**Konkluzionet:** Identifikimi i hershëm dhe menaxhimi adekuat i çrregullimeve hipertensive të shtatzënisë janë thelbësore për reduktimin e komplikacioneve maternale dhe neonatale. Nevojiten kërkime të mëtejshme për të përmirësuar strategjitë e parashikimit, parandalimit dhe trajtimit, me qëllim optimizimin e rezultateve klinike. Hipertensioni në shtatzëni është një gjendje që kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe ndërhyrje të hershme për të siguruar një shtatzëni të shëndetshme dhe për të minimizuar rrezikun për nënën dhe foshnjën. Me trajtim të duhur, shumica e grave mund të menaxhojnë këtë gjendje dhe të kenë një lindje të sigurt. Është e rëndësishme të theksohet rëndësia e diagnostikimit të hershëm, trajtimit dhe menaxhimit të hipertensionit gjatë shtatzënisë për të parandaluar komplikacione të mundshme për nënën dhe fëmijën. Ky studim synon të përmirësojë praktikat e kujdesit shëndetësor, edukatën e nënave dhe strategjitë e menaxhimit të hipertensionit për të siguruar një shtatzëni të shëndetshme dhe të sigurt.
**Fjalë kyç:** *Hipertensioni në shtatzëni,pre-eklampsia, eklampsia, Sindroma HELLP, menaxhimi obstetrik.*

# HYPERTENSION – THE MOST COMMON PATHOLOGY IN PREGNANCY

**FASELA IBRAHIMI[1]**

[1]*Queen Geraldine Obstetric and Gynecological University Hospital*

**Introduction:** Hypertensive disorders of pregnancy are among the leading causes of maternal and fetal morbidity and mortality worldwide. Conditions such as pre-eclampsia, eclampsia, and HELLP syndrome represent serious complications that require timely diagnosis and treatment.

**Methodology:** A review of the latest scientific literature, clinical guidelines, and meta-analyses was performed to summarize current knowledge and new perspectives on these pathologies. Blood pressure measurement is the most basic and important method for the diagnosis and management of hypertension in pregnancy. Blood pressure should be measured regularly during each prenatal visit.

**Results:** Hypertension during pregnancy is associated with endothelial dysfunction, abnormal placental development, and systemic inflammation, contributing to multiorgan involvement. Pre-eclampsia is characterized by recurrent hypertension and proteinuria, while eclampsia presents with convulsive seizures as a severe complication. HELLP syndrome includes hemolysis, elevated liver enzymes, and thrombocytopenia, often requiring urgent medical intervention. Management strategies include antihypertensive therapy, administration of magnesium sulfate to prevent seizures, and timely delivery to avoid severe complications.

**Conclusions:** Early identification and adequate management of hypertensive disorders of pregnancy are essential for reducing maternal and neonatal complications. Further research is needed to improve prediction, prevention, and treatment strategies to optimize clinical outcomes. Hypertension in pregnancy is a condition that requires continuous monitoring and early intervention to ensure a healthy pregnancy and minimize risk to the mother and baby. With appropriate treatment, most women can manage this condition and have a safe delivery. It is important to emphasize the importance of early diagnosis, treatment, and management of hypertension during pregnancy to prevent potential complications for the mother and baby. This study aims to improve healthcare practices, maternal education, and hypertension management strategies to ensure a healthy and safe pregnancy.

**Keywords:** *Hypertension in pregnancy, pre-eclampsia, eclampsia, HELLP syndrome, obstetric management.*

# MONITORIMI I GRUAS SHTATZËNË DHE PËRGATITJA E GRUAS PËR PROCESIN E LINDJES.

**EGLANTINA CUFAJ[1]**

[1]*Infermiere në Qendrën Shëndetësore, Sukth*

**Hyrje:** Monitorimi i gruas shtatzënë është një proces i vazhdueshëm që përfshin kontrollimin e shëndetit të gruas dhe zhvillimin e fëmijës gjatë gjithë shtatzënisë. Ky monitorim ka për qëllim parandalimin e komplikacioneve dhe identifikimin e mundësive të rrezikut që mund të ndikojnë në nënën ose fëmijën. Kujdesi infermieror gjatë shtatzanisë dhe përgatitja e gruas për procesin e lindjes, është një ndër detyrat e infermieres.

**Qëllimi:** Ky studim ka për qëlim zbatimin e etapave te procesit infermieror tek një grua dhe përgatitja e saj për fazën e lindjes. Gjithashtu ka për qëllim të ndihmojë gruan të përgatitet për procesin e lindjes dhe ardhjen në jetë të fëmijës, në mënyrë sa më të natyrshme. Të sigurojë edukim shëndetësor mbi ushqyerjen, higjienën, veshjen, ushtrimet e nevojshme dhe rëndësinë që ka lidhja nënë-fëmijë.

**Metodologjia:** Tek kujdesi infemieror, i cili zë një vend të rëndësishëm, gruaja është ndjekur hap pas hapi duke përfshirë vizitat e bëra te mjeku gjinekolog, ekzaminime laboratorike, ekzaminime ekografike.

**Rezultatet:** Monitorimi përfshin një vlerësim të vazhdueshëm të shëndetit të gruas, duke përfshirë matjen e presionit të gjakut, ndjekjen e peshës, testet për diabetin gestacional dhe analizat laboratorike. Po ashtu, zhvillimi dhe gjendja e fetusit monitorohen me anë të ekografisë dhe testimeve të tjera për të siguruar një shtatzani të shëndetshme.

Monitorimi rregullt ndihmon për të siguruar që gruaja është duke kaluar shtatzëninë pa komplikacione dhe që nuk ka probleme të shëndetit si hipertensioni, diabeti gestacional ose infeksionet. Ekografia dhe testet e tjera mund të ndihmojnë për të kontrolluar rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, për të siguruar që ai po zhvillohet siç duhet dhe nuk ka probleme të mundshme.

Monitorimi i rregullt ndihmon për të siguruar që kujdesi prenatal të jetë në përputhje me standardet dhe protokollet mjekësore ndërkombëtare. Ajo mund të ndihmojë për të identifikuar gratë që janë në rrezik për lindje të parakohshme dhe të ndërmerren masat parandaluese.

**Fjalë kyç:** *Shtatzani, kujdes infermierore, monitorim.*

# MONITORING THE PREGNANT WOMAN AND PREPARING THE WOMAN FOR THE BIRTH PROCESS.

**EGLANTINA CUFAJ[1]**

[1]*Nurse at the Health Center, Sukth*

**Introduction:** Monitoring the pregnant woman is a continuous process that includes checking the woman's health and the child's development throughout pregnancy. This monitoring aims to prevent complications and identify potential risks that may affect the mother or child. Nursing care during pregnancy and preparing the woman for the birth process is one of the duties of the nurse.

**Purpose:** This study aims to implement the stages of the nursing process in a woman and prepare her for the birth phase. It also aims to help the woman prepare for the birth process and the birth of the child, in the most natural way possible. To provide health education on nutrition, hygiene, clothing, necessary exercises and the importance of the mother-child bond.

**Methodology:** In nursing care, which occupies an important place, the woman is followed step by step including visits to the gynecologist, laboratory examinations, ultrasound examinations.

**Results:** Monitoring includes a continuous assessment of the woman's health, including blood pressure measurement, weight monitoring, tests for gestational diabetes and laboratory tests. In addition, the development and condition of the fetus are monitored through ultrasound and other tests to ensure a healthy pregnancy.

Regular monitoring helps to ensure that the woman is going through the pregnancy without complications and that she does not have health problems such as hypertension, gestational diabetes or infections. Ultrasound and other tests can help to check the growth and development of the child, to ensure that he is developing properly and does not have any potential problems.

Regular monitoring helps to ensure that prenatal care is in accordance with international medical standards and protocols. It can help identify women at risk for preterm birth and take preventive measures.

**Keywords:** *Pregnancy, nursing care, monitoring.*

# NJOHURITË, VLERSIMI DHE NIVELI I BURNOUT TEK INFERMIERET-MAMI NË SPITALIN RAJONAL SHKODËR

**SILVANA BELISHA[1], VALBONA DIBRA[2], ELSIONA QALLIA[3], VERA GJINAJ[4], ARTA ZOGU**

*[1]Departamenti Infermieri, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"*

**Hyrje**: Burnout në personelin infermieror, është një gjendje serioze e lidhur me punën që mund të ketë pasoja të mëdha për infermierët, si edhe pacientët e tyre. Fatkeqësisht, burnout në personelin infermieror, sipas studime të ndryshme është në rritje, duke e bërë atë më të rëndësishme se kurrë për të kuptuar se si të menaxhohet dhe të parandalohet. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit përcaktohet si një lodhje mendore dhe fizike, mungese e përqëndrimit në punë, rënie / reduktim i performancës në punë.

**Qëllimi:** i ketij studimi është të përcaktohen njohurite, qëndrimet dhe niveli i burnout tek infermieret -mami ne spitalin rajonal Shkoder, dhe konkretisht në katër pavione, obstetrike, gjinekologji, salle lindjeje dhe neonatologji.

Materiali dhe metodologjia: Është një studim cross-sectional. Studimi është bërë në një periudhë 6 mujore shtator-shkurt 2024-2025. Në këtë studim morën pjesë 48 infermiere-mami,në spitalin rajonal Shkodër sipas pavioneve përkatëse të cilave ju është dhënë anketa online për plotësimin e saj, pasi konfirmuan dëshirën e tyre. Pytesori është i ndare në 4 seksione, të dhënat demografike, karakteristikat e punës, vleresimi i nivelit të Burnout dhe pyetje rreth njohurive të burnout-it. Të dhënat për të matur nivelin e Burnout u bënë sipas pikëzimit të Inventarit të Burnout Maslach (MBI).

**Rezultat :** Studimi tregon për një nivel mesatar të bounout. Rraskapitja emocionale paraqitet në nivele të larte ≥ 27, 79.16%. Depersonalizimi dhe Arritjet personale paraqiten në nivele të moderuara.

72.9% pranojnë që nuk kanë dëgjuar për Burnout, dhe vetëm 15% njohin faktorët që mund të shkaktojne bournout.

**Konkluzionet:** Infermieret mami kanë njohuri shumë të pakta për bournout në këtë mënyrë ato nuk dinë të përcaktojnë faktorët ë rrezikut që mund të ndikojnë në shfaqjen e tij, dhe rolin që luan bournout në kujdesin ë pacientevë. Prandaj infermieret-mami kanë nevojë për edukim nëpërmjet trajtimeve.

**Fjalet kyce:** *burn out, depersonalizim, tejlodhje emocionale, arritje personale, performance.*

# KNOWLEDGE, ASSESSMENT AND LEVEL OF BURNOUT AMONG NURSES-MIDWIFE IN SHKODER REGIONAL HOSPITAL

**SILVANA BELISHA[1], VALBONA DIBRA[2], ELSIONA QALLIA[3], VERA GJINAJ[4], ARTA ZOGU**

*[1]Departamenti Infermieri, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"*

**Introduction:** Nursing burnout is a serious work-related condition that can have significant consequences for nurses and their patients. Unfortunately, burnout among nurses is on the rise according to various studies, making it more important than ever to understand how to manage and prevent it. According to the World Health Organization, it is defined as mental and physical exhaustion, lack of concentration at work, decline / reduction in performance at work.

**Aim:** This study aims to determine the knowledge, attitudes and level of burnout among nurses-midwives in Shkoder Regional Hospital and specifically in four wards, obstetrics, gynecology, delivery room and neonatology.

**Material and methodology:** This is a cross-sectional study. The study was conducted over a period of 6 months from September to February 2024-2025. This study involved 48 midwives in Shkodra Regional Hospital, according to their respective wards, who were given an online survey to complete after confirming their willingness. The questionnaire is divided into 4 sections, demographic data, work characteristics, assessment of the level of burnout and questions about knowledge of burnout. The data to measure the level of burnout were made according to the Maslach Burnout Inventory (MBI) score.

**Results:** The study shows an average level of burnout. Emotional exhaustion is presented at high levels $\geq 27$, 79.16%. Depersonalization and personal accomplishment are presented at moderate levels. 72.9% admit that they have never heard of burnout and only 15% know the factors that can cause burnout.

**Conclusions:** Nurse midwives have very little knowledge about burnout and therefore do not know how to identify the risk factors that may affect its occurrence and the role that burnout plays in patient care. Therefore, nurse midwives need education through treatment.

**Keywords:** *burnout, depersonalization, emotional exhaustion, personal accomplishment, performance.*

# ROLI I MAMIVE NË PROMOVIMIN E NJË STILI JETESE TË SHËNDETSHME GJATË SHTATZANISË NË SHQIPËRI

**SHPRESA MOLLA[1]**

[1]*Materniteti Lezhë*
[1]*Presidente e UISH Qarku Lezhë*

**Hyrje:** Shtatzënia është një periudhë kyçe që ndikon në shëndetin e gruas dhe fetusit, ku mamitë luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e sjelljeve të shëndetshme dhe marrjen e vendimeve të informuara. Megjithatë, në Shqipëri, niveli i përfshirjes së tyre në promovimin e një stili jetese të shëndetshëm mbetet i paqartë. Ky studim synon të eksplorojë rolin e mamive, të identifikojë sfidat dhe të propozojë strategji për rritjen e ndikimit të tyre në kujdesin para lindjes.
**Qëllimi**: Të vlerësojë rolin e mamive në promovimin e një stili jetese të shëndetshme gjatë shtatzanisë së femrave në Shqipëri.
**Metodologjia:** Ky studim është realizuar përmes intervistave direkte te profesionistët e mamive. Janë marrë në studim mami që punojnë në zona urbane dhe rurale në të gjithë Shqipërinë për të fituar njohuri mbi qasjet e tyre ndaj kujdesit prenatal dhe promovimit të shëndetit. Këto intervista kishin si qëllim për të eksploruar sfidat me të cilat ata përballen në promovimin e stilit të jetesës së shëndetshëm dhe burimet që ata kërkojnë për të përmirësuar praktikën e tyre.
**Rezultatet:** Mamitë luajnë një rol kyç në edukimin e grave mbi rëndësinë e ushqimit të balancuar, aktivitetit fizik të rregullt, menaxhimit të stresit dhe shëndetit mendor gjatë shtatzënisë. Megjithatë, sfida të tilla si trajnimi i kufizuar, mungesa e burimeve dhe barrierat kulturore për edukatën shëndetësore mund të ndikojnë në efektivitetin e rolit të tyre. Për më tepër, mund të vërehen dallime midis praktikave urbane dhe rurale, me zonat rurale që mund të përballen me pengesa më të mëdha në promovimin e shëndetit për shkak të aksesit të kufizuar në burimet shëndetësore.
**Konkluzione:** Mamitë në Shqipëri luajnë rol në promovimin e një stili jetese të shëndetshëm gjatë shtatzënisë, duke kontribuar ndjeshëm në rezultatet e shëndetit të nënës dhe fetusit. Megjithatë, për të maksimizuar ndikimin e tyre, ka nevojë për programe të përmirësuara trajnimi dhe një bashkëpunim më të fortë me profesionistët e tjerë të kujdesit shëndetësor. Zgjidhja e barrierave me të cilat përballen mamitë mund të çojë në edukim më të mirë shëndetësor dhe mbështetje për gratë shtatzëna, duke përmirësuar në fund rezultatet e shëndetit të nënës dhe fëmijës në Shqipëri. Rekomandimet përfshijnë ofrimin e materiale edukative të përditësuara për mamitë, rritjen e aksesit në burime shëndetësore prenatale dhe sigurimin e zhvillimit profesional të vazhdueshëm për t'i pajisur ata me njohuri më të mira në lidhje me promovimin e një stili jetese të shëndetshëm gjatë shtatzënisë.
***Fjalë kyçe:*** *stil jetese, shtatzani, mami, Shqipëri*

# THE ROLE OF MIDWIFE IN PROMOTING A HEALTHY LIFESTYLE DURING PREGNANCY IN ALBANIA

**SHPRESA MOLLA[1]**

*[1]Lezha Maternity Hospital*
*[1]President of UISH Lezhë Region*

**Introduction:** Pregnancy is a key period that affects the health of the woman and the fetus, where midwives play an important role in supporting healthy behaviors and making informed decisions. However, in Albania, the level of their involvement in promoting a healthy lifestyle remains unclear. This study aims to explore the role of midwives, identify challenges and propose strategies to increase their impact in prenatal care.

**The aim:** To assess the role of midwives in promoting a healthy lifestyle during pregnancy of women in Albania.

Methodology: This study was conducted through direct interviews with midwifery professionals. Midwives working in urban and rural areas across Albania were interviewed to gain insight into their approaches to prenatal care and health promotion. These interviews aimed to explore the challenges they face in promoting healthy lifestyles and the resources they seek to improve their practice.

**Results:** Midwives play a key role in educating women about the importance of a balanced diet, regular physical activity, stress management, and mental health during pregnancy. However, challenges such as limited training, lack of resources, and cultural barriers to health education may impact the effectiveness of their role. Furthermore, differences can be observed between urban and rural practices, with rural areas potentially facing greater barriers to health promotion due to limited access to health resources.

**Conclusions:** Midwives in Albania play a role in promoting a healthy lifestyle during pregnancy, contributing significantly to maternal and fetal health outcomes. However, to maximize their impact, there is a need for improved training programs and stronger collaboration with other health care professionals. Addressing the barriers faced by midwives could lead to better health education and support for pregnant women, ultimately improving maternal and child health outcomes in Albania. Recommendations include providing updated educational materials to midwives, increasing access to prenatal health resources, and ensuring continuing professional development to equip them with better knowledge about promoting a healthy lifestyle during pregnancy.

**Keywords:** *lifestyle, pregnancy, midwife, Albania*

# RËNDËSIA E USHQYERJES ME GJI, PËRFITIMET SHËNDETËSORE DHE SFIDAT E ZBATIMIT NË SHQIPËRI

**ANILA JANEVA[1]**

[1]*Infermiere, Institucioni Shtëpia e Lindjes Korçë*

**Hyrje:** Studimet dhe kërkimet shkencore theksojnë rëndësinë e qumështit të gjirit për shëndetin e foshnjës, duke e konsideruar atë si ushqimin ideal që përmbush nevojat e saj ushqyese dhe imunologjike. Përbërja e tij e pasur me proteina, lipide, karbohidrate dhe antitrupa ka bërë që organizata të njohura ndërkombëtare, si OBSH dhe UNICEF, të rekomandojnë ushqyerjen ekskluzive me gji deri në gjashtë muajt e parë të jetës. Në Shqipëri, pavarësisht njohurive mbi përfitimet e gjidhënies, normat e ushqyerjes ekskluzive me gji mbeten të ulëta në krahasim me vendet e tjera europiane.
**Qëllimi:** Ky punim ka për qëllim të analizojë përfitimet shëndetësore të ushqyerjes me gji dhe të identifikojë sfidat kryesore në zbatimin dhe promovimin e saj në Shqipëri.
**Metodologjia:** Studimi është retrospektiv dhe është realizuar në disa qendra shëndetësore dhe maternitet në qytetin e Korces. Ai është bazuar në anketime të kryera me 50 nëna të porsalindura dhe 40 infermiere gjatë periudhës 2022 –2024. Anketat janë dizajnuar për të vlerësuar njohuritë e nënave mbi rëndësinë e gjidhënies, vështirësitë që përjetojnë, si dhe mbështetjen institucionale të ofruar. Të dhënat e marra janë analizuar në mënyrë statistikore për të identifikuar faktorët që ndikojnë në shkallën e ushqyerjes me gji.
**Rezultatet:** Të dhënat tregojnë se shumica e nënave janë të informuara për përfitimet e ushqyerjes me gji, por përballen me barriera të ndryshme, përfshirë mungesën e mbështetjes profesionale dhe sociale, ndikimin e marketingut të qumështit të formulës dhe sfidat praktike në vendin e punës.
**Përfundim:** Shqipëria ka miratuar politika për promovimin e gjidhënies, por zbatimi i tyre mbetet një sfidë. Është e nevojshme të forcohet mbështetja institucionale për nënat, duke përfshirë edukimin e tyre gjatë shtatzënisë, krijimin e hapësirave për ushqyerjen me gji në vendin e punës dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e gjidhënies. Ushqyerja me gji krijon një lidhje emocionale dhe afektive të fortë midis nënës dhe foshnjës, duke përmirësuar lidhjen ndërpersonale dhe siguruar një ndjenjë sigurie për foshnjën.
**Fjalë kyçe:** *Gjidhënia, përfitimet shëndetësore, nënat, sfidat institucionale, mbështetja profesionale.*

# THE IMPORTANCE OF BREASTFEEDING, HEALTH BENEFITS AND IMPLEMENTATION CHALLENGES IN ALBANIA

**ANILA JANEVA**[1]

[1]*Nurse, Birth Home Korça Institution*

**Introduction:** Studies and scientific research emphasize the importance of breast milk for the health of the baby, considering it as the ideal food that meets its nutritional and immunological needs. Its composition rich in proteins, lipids, carbohydrates and antibodies has led well-known international organizations, such as WHO and UNICEF, to recommend exclusive breastfeeding for up to the first six months of life. In Albania, despite the knowledge about the benefits of breastfeeding, exclusive breastfeeding rates remain low compared to other European countries.

**Purpose of the paper:** This paper aims to analyze the health benefits of breastfeeding and identify the main challenges in its implementation and promotion in Albania.

**Methodology:** The study is retrospective and was conducted in several health and maternity centers in the city of Korca. It is based on surveys conducted with 50 newborn mothers and 40 nurses during the period 2022 –2024. The surveys were designed to assess mothers' knowledge on the importance of breastfeeding, the difficulties they experience, as well as the institutional support provided. The data obtained were statistically analyzed to identify factors that influence the rate of breastfeeding.

**Results:** The data show that most mothers are informed about the benefits of breastfeeding, but face various barriers, including the lack of professional and social support, the influence of formula milk marketing, and practical challenges in the workplace.

**Conclusion:** Albania has adopted policies to promote breastfeeding, but their implementation remains a challenge. It is necessary to strengthen institutional support for mothers, including their education during pregnancy, the creation of spaces for breastfeeding in the workplace and awareness-raising on the importance of breastfeeding. Breastfeeding creates a strong emotional and affective bond between mother and baby, improving interpersonal bonding and providing a sense of security for the baby.

**Keywords:** *Breastfeeding, health benefits, mothers, institutional challenges, professional support.*

# NDIKIMI I BURIMEVE SPITALORE DHE DISPONUESHMERIA E MBESHTETJES PROFESIONALE TË EPIZIOTOMISË NË MATERNITETIN E DURRËSIT REZULTATET E SONDAZHEVE TË EPIZIOTOMISË 2024-2025

**SIDORELA HASANI FEZGA[1]**

[1]*Pedagoge UAMD;*
[1]*Mami salla operatore në maternitetin e Durrësit*

**Hyrje:** Studimet dhe kërkimet shkencore theksojnë rëndësinë e epiziotomisë për shëndetin e gruas, duke e konsideruar atë si një incizion shumë të domosdoshëm në disa raste për mirëqenien e fetale dhe atë amtare. Epiziotomia është një procedurë kirurgjikale që përfshin një prerje të perineumit për të lehtësuar lindjen vaginale. Historikisht, kjo ndërhyrje është përdorur gjerësisht, por studimet e fundit theksojnë nevojën për një qasje më selektive.

**Qëllimi i punimit**: Ky punim ka për qëllim të identifikojë indikacionet dhe kundërindikacionet për kryerjen e epiziotomisë.

**Metodologjia**: Studimi është prospektiv dhe është realizuar në Maternitetin e Durrësit, duke u bazuar në të dhënat e marra nga rastet klinike dhe rezultatet përkatëse. Subjektet e anketës kanë qenë të informuara në lidhje me indikacionet dhe kundërindikacionet e epiziotomisë dhe janë të njohura me rëndësinë e kësaj procedure për kujdesin ndaj shëndetit të gruas. Të dhënat e përftuara janë përpunuar në mënyrë statistikore.

**Rezultatet**: Në sa % të grave primipare realizohet epiziotomia, në sa % të grave sekundipare, terci dhe pluripare realizohet, dhe cilat janë kushtet e favorshme për t'u realizuar ajo? Epiziotomia nuk rekomandohet në mënyrë rutinore për të gjitha lindjet vaginale. Studimet kanë treguar se përdorimi rutinë i epiziotomisë mund të rrisë rrezikun e laceracioneve të rënda perineale dhe komplikacioneve të tjera. Prandaj, është e rëndësishme që kjo procedurë të kryhet vetëm kur ka indikacione të qarta mjekësore.

**Përfundim:** Një rëndësi të veçantë përsa i përket temës së epiziotomisë ka dhe roli i mamisë dhe ecuria postlindje e kësaj procedure.

Epiziotomia është një ndërhyrje që mund të jetë e dobishme në situata të caktuara gjatë lindjes, por përdorimi i saj duhet të jetë i kufizuar dhe i bazuar në indikacione të qarta mjekësore. Është e rëndësishme që personeli shëndetësor të ndjekë protokollet më të fundit dhe të ofrojë mbështetje profesionale për nënat gjatë dhe pas lindjes, duke siguruar një kujdes optimal dhe duke minimizuar rreziqet e mundshme.

**Fjalë kyce:** *Epiziotomia, indikacione ,kunderindikacione, nëna, personeli shëndetësor, mbështetja profesionale institucionale; paciente.*

# IMPACT OF HOSPITAL RESOURCES AND AVAILABILITY OF PROFESSIONAL SUPPORT FOR EPIZIOTOMY IN DURRES MATERNITY RESULTS OF EPIZIOTOMY SURVEYS 2024-2025

**SIDORELA HASANI FEZGA[1]**

*[1]UAMD Pedagogue;*
*[1]Operating room midwife in Durres maternity*

**Introduction:** Studies and scientific research emphasize the importance of episiotomy for women's health, considering it as a very necessary incision in some cases for the well-being of the fetus and the mother. Episiotomy is a surgical procedure that involves an incision of the perineum to facilitate vaginal birth. Historically, this intervention has been widely used, but recent studies emphasize the need for a more selective approach.

**Purpose of the paper:** This paper aims to identify the indications and contraindications for performing episiotomy.

**Methodology:** The study is prospective and was conducted at the Durrës Maternity Hospital, based on data obtained from clinical cases and relevant results. The survey subjects were informed about the indications and contraindications of episiotomy and are familiar with the importance of this procedure for caring for women's health. The data obtained were statistically processed.

**Results:** In what % of primiparous women is episiotomy performed, in what % of secundari, terti and pluriparous women is it performed, and what are the favorable conditions for performing it? Episiotomy is not routinely recommended for all vaginal births. Studies have shown that the routine use of episiotomy may increase the risk of severe perineal lacerations and other complications. Therefore, it is important that this procedure is performed only when there are clear medical indications.

**Conclusion:** Of particular importance regarding the topic of episiotomy is the role of the midwife and the postpartum course of this procedure.

Episiotomy is an intervention that can be useful in certain situations during childbirth, but its use should be limited and based on clear medical indications. It is important that health personnel follow the latest protocols and provide professional support to mothers during and after childbirth, ensuring optimal care and minimizing possible risks.

**Keywords:** *Episiotomies, indications, contraindications, mothers, healthcare personnel, institutional professional support; patients.*

# RAPORTI MIDIS OBEZITETIT DHE SHËNDETIT RIPRODHUES FEMËROR

**IVIA ELEZI**[1]

[1] *Mami, S.U.O.GJ "Koco Gliozheni"*

**Hyrje:** Obeziteti është një problem madhor shëndetësor global që ka një ndikim të konsiderueshëm në mirëqenien e përgjithshme të gruas, duke përfshirë edhe shëndetin riprodhues. Studime të shumta kanë treguar një lidhje të qartë midis mbipeshës dhe një sërë problemesh riprodhuese, duke përfshirë çrregullimet menstruale, infertilitetin dhe komplikacionet gjatë shtatzënisë. Për më tepër, obeziteti ka pasoja afatgjata shëndetësore si për nënën ashtu edhe për fëmijën, që shtrihen përtej periudhës së shtatzënisë dhe lindjes. Marrëdhënia komplekse midis obezitetit, çekuilibrave hormonalë dhe çrregullimeve metabolike mund të ndikojë në proceset delikate të konceptimit dhe shtatzënisë, duke e bërë këtë një çështje kyçe në shëndetin e grave. Përballimi i këtyre sfidave kërkon krijimin e metodave të individualizuara për të përmirësuar rezultatet te gratë obeze.

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij artikulli është të shqyrtojë ndikimin e obezitetit në shëndetin riprodhues femëror, duke përfshirë çekuilibrat hormonalë, funksionin ovarian dhe rezultatet e shtatzënisë.

**Metodologjia:** U krye një studimi literaturës, duke analizuar studime klinike, meta-analiza dhe udhëzime të publikuara gjatë dekadës së fundit. Çështjet kryesore të diskutuara ishin sindroma e ovarit policistik (PCOS), rezultatet e teknologjive të asistuara të riprodhimit dhe shëndeti nënë-foshnjë.

**Rezultate:** Obeziteti mund të krijojë çekuilibër hormonal dhe zhvillim të reduktuar të folikulave. Masa e tepërt dhjamore lidhet ngushtë me rezistencën ndaj insulinës dhe nivelet e larta të androgjeneve, që shpesh rezultojnë në joovulim dhe infertilitet. Për më tepër, gratë obeze që i nënshtrohen teknologjive të asistuara të riprodhimit kanë norma më të ulëta suksesi dhe një gjasë më të madhe për abort spontan. Rezultatet e shtatzënisë preken gjithashtu, me rritjen e rrezikut për diabet gestacional, çrregullime hipertensive dhe nevojën për lindje cezariane.

**Diskutime:** Obeziteti ndikon ndjeshëm në shëndetin riprodhues të grave, duke përfshirë fertilitetin, ecurinë e shtatzënisë dhe shëndetin afatgjatë si për nënën ashtu edhe për fëmijën. Menaxhimi i obezitetit nëpërmjet ndryshimeve të synuara në stilin e jetesës, ndërhyrjeve farmakologjike dhe trajtimeve të personalizuara të fertilitetit mund të përmirësojë rezultatet riprodhuese. Nevojiten më shumë studime për të zhvilluar strategji të përshtatura që ndihmojnë gratë në moshë riprodhuese të menaxhojnë obezitetin dhe pasojat e tij.

***Fjalë kyçe:*** *Obeziteti, fertiliteti, femrat, shëndeti*

# THE RELATIONSHIP BETWEEN OBESITY AND FEMALE REPRODUCTIVE HEALTH

**IVIA ELEZI[1]**

*[1]Midwife, S.U.O.GJ "Koco Gliozheni"*

**Introduction:** Obesity is a major global health problem that has a significant impact on women's overall well-being, including reproductive health. Numerous studies have shown a clear link between obesity and a range of reproductive problems, including menstrual disorders, infertility, and pregnancy complications. Furthermore, obesity has long-term health consequences for both mother and child, extending beyond the period of pregnancy and childbirth. The complex relationship between obesity, hormonal imbalances, and metabolic disorders can affect the delicate processes of conception and pregnancy, making this a key issue in women's health. Addressing these challenges requires the development of individualized approaches to improve outcomes in obese women.

**Purpose:** The purpose of this article is to review the impact of obesity on female reproductive health, including hormonal imbalances, ovarian function, and pregnancy outcomes.

**Methodology:** A literature review was conducted, analyzing clinical trials, meta-analyses, and guidelines published over the past decade. The main issues discussed were polycystic ovary syndrome (PCOS), outcomes of assisted reproductive technologies, and maternal-infant health.

**Results:** Obesity can create hormonal imbalances and reduced follicular development. Excess body fat is closely associated with insulin resistance and high androgen levels, which often result in anovulation and infertility. Furthermore, obese women undergoing assisted reproductive technologies have lower success rates and a higher likelihood of spontaneous abortion. Pregnancy outcomes are also affected, with increased risk of gestational diabetes, hypertensive disorders, and the need for cesarean delivery.

**Discussion:** Obesity significantly impacts women's reproductive health, including fertility, pregnancy outcome, and long-term health for both mother and child. Managing obesity through targeted lifestyle changes, pharmacological interventions, and personalized fertility treatments can improve reproductive outcomes. More research is needed to develop tailored strategies that help women of reproductive age manage obesity and its consequences.

**Keywords:** *Obesity, fertility, women, health*

# IKTERI I TË PORSALINDURIT

**ABLA ÇUKO[1], MIRELA META[2], ELISABETA RISTA[3]**

*[1]Kry/Inf.në shërbimin Neonatit në Spitalin e Maternitetit Fier*
*[2]Mjeke , Shefe departamentit të Neonatologjisë ne Maternitetin e Spitalit Fier*
*[3]Infermiere, Presidente e UISH Qarku Fier*

**Hyrje:** Ikteri i të porsalindurit sipas studimeve dhe kërkimeve shkencore theksojnë për rëndësinë shëndetësore të foshnjes.Prodhimi i bilirubinës dhe metabolizmi i saj,shkatërrimi i eritrociteve të tepërta pas lindjes,tek i porsalinduri,prodhon një sasi të shtuar të bilirubinës në gjak. Bilirubina është një produkt i shpërbërjes së qelizave të kuqe të gjakut të vjetra dhe normalisht përpunohen nga mëlçia. Në trupin e foshnjave të porsalindura, mëlçia ende mund të mos jetë plotësisht e zhvilluar për të përpunuar bilirubinën, gjë që mund të shkaktojë nivele të larta të bilirubinës në gjak dhe të çojë në ikter. Në shumicën e rasteve ikteri i të porsalindurit është situatë fiziologjike, që kalon lehtë dhe pa mjekim.Në disa raste ikteri është patologjik, le pasoja dhe mund të kërcënoj jetën e të porsalindurit,me ndaj kërkon trajtim të menjëhershëm. Depozitimi i bilirubinës në indin trunor, që shkakton dëmtime neurologjike të parikthyeshme.

**Qëllimi:** Ky studim ka për qëllim rritjen e vëmëndjes për një shëndet sa më të mirë për të porsalindurin duke patur nën kontroll nivelet e bilirubinës dhe parandalimin e neurotoksicitetit prej saj.

**Metodologjia:** Informacionet e marra si dhe rastet klinike në këtë projekt janë marrë në Spitalin Rajonal të Fierit në shërbimin e Neonatologjisë në raste të asistuara ku në fëmijët e porsalindur me ikter aplikohet fototerapia për të ulur hyperbilirubinemine,të gjitha rastet janë ndjekur për muaj me radhë në rehabilitim ku metodologjia dhe objektivat tona kanë qënë të ndryshueshme në varesi të pacientit.

**Konkluzionet:** Shërbimi i neonatologjisë në Spitalin Fier tregon një kujdes të veçantë për fëmijët e porsalindur me ikter. Trajtimi i ikterit neonatal: Ushqyerje e bollshme dhe e shpeshtë, Fizioterapi, Plazëm e freskët, Imunoglobulinë, IgG intravenoz, Eksanguino transufuzion.

Në rastet më të rënda, ikteri mund të shkaktojë kernikterus, një formë e dëmtimit të trurit që është shkaktuar nga nivelet shumë të larta të bilirubinës. Ky është një gjendje mjaft serioze, por është e parandalueshme nëse trajtohet ikteri i foshnjës në kohë.

**Fjalë kyçe:** *Ikteri të porsalindurit, nënat, fototerapia, ushqyerja me gji, personel shëndetësor, mbështetja profesionale institucionale.*

# NEWBORN JAUNDICE

**ABLA ÇUKO[1], MIRELA META[2], ELISABETA RISTA[3]**

[1]*Head/Inf. of the Neonatology Service at the Fier Maternity Hospital*
[2]*Doctor, Head of the Neonatology Department at the Fier Maternity Hospital*
[3]*Nurse, President of UISH Qarku Fier*

**Introduction:** Newborn jaundice, according to studies and scientific research, emphasizes the importance of the baby's health. The production of bilirubin and its metabolism, the destruction of excess erythrocytes after birth, in the newborn, produces an increased amount of bilirubin in the blood. Bilirubin is a product of the breakdown of old red blood cells and is normally processed by the liver. In the body of newborn babies, the liver may not yet be fully developed to process bilirubin, which can cause high levels of bilirubin in the blood and lead to jaundice. In most cases, neonatal jaundice is a physiological situation that passes easily and without treatment. In some cases, jaundice is pathological, has consequences and can threaten the life of the newborn, therefore requiring immediate treatment. Deposition of bilirubin in the brain tissue, which causes irreversible neurological damage.

**Purpose:** This study aims to increase attention to the best possible health for the newborn by controlling bilirubin levels and preventing neurotoxicity from it.

**Methodology:** The information obtained and the clinical cases in this project were obtained at the Fier Regional Hospital in the Neonatology service in assisted cases where newborns with jaundice are treated with phototherapy to reduce hyperbilirubinemia, all cases were followed for months in rehabilitation where our methodology and objectives have been variable depending on the patient.

**Conclusions:** The neonatology service at Fier Hospital shows special care for newborns with jaundice. Treatment of neonatal jaundice: Abundant and frequent feeding, Physiotherapy, Fresh plasma, Immunoglobulin, Intravenous IgG, Exchange transfusion.

In the most severe cases, jaundice can cause kernicterus, a form of brain damage that is caused by very high levels of bilirubin. This is a very serious condition, but it is preventable if the baby's jaundice is treated in time.

**Keywords:** *Neonatal jaundice, mothers, phototherapy, breastfeeding, healthcare personnel, institutional professional support.*

# VLERËSIMI I BARRIERAVE ME TË CILAT PËRBALLEN MAMITË NË OFRIMIN E KUJDESIT PRE DHE POSTNATAL

**EGLANTINA HAXHIAJ [1]**

[1]*SUOGJ 'Koco Gliozheni' Maternity Hospital, Tirana*

**Hyrje:** Mamitë luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së nënave dhe të porsalindurve, duke ofruar kujdes gjatë shtatzënisë, lindjes dhe periudhës pas lindjes. Megjithatë, aftësia e tyre për të ofruar kujdes optimal shpesh pengohet nga sfida të ndryshme. Kuptimi i këtyre barrierave është thelbësor për përmirësimin e praktikave të kujdesit shëndetësor si dhe optimizimin e rezultateve të nënës dhe foshnjes. Ky studim eksploron vështirësitë që hasin mamitë gjatë dhënies së kujdesit, duke u fokusuar në faktorët organizativë, arsimorë dhe socio-kulturorë.

**Metodologjia:** Një qasje cilësore u përdor për të mbledhur njohuri nga 40 mami që punojnë në maternitete dhe qendra të kujdesit shëndetësor parësor në të gjithë Shqipërinë. Nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuara, mamitë ndanë përvojat dhe këndvështrimet e tyre. Të dhënat u analizuan në mënyrë tematike, duke identifikuar sfidat kryesore që ndikojnë në praktikën e tyre të përditshme.

**Rezultatet:** Gjetjet zbuluan disa pengesa të rëndësishme. Shumë mami raportuan se ndjeheshin të mbingarkuar për shkak të ngarkesave të mëdha të punës dhe mungesës së stafit, gjë që kufizoi kohën që mund t'i kushtonin secilit pacient. Qasja në udhëzimet klinike të përditësuara dhe mundësitë për edukimin e vazhdueshëm shpesh mungonin, duke e bërë të vështirë qëndrimin në përputhje me praktikat më të fundit të bazuara në prova. Për më tepër, strukturat hierarkike brenda ekipeve të kujdesit shëndetësor ndonjëherë kufizonin autonominë e mamive duke ndikuar në procesin e tyre të vendimmarrjes si dhe duke krijuar kompleksitete të mëtejshme në ofrimin e kujdesit me në qendër pacientin.

**Diskutime:** Mamitë përballen me sfida të ndryshme që ndikojnë si në kënaqësinë e tyre profesionale ashtu edhe në cilësinë e kujdesit që ofrojnë. Adresimi i këtyre barrierave kërkon një qasje të multiparametrike, duke përfshirë rritjen e suportit të stafit, sigurimin e aksesit në trajnime të vazhdueshme dhe nxitjen e një kulture që fuqizon mamitë brenda ekipeve multidisiplinare. Duke trajtuar këto çështje, mund të forcohen praktikat e mamisë, të përmirësohen rezultatet e nënës dhe neonatale dhe të mbështeten mamitë në ofrimin e kujdesit sa më optimal.

***Fjalët kyçe:*** *Mami, barriera, kujdesi i nënës, sfidat e kujdesit shëndetësor, zhvillimi profesional*

# ASSESSMENT OF BARRIERS FACED BY MIDWIFE IN PROVIDING PRE- AND POSTNATAL CARE

**EGLANTINA HAXHIAJ[1]**

*[1]SUOGJ 'Koco Gliozheni' Maternity Hospital, Tirana*

**Introduction:** Midwives play an important role in ensuring the health and well-being of mothers and newborns, by providing care during pregnancy, childbirth and the postpartum period. However, their ability to provide optimal care is often hampered by various challenges. Understanding these barriers is essential for improving healthcare practices and optimizing maternal and infant outcomes. This study explores the difficulties midwives face in providing care, focusing on organizational, educational and socio-cultural factors.

**Methodology:** A qualitative approach was used to gather insights from 40 midwives working in maternity hospitals and primary health care centers across Albania. Through semi-structured interviews, midwives shared their experiences and perspectives. The data were analyzed thematically, identifying key challenges that impact their daily practice.

**Results:** The findings revealed several important barriers. Many midwives reported feeling overwhelmed due to high workloads and staff shortages, which limited the time they could devote to each patient. Access to up-to-date clinical guidelines and opportunities for continuing education were often lacking, making it difficult to stay in line with the latest evidence-based practices. Furthermore, hierarchical structures within healthcare teams sometimes limited midwives' autonomy, influencing their decision-making process and creating further complexities in providing patient-centred care.

**Discussion:** Midwives face various challenges that impact both their professional satisfaction and the quality of care they provide. Addressing these barriers requires a multi-pronged approach, including increasing staff support, ensuring access to ongoing training, and fostering a culture that empowers midwives within multidisciplinary teams. By addressing these issues, midwifery practices can be strengthened, maternal and neonatal outcomes can be improved, and midwives can be supported to provide optimal care.

**Keywords:** *Midwifery, barriers, maternal care, healthcare challenges, professional development*

# KUJDESI I PLAGËVE POST-OPERATORE PAS LINDJES

**ELVIRA QOSJA [1], ADRIAN BETI [2]**

[1] *Spitali Rajonal "Xhaferr Kongoli", Elbasan*

Autori korrespondent: Elvira.Qosja@uniel.edu.al

**Hyrje:** Lindja cezariane është procedura kirurgjikale më e zakonshme në pavionet e obstetrikë-gjinekologjisë dhe infeksioni në vendin e plagës përbën një ndërlikim serioz për lehonën. Disa përparime të rëndësishme në masat parandaluese kanë treguar efektivitet në reduktimin e rrezikut të infeksionit, ndërsa masa të tjera mbeten ende të mundshme, por nuk janë vërtetuar plotësisht në studimet klinike. Njohuritë dhe praktikat infermierore janë tepër të rëndësishme në menaxhimin e tyre.

**Qëllimi:** Identifikimi i protokolleve dhe praktikave në lidhje me kujdesin e plagëve operatore pas lindjes. Roli i infermierit në menaxhimin e tyre dhe asistenca e ofruar prej tij.

**Metodologjia:** Është bërë një studim i kujdesshëm i literaturës përmes PUBMED, duke përdorur si fjalë kyçe: *"caesarean wound"* dhe *"nurse"* dhe *"infection"*. Pasi janë analizuar abstraktet dhe titujt e studimeve të identifikuara, është bërë një vlerësim i përmbajtjes së artikujve të përfshirë në studim.

**Rezultate:** Infermieri luan një rol të rëndësishëm në kujdesin e plagëve post-operatore në lindjet cezariane. Disa strategji për të reduktuar ndjeshëm shfaqjen e tyre mund të përfshijnë: përdorimin e antibiotikëve; higjienën dhe sterilizimin maksimal; njohjen, identifikimin dhe menaxhimin e faktorëve të riskut si dhe ndjekjen e kujdesshme postoperatore.

**Konkluzione:** Reduktimi i infeksioneve të plagëve kirurgjikale pas lindjes cezariane është thelbësor për përmirësimin e shëndetit të nënës dhe reduktimin e ndërlikimeve postoperatore. Zbatimi i praktikave të bazuara në prova shkencore, të tilla si përdorimi i duhur i antibiotikëve, teknikat strikte të sterilizimit dhe kujdesi adekuat pas operacionit, kanë treguar një ulje të ndjeshme të rrezikut të infeksionit. Për më tepër, edukimi i stafit mjekësor dhe informimi i pacienteve për higjienën dhe ndjekjen e duhur të rekomandimeve pas operacionit janë masa kyçe për të minimizuar ndërlikimet dhe për të siguruar një rikuperim të shpejtë dhe të sigurt.

***Fjalë kyçe:*** *lindje cezariane, plagë operatore, kujdes infermieror*

# POST-OPERATIVE WOUND CARE AFTER BIRTH

**ELVIRA QOSJA [1], ADRIAN BETI [2]**

[1] *"Xhaferr Kongoli" Regional Hospital, Elbasan*

Corresponding author*:* *Elvira.Qosja@uniel.edu.al*

**Introduction:** Cesarean section is the most common surgical procedure in obstetrics-gynecology wards and wound site infection constitutes a serious complication for the mother. Some important advances in preventive measures have shown effectiveness in reducing the risk of infection, while other measures still remain possible, but have not been fully proven in clinical studies. Nursing knowledge and practices are extremely important in their management.

**Aim:** To identify protocols and practices related to the care of postoperative wounds after childbirth. The role of the nurse in their management and the assistance provided by him.

**Methodology:** A careful literature search was conducted through PUBMED, using the keywords: "caesarean wound" and "nurse" and "infection". After analyzing the abstracts and titles of the identified studies, an assessment of the content of the articles included in the study was made.

**Results:** The nurse plays an important role in the care of postoperative wounds in cesarean deliveries. Some strategies to significantly reduce their occurrence may include: the use of antibiotics; maximum hygiene and sterilization; recognition, identification and management of risk factors as well as careful postoperative follow-up.

**Conclusions**: Reducing surgical wound infections after cesarean delivery is essential for improving maternal health and reducing postoperative complications. The implementation of evidence-based practices, such as the appropriate use of antibiotics, strict sterilization techniques and adequate postoperative care, have been shown to significantly reduce the risk of infection. Furthermore, educating medical staff and informing patients about hygiene and proper follow-up of postoperative recommendations are key measures to minimize complications and ensure a quick and safe recovery.

**Keywords:** *cesarean section, surgical wound, nursing care*

# ROLI I MAMIVE NË EDUKIMIN E GRAVE PËR NJË USHQYERJE TË SHËNDETSHME GJATË SHTATZANISË

**ALMA IMAMI ⁻ LELÇAJ [1], ALKETA DERVISHI [2], MIRANDA ÇELA [3]**

[1]*Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë Tiranë*

**Hyrje:** Ushqyerja adekuate gjatë shtatzanisë ndikon pozitivisht në shëndetin maternal dhe fetal, ndërsa kequshqyerja mund të sjellë pasoja serioze. Një dietë e ekuilibruar ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve të komplikacioneve obstetrike, ndërkohë që mungesa e ushqyesve esencialë mund të çojë në lindje të parakohshme, pesha e ulët e lindjes apo probleme shëndetësore për nënën dhe foshnjën. Edukimi i grave për ushqyerjen e shëndetshme është një ndër strategjitë kryesore për të përmirësuar mirëqenien e tyre dhe të foshnjës. Mamitë kanë një rol të rëndësishëm në këtë proces duke dhënë këshilla dhe udhëzime të personalizuara mbi nevojat ushqimore gjatë shtatzanisë.

**Qëllimi:** Ky studim synon të evidentojë rëndësinë e rolit të mamive në edukimin e grave për ushqyerjen e shëndetshme gjatë shtatzanisë dhe të identifikojë sfidat që ato hasin në këtë proces. Gjithashtu, synohet të propozohet rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i mbështetjes institucionale për të forcuar këtë aspekt të kujdesit shëndetësor prenatal.

**Metodologjia:** Studimi është bazuar në rishikimin e literaturës shkencore të publikuar në platformat si PubMed, Medline dhe Google Scholar. Janë analizuar të dhëna mbi ndikimin e mamive në edukimin ushqimor të grave shtatzëna dhe nevojën për trajnime të vazhdueshme. Janë shqyrtuar studime që theksojnë efektivitetin e programeve edukative për përmirësimin e zakoneve ushqimore gjatë shtatzanisë.

**Rezultatet:** Mamitë ndihmojnë në vlerësimin e statusit ushqimor të grave dhe ofrojnë këshillim për një dietë të shëndetshme. Ato luajnë një rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e një diete të balancuar, të pasur me proteina, vitamina dhe minerale thelbësore. Megjithatë, sfidat kryesore përfshijnë mungesën e burimeve edukative, ndikimin e besimeve tradicionale dhe mungesën e trajnimeve të specializuara për mamitë. Përmirësimi i programeve të edukimit dhe mbështetja institucionale janë të domosdoshm e për të kapërcyer këto sfida.

**Konkluzione:** Për të rritur efektivitetin e edukimit të grave për ushqyerjen gjatë shtatzanisë, nevojiten trajnime të vazhdueshme për mamitë dhe integrimi i informacioneve të përditësuara në praktikat klinike. Institucionet shëndetësore duhet të mbështesin më shumë këtë aspekt për të siguruar një shëndet optimal për gratë dhe foshnjat. Rritja e ndërgjegjësimit, krijimi i materialeve informuese dhe bashkëpunimi me dietologë dhe specialistë të ushqyerjes do të ndihmojë në përmirësimin e situatës aktuale.

**Fjalë kyçe:** *edukim, ushqyerje, mami, shtatzani, shëndet fetal, kujdes prenatal.*

# THE ROLE OF MIDWIVES IN EDUCATING WOMEN ON HEALTHY NUTRITION DURING PREGNANCY

**ALMA IMAMI – LELÇAJ [1], ALKETA DERVISHI [2], MIRANDA ÇELA [3]**

[1]*Faculty of Medical and Technical Sciences, University of Medicine, Tirana*

**Introduction:** Adequate nutrition during pregnancy positively affects maternal and fetal health, while malnutrition can have serious consequences. A balanced diet helps reduce the risks of obstetric complications, while the lack of essential nutrients can lead to premature birth, low birth weight or health problems for the mother and baby. Educating women on healthy nutrition is one of the main strategies to improve their well-being and that of the baby. Midwives have an important role in this process by providing personalized advice and guidance on nutritional needs during pregnancy.

**Purpose:** This study aims to highlight the importance of the role of midwives in educating women about healthy nutrition during pregnancy and to identify the challenges they face in this process. It also aims to propose increasing awareness and improving institutional support to strengthen this aspect of prenatal health care.

**Methodology:** The study is based on a review of scientific literature published on platforms such as PubMed, Medline and Google Scholar. Data on the impact of midwives on the nutrition education of pregnant women and the need for continuous training were analyzed. Studies that highlight the effectiveness of educational programs for improving eating habits during pregnancy were reviewed.

**Results:** Midwives help assess the nutritional status of women and provide advice on a healthy diet. They play a key role in raising awareness about the importance of a balanced diet, rich in proteins, vitamins and essential minerals. However, the main challenges include the lack of educational resources, the influence of traditional beliefs, and the lack of specialized training for midwives. Improving education programs and institutional support are necessary to overcome these challenges.

**Conclusions:** To increase the effectiveness of educating women about nutrition during pregnancy, continuous training for midwives and the integration of updated information into clinical practices are needed. Health institutions should support this aspect more to ensure optimal health for women and infants. Raising awareness, creating information materials, and collaborating with dietitians and nutrition specialists will help improve the current situation.

**Keywords:** *education, nutrition, midwife, pregnancy, fetal health, prenatal care.*

# NJOHJA E FIGURËS PROFESIONALE TË MAMISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

**BLERINA DUKA**[1]

[1]*Presidente e Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë*

**Hyrje:**Roli i mamisë përfshin vlerësimin, parandalimin, ndihmën gjatë lindjes dhe kujdesin pas lindjes për të siguruar mirëqenien e nënës dhe foshnjës. Në Republikën e Shqipërisë, ky profesion është i rregulluar me ligj dhe standarde profesionale, por sfidat në zbatimin praktik të kompetencave të mamisë mbeten ende të pranishme. Pavarësisht progresit në njohjen e rëndësisë së mamive, faktorë si mungesa e edukimit të vazhdueshëm, kushtet e punës dhe ndërgjegjësimi i ulët i publikut ndikojnë në fuqizimin e këtij profesioni. Ky studim shqyrton rëndësinë e njohjes së figurës profesionale të mamisë në Shqipëri, duke analizuar sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e këtij sektori.

**Qëllimi:** Ky studim synon të analizojë statusin profesional të mamisë në Shqipëri, duke shqyrtuar sfidat dhe mundësitë për forcimin e këtij profesioni. Gjithashtu, shqyrton rolin e mamisë në sistemin shëndetësor dhe ndikimin e saj në përmirësimin e shëndetit të nënës dhe foshnjës.

**Metodologjia**: Studimi bazohet në një qasje cilësore dhe sasiore, duke përfshirë:Analizën e dokumenteve ligjore dhe rregullatore që përcaktojnë rolin dhe përgjegjësitë e mamisë.Anketimin e profesionistëve të mamisë mbi perceptimin e tyre për njohjen dhe sfidat profesionale.Rishikimin e literaturës mbi praktikat më të mira në vendet evropiane dhe krahasimin me situatën në Shqipëri.

**Rezultatet:** Gjetjet e studimit tregojnë se, ndonëse roli i mamisë është i përcaktuar qartë në kuadrin ligjor, zbatimi i plotë i kompetencave të saj ende përballet me sfida. Këto përfshijnë mungesën e edukimit të vazhdueshëm, njohjen e kufizuar të rolit të mamisë nga publiku dhe nevojën për përmirësime në kushtet e punës. Përvoja ndërkombëtare sugjeron se fuqizimi i mamisë sjell përmirësime të ndjeshme në shëndetin perinatal dhe reduktimin e komplikacioneve gjatë lindjes.

**Konkluzionet:** Rritja e investimeve në edukimin dhe zhvillimin profesional të mamisë, përmirësimi i kushteve të punës dhe rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e këtij profesioni janë hapa kyç për përmirësimin e kujdesit shëndetësor amtar në Shqipëri.

**Fjalë kyçe:** *Mamia, kujdesi perinatal, shëndeti i nënës dhe foshnjës, profesionet shëndetësore, sistemi shëndetësor.*

# RECOGNITION OF THE PROFESSIONAL FIGURE OF MIDWIFERY IN THE REPUBLIC OF ALBANIA

**BLERINA DUKA** [1]

[1] *President of the Order of Nurses of Albania*

**Introduction:** Midwifery is a key profession in the healthcare system, providing specialized services for pregnant women, childbirth and the postpartum period. The role of midwifery includes assessment, prevention, assistance during childbirth and post-natal care to ensure the well-being of the mother and baby. In the Republic of Albania, this profession is regulated by law and professional standards, but challenges in the practical implementation of midwifery competencies still remain present. Despite progress in recognizing the importance of midwives, factors such as the lack of continuing education, working conditions and low public awareness affect the empowerment of this profession. This study examines the importance of recognizing the professional figure of midwifery in Albania, analyzing the challenges and opportunities for improving this sector.

**Purpose:** This study aims to analyze the professional status of midwives in Albania, examining the challenges and opportunities for strengthening this profession. It also examines the role of midwives in the health system and its impact on improving maternal and infant health.

**Methodology:** The study is based on a qualitative and quantitative approach, including analysis of legal and regulatory documents that define the role and responsibilities of midwives. Survey of midwifery professionals on their perception of professional recognition and challenges. Literature review on best practices in European countries and comparison with the situation in Albania.

**Results:** The study findings show that, although the role of midwives is clearly defined in the legal framework, the full implementation of their competencies still faces challenges. These include the lack of continuing education, limited public recognition of the role of midwives, and the need for improvements in working conditions. International experience suggests that empowering midwives leads to significant improvements in perinatal health and reduced complications during childbirth.

**Conclusions:** Increasing investment in midwifery education and professional development, improving working conditions, and raising awareness of the importance of this profession are key steps to improving maternal health care in Albania.

**Keywords:** *Midwifery, perinatal care, maternal and infant health, health professions, health system.*

# KARCINOMA MAMARE: NJË SHQYRTIMI LITERATURËS DHE CASE REPORT.

**FILE BRACJA[1], LUIZA LUSHI[2], SVETLLANA BITINCKA [3]**

[1]*Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë Tiranë*
[2]*Fakulteti Shkencave Mjekësore, Universiteti Europian i Tiranës*
[3]*Mjeke Infeksioniste, Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University*

**Hyrje:** Kanceri i gjirit është një sëmundje malinje e karakterizuar nga rritja e pakontrolluar e qelizave në indin e gjirit.Edhe pse kjo patologji prek të dy gjinitë, femrat janë më të predispozuara. Kanceri i gjirit është një ndër shkaqet kryesore të vdekshmërisë tek gratë në mbarë botën, ndërsa diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi i duhur mund të përmirësojnë ndjeshëm prognozën dhe cilësinë e jetës së pacientëve.

**Qëllimi:** Ky studim synon të analizojë shpeshtësinë, ashpërsinë, kujdesin dhe menaxhimin e karcinomës mamare në Spitalin Rajonal "Xhaferr Kongoli" në Elbasan gjatë vitit 2023. Gjithashtu, synohet të vlerësohet ndikimi i faktoreve të rrezikut, si dhe rëndësia e depistimit të hershëm në përmirësimin e rezultateve të trajtimit.

**Metodologjia:** Ky studim bazohet në të dhënat e mbledhura nga pacientët e trajtuar në kujdesin paliativ të spitalit gjatë vitit 2023. Në total, kanë marrë trajtim 1299 pacientë, nga të cilët 551 ishin të diagnostikuar me kancer të gjirit, përkatësisht 549 femra dhe 2 meshkuj. Janë analizuar faktorët demografikë, historia mjekësore dhe trajtimet e marra. Gjithashtu, përfshihet një rast klinik që ilustron sfidat dhe strategjitë e trajtimit të kësaj patologjie.

**Rezultatet:** Analiza e të dhënave tregoi se një përqindje e konsiderueshme e pacientëve të diagnostikuar ishin në stade të avancuara të sëmundjes, duke reflektuar mungesën e depistimit të hershëm dhe nivelin e ulët të ndërgjegjësimit shëndetësor. Pacientët me diagnozë të hershme kishin prognozë më të mirë dhe përgjigje më efektive ndaj trajtimit. Faktori kryesor që ndikoi në vonesën e diagnostikimit ishte mungesa e edukimit shëndetësor dhe aksesit në shërbimet mjekësore.

**Përfundime:** Rezultatet e studimit theksojnë rëndësinë e depistimit të hershëm dhe promocionit shëndetësor për të përmirësuar diagnostikimin dhe trajtimin e karcinomës mamare. Gjithashtu, niveli i arsimimit luan një rol kyç, pasi mungesa e informacionit të saktë ndikon në kulturën shëndetësore dhe çon në vonesë në evidentimin e faktorëve të rrezikut. Prandaj, nevojiten fushata të vazhdueshme ndërgjegjësuese për të reduktuar barrën e sëmundjes, si dhe politika të përmirësuara për akses më të lehtë në shërbimet mjekësore dhe ekzaminimet parandaluese.

**Fjalë kyçe:** *karcinoma mamare, depistim, promocion shëndetësor, diagnostikim i hershëm.*

# BREAST CANCER: A LITERATURE REVIEW AND CASE REPORT.

**FILE BRACJA [1], LUIZA LUSHI [2], SVETLLANA BITINCKA [3]**

[1]*Faculty of Medical and Technical Sciences, University of Tirana*
[2]*Faculty of Medical Sciences, European University of Tirana*
[3]*Infectious Disease Physician, Lecturer, Faculty of Medical Sciences, Albanian University.*

**Introduction:** Breast cancer is a malignant disease characterized by the uncontrolled growth of cells in the breast tissue. Although this pathology affects both sexes, women are more predisposed. Breast cancer is one of the leading causes of mortality in women worldwide, while early diagnosis and appropriate treatment can significantly improve the prognosis and quality of life of patients.

**Purpose:** This study aims to analyze the frequency, severity, care and management of breast carcinoma at the "Xhaferr Kongoli" Regional Hospital in Elbasan during 2023. It also aims to assess the impact of risk factors, as well as the importance of early screening in improving treatment outcomes.

**Methodology:** This study is based on data collected from patients treated in the hospital's palliative care during 2023. In total, 1299 patients received treatment, of whom 551 were diagnosed with breast cancer, respectively 549 women and 2 men. Demographic factors, medical history and treatments received were analyzed. A clinical case is also included that illustrates the challenges and treatment strategies of this pathology.

**Results:** Data analysis showed that a significant percentage of diagnosed patients were in advanced stages of the disease, reflecting the lack of early screening and low level of health awareness. Patients with early diagnosis had a better prognosis and more effective response to treatment. The main factor that influenced the delay in diagnosis was the lack of health education and access to medical services.

**Conclusions:** The results of the study emphasize the importance of early screening and health promotion to improve the diagnosis and treatment of breast cancer. Also, the level of education plays a key role, as the lack of accurate information affects the health culture and leads to delays in identifying risk factors. Therefore, continuous awareness campaigns are needed to reduce the burden of the disease, as well as improved policies for easier access to medical services and preventive examinations.

**Keywords:** *breast cancer, screening, health promotion, early diagnosis.*

# MENAXHIMI I USHQYERJES ORO/NAZOGASTRIKE TE NEONATI PREMATUR NË KUJDESIN INTENSIV

**ARJONA RAKIPI[1], BLERINA DUKA[2]**

[1]*Specialiste edukimit ne vazhdim prane Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë*
[2]*Presidente e Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë*

**Hyrje:** Një nga më të rëndësishmet është ushqyerja midis shumë vështirësive që kanë të porsalindurit e parakohshëm në përshtatjen me ekzistencën jashtë uterine. Ushqyerja oro/nazogastrike është një teknikë jetike në kujdesin intensiv neonatal për të garantuar mbështetjen e nevojshme ushqyese për rritjen dhe zhvillimin më të mirë të këtyre foshnjave. Minimizimi i problemeve dhe rritja e rezultateve klinike varen nga menaxhimi i duhur i kësaj qasjeje. Infermierët luajnë një rol kryesor në vendosjen, monitorimin dhe mirëmbajtjen e tubave të ushqimit, duke siguruar sigurinë dhe efikasitetin në njësitë e kujdesit intensiv neonatal (NICU).

**Qëllimi**: Nëpërmjet një analize të faktorëve që ndikojnë në suksesin e të ushqyerit, si dhe avantazheve dhe rreziqeve të mundshme, ky studim synon të hulumtojë strategjitë më efikase për kontrollin e ushqyerjes oro/nazogastrike tek të porsalindurit preterm në kujdesin intensiv.

**Metodologjia**: Një rishikim sistematik i literaturës u krye duke analizuar studimet e publikuara në pesë vitet e fundit mbi ushqyerjen oro/nazogastrike tek neonatët prematurë. Burimet e të dhënave përfshinë databaza shkencore si PubMed, Scopus dhe Cochrane Library. Artikujt u vlerësuan mbi bazën e kritereve të cilësisë dhe rëndësisë klinike.

**Rezultatet** treguan se përdorimi i një tubi nazogastrik për të ushqyer me gji ka një sërë përfitimesh mbi formulat artificiale, duke përfshirë promovimin e pjekurisë gastrointestinale dhe uljen e rrezikut të enterokolitit nekrotizues. Për më tepër, një kohë më e shkurtër për ushqimin e plotë enteral dhe toleranca e shtuar ndaj të ushqyerit janë lidhur me fillimin e hershëm të ushqyerjes enterale. Efikasiteti i përgjithshëm i menaxhimit të të ushqyerit te të porsalindurit e parakohshëm përmirësohet më tej duke trajnuar në mënyrë të përshtatshme profesionistët e kujdesit shëndetësor në teknikat e të ushqyerit dhe përditësimi me protokollet e fundit .

**Konkluzione**: Përdorimi i ushqyerjes oro/nazogastrike, ndjekja e udhëzimeve të të ushqyerit dhe vëzhgimi i ngushtë i gjërave janë të gjitha vendimtare për uljen e komplikimeve dhe përmirësimin e rezultateve klinike. Për më tepër, suksesi i të ushqyerit të këtyre foshnjave varet shumë nga kujdesi multidisiplinar dhe edukimi i prindërve.

**Fjalët kyçe:** *menaxhimi i ushqyerjes, ushqyerja oro/nazogastrike, neonat prematur, kujdesi intensiv*

# MANAGEMENT OF ORO/NASOGASTRIC FEEDING IN PRETERM NEONATES IN INTENSIVE CARE

**ARJONA RAKIPI[1], BLERINA DUKA[2]**

[1] *Continuing Education Specialist, Order of Nurses of Albania*

[2] *President, Order of Nurses of Albania*

**Introduction**: One of the most critical challenges preterm neonates face in adapting to extrauterine life is nutrition. Oro/nasogastric feeding is a vital technique in neonatal intensive care to ensure the necessary nutritional support for optimal growth and development. Minimizing complications and improving clinical outcomes depend on the proper management of this approach. Nurses play a key role in placing, monitoring, and maintaining feeding tubes, ensuring safety and efficiency in neonatal intensive care units (NICUs).

**Objective**: By analyzing variables influencing feeding success, as well as potential advantages and risks, this study aims to explore the most effective strategies for managing oro/nasogastric feeding in preterm neonates in intensive care.

**Methodology**: A systematic review of the literature was conducted, analyzing studies published in the last five years on oro/nasogastric feeding in preterm neonates. Data sources included scientific databases such as PubMed, Scopus, and Cochrane Library. Articles were evaluated based on quality and clinical relevance criteria.

**Results**: Findings indicated that using a nasogastric tube for breast milk feeding offers several benefits over artificial formulas, including promoting gastrointestinal maturity and reducing the risk of necrotizing enterocolitis. Additionally, early initiation of enteral feeding has been associated with shorter time to full enteral nutrition and improved feeding tolerance. Proper training of healthcare professionals in feeding techniques and adherence to updated protocols further enhance overall feeding management effectiveness in preterm neonates.

**Conclusions**: A personalized, evidence-based strategy is required for managing oro/nasogastric feeding in preterm neonates. The use of breast milk, adherence to feeding guidelines, and close monitoring are all crucial for reducing complications and improving clinical outcomes. Moreover, the success of feeding these infants heavily relies on multidisciplinary care and parental education.

**Keywords**: *Feeding management, oro/nasogastric feeding, preterm neonate, intensive care*

# LINDJA NATYRALE DHE AVANTAZHET E SAJ PËR NËNËN DHE FËMIJËN

**NINA NASAFUGA[1]**

[1]*Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik " Koço Gliozheni"*

**Hyrje:** Lindja natyrale është një proces fiziologjik kompleks, në të cilin trupi i gruas përgatitet për të sjellë në jetë foshnjën pa ndërhyrje mjekësore të panevojshme. Kjo metodë e lindjes është vlerësuar për përfitimet e saj të shumta si për nënën, ashtu edhe për foshnjën. Studimet tregojnë se gratë që kalojnë nëpër një lindje natyrale kanë një rikuperim më të shpejtë, më pak rrezik për komplikime dhe një eksperiencë më të kënaqshme në krahasim me ato që i nënshtrohen ndërhyrjeve mjekësore siç është operacioni cezarian (Smith et al., 2020).
**Qëllimi:** Qëllimi i këtij punimi është të kuptohet rëndësia e lindjes natyrale, si një proces lindjeje sa më i natyrshëm dhe i shëndetshëm për nënën dhe foshnjën.
**Metodologjia:** Kërkimet kanë treguar se foshnjat e lindura në mënyrë natyrale ekspozohen ndaj mikrobiomës së shëndetshme të nënës gjatë kalimit nëpër kanalin e lindjes, çka ndihmon në zhvillimin e sistemit të tyre imunitar duke reduktuar incidencen e semundjeve autoimune dhe alergjike gjate jetes (Dominguez-Bello et al., 2016). Edukimi prenatal, teknikat e menaxhimit të dhimbjes, si frymëmarrja dhe meditimi, si dhe prania e një mbështetjeje emocionale dhe profesionale, mund të përmirësojnë përvojën e lindjes dhe të ndihmojnë gratë të ndihen më të sigurta dhe të fuqizuara gjatë këtij procesi (Bohren et al., 2017).
**Konkuzioni:** Ky prezantim do të analizojë përfitimet e lindjes natyrale duke u bazuar në kërkime shkencore dhe do të eksplorojë strategjitë që mund të ndihmojnë gratë të përballojnë sfidat e lindjes pa ndërhyrje të panevojshme. Gjithashtu, do të diskutohet ndikimi i politikave shëndetësore dhe qasjes ndaj lindjes natyrale në sistemet moderne të kujdesit mjekësor. Një aspekt i rëndësishëm i lindjes natyrale është roli i hormoneve. Gjatë procesit të lindjes, trupi i nënës çliron oksitocinë, hormon që jo vetëm ndihmon në stimulimin e kontraktimeve, por gjithashtu forcon lidhjen emocionale mes nënës dhe foshnjës (Buckley, 2015). Për më tepër, beta-endorfinat natyrale që lëshohen gjatë lindjes ndihmojnë në menaxhimin e dhimbjes dhe krijojnë një ndjenjë euforie pas lindjes.
**Fjalë kyçe:** *lindje natyrale, mbështetje natyrale dhe profesionale.*

# NATURAL BIRTH AND ITS ADVANTAGES FOR MOTHER AND CHILD

**NINA NASAFUGA**[1]

[1]*"Koco Gliozheni" Obstetric Gynecological University Hospital*

**Introduction**: Natural childbirth is a complex physiological process in which a woman's body prepares to deliver her baby without unnecessary medical intervention. This method of birth has been praised for its numerous benefits for both mother and baby. Studies show that women who undergo a natural birth have a faster recovery, less risk of complications, and a more satisfying experience compared to those who undergo medical interventions such as cesarean section (Smith et al., 2020).

**Purpose of the paper:** The purpose of this paper is to understand the importance of natural childbirth, as a birth process that is as natural and healthy as possible for mother and baby.

**Methodology:** Research has shown that babies born naturally are exposed to their mother's healthy microbiome during passage through the birth canal, which helps develop their immune system, reducing the incidence of autoimmune and allergic diseases later in life (Dominguez-Bello et al., 2016). Prenatal education, pain management techniques such as breathing and meditation, and the presence of emotional and professional support can improve the birth experience and help women feel more confident and empowered during this process (Bohren et al., 2017).

**Conclusion:** This presentation will analyze the benefits of natural childbirth based on scientific research and explore strategies that can help women cope with the challenges of childbirth without unnecessary interventions. The impact of health policies and approaches to natural childbirth on modern health care systems will also be discussed. An important aspect of natural childbirth is the role of hormones. During the birth process, the mother's body releases oxytocin, a hormone that not only helps stimulate contractions, but also strengthens the emotional bond between mother and baby (Buckley, 2015). In addition, the natural beta-endorphins released during labor help with pain management and create a sense of euphoria after birth.

**Keywords:** *natural birth, natural and professional support.*

# ROLI I MAMIVE NË TRAJTIMIN E URGJENCAVE MENJËHERË PAS LINDJES

**FJORIDA SENJA[1]**

*[1]Spitali Obstetrik-Gjinekologji"Koco Gliozheni",Tiranë*

**Hyrje:** Reanimimi neonatal është një ndërhyrje kritike që synon stabilizimin e të porsalindurve që përjetojnë probleme respiratore ose kardiake menjëherë pas lindjes. Mamitë, si kujdestare kryesore në dhomën e lindjes, luajnë një rol vendimtar në marrjen e masave jetëshpëtuese gjatë këtyre urgjencave.

**Metodologjia:** U përdor një qasje e metodave të përziera, duke kombinuar të dhënat sasiore nga anketat dhe njohuritë cilësore nga intervistat gjysmë të strukturuara. Studimi përfshinte 50 mami nga njësitë neonatale në të gjithë Shqipërinë, me të dhëna të mbledhura gjatë një periudhe gjashtëmujore. Pjesëmarrësit u vlerësuan mbi njohuritë e tyre për protokollet e reanimimit neonatal.

**Rezultatet:** Të dhënat raportuan se vetëm 60% e mamive demonstruan familjaritet me udhëzimet më të fundit të reanimimit neonatal. Intervistat theksuan rëndësinë e trajnimeve të rregullta dhe aksesin në udhëzimet e përditësuara për rritjen e besimit dhe kompetencës së mamive.

**Diskutime:** Mamitë janë një element kyç i ekipit shëndetësor për të siguruar që reanimimi neonatal të kryhet në mënyrë të menjëhershme dhe efektive pas lindjes. Në shumë raste, ato janë përgjegjëse për fillimin e procedurave të reanimimit para se të arrijë ekipi i mjekëve. Programet e trajnimit të strukturuara janë të një rëndësie të madhe për të siguruar që mamitë të kenë njohuri dhe aftësi të plota për të përballuar emergjencat neonatale. Trajnimi i bazuar në simulime dhe në përdorimin e protokolleve të përditësuara rrit ndjeshëm aftësinë e mamive për të bërë ndërhyrje të shpejta dhe efikase. Ky studim nënvizon se edukimi i vazhdueshëm është esencial për mbajtjen e një niveli të lartë të gatishmërisë dhe kompetencës. Përveç kësaj, është e rëndësishme që këto trajnime të integrohen në zhvillimin profesional rutinë të mamive, në mënyrë që ato të jenë gjithmonë të përgatitura për të përballuar emergjencat. Trajnimi i rregullt dhe përdorimi i protokolleve të standardizuara janë të domosdoshme për të siguruar rezultate më të mira për foshnjat dhe për të rritur besimin e stafit shëndetësor, duke i mundësuar atyre të reagojnë me efikasitet dhe profesionalizëm në situata të tensionuara.

***Fjalë kyçe:*** *reanimim neonatal, mami, protokollet e urgjencës, trajnim, kujdesi neonatal*

# THE ROLE OF MIDWIFERIES IN THE TREATMENT OF EMERGENCIES IMMEDIATELY AFTER BIRTH

**FJORIDA SENJA**[1]

[1]*Koco Gliozheni Obstetric-Gynecology Hospital, Tirana*

**Introduction:** Neonatal resuscitation is a critical intervention aimed at stabilizing newborns who experience respiratory or cardiac problems immediately after birth. Midwives, as primary caregivers in the delivery room, play a crucial role in taking life-saving measures during these emergencies.

**Methodology:** A mixed methods approach was used, combining quantitative data from surveys and qualitative insights from semi-structured interviews. The study included 50 midwives from neonatal units across Albania, with data collected over a six-month period. Participants were assessed on their knowledge of neonatal resuscitation protocols.

**Results:** The data reported that only 60% of midwives demonstrated familiarity with the latest neonatal resuscitation guidelines. Interviews highlighted the importance of regular training and access to updated guidelines to increase midwives' confidence and competence.

**Discussion:** Midwives are a key element of the health team in ensuring that neonatal resuscitation is performed promptly and effectively after birth. In many cases, they are responsible for initiating resuscitation procedures before the medical team arrives. Structured training programs are of great importance to ensure that midwives have the full knowledge and skills to deal with neonatal emergencies. Training based on simulations and the use of updated protocols significantly increases the ability of midwives to perform rapid and effective interventions. This study highlights that continuing education is essential to maintain a high level of readiness and competence. In addition, it is important that these training courses are integrated into the routine professional development of midwives, so that they are always prepared to deal with emergencies. Regular training and the use of standardized protocols are essential to ensure better outcomes for babies and to increase the confidence of health staff, enabling them to respond efficiently and professionally in tense situations.

**Keywords:** *neonatal resuscitation, midwifery, emergency protocols, training, neonatal care*

# ROLI I MAMIVE NË PROMOVIMIN E VAKSINIMIT TË GRAVE SHTATZËNA DHE FOSHNJAVE: NJË RISHIKIM LITERATURE I BAZUAR NË EVIDENCA

**ANDUELA VASO[1] , EDIONA KOLA[2]**

*[1]Urdhri i Infermierit Qarku Tiranë, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.*

*[2]Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.*

**Hyrje:** Në kohën që jetojmë me informacione që vijnë nga burime të shumta, diskutimi mbi sfidat dhe pengesat e vaksinimit është me shumë rëndësi. Roli i mamive në promovimin e vaksinimit është një temë shumë aktuale dhe e rëndësishme në fushën e shëndetit publik dhe kujdesit shëndetësor. Ky rishikim do të përqendrohet në mënyrat se si gratë shtatzëna dhe mamitë mund të ndikojnë në promovimin dhe shpërndarjen e informacionit lidhur me vaksinimin, si dhe në ndikimin që vaksinat kanë në shëndetin e grave shtatzëna dhe fëmijëve të tyre. Informacioni i pasaktë, frika nga efekte anësore, mungesa e besimit tek sistemet shëndetësore janë disa prej sfidave që po has shërbimi shëndetësor.

**Qëllimi** i këtij punimi është të analizohet literatura për të evidentuar rolin e mamive në promovimin e vaksinimit për gratë shtatzëna dhe foshnjat. Si dhe njohja e bazuar në evidence e disa ndërhyrjeve më të rëndësishmë për të promovuar vaksinimin.

**Metodologjia:** Për të arritur qëllimin, është përdorur një rishikim literaturor i bazuar në studime të ndryshme që shqyrtojnë rolin e mamive në promovimin e vaksinimit.

Metodologjia përfshin analizimin e strategjive të edukimit dhe komunikimit, bashkëpunimin ndërsektorial, dhe përdorimin e mediave për promovimin e vaksinimit.

**Rezultatet:** Rezultatet tregojnë se mamitë kanë një rol të rëndësishëm në edukimin e grave shtatzëna dhe ofrimin e informacionit të saktë dhe të kuptueshëm për vaksinimin. Përdorimi i klasave prenatale dhe bashkëpunimi me autoritetet shëndetësore dhe mediat janë strategji efikase për promovimin e vaksinimit. Mamitë ndihmojnë në thyerjen e miteve dhe besimeve të gabuara lidhur me vaksinat.

**Konkluzionet:** Mamitë luajnë një rol kyç në forcimin e shëndetit publik duke ofruar mbështetje dhe këshilla të personalizuara për gratë shtatzëna. Ndërhyrjet e bazuara në evidence, si edukimi dhe komunikimi i qartë, janë të nevojshme për të siguruar që gratë të marrin vendime të informuara për vaksinimin. Nevoja për mbështetje të mëtejshme dhe bashkëpunim ndërsektorial mbetet thelbësore për promovimin e vaksinimit.

***Fjalët kyce**: mamia, vaksinimi, edukimi, shëndeti publik.*

# THE ROLE OF MIDWIFERIES IN PROMOTING VACCINATION OF PREGNANT WOMEN AND INFANTS: AN EVIDENCE-BASED LITERATURE REVIEW

**ANDUELA VASO[1] , EDIONA KOLA[2]**

*[1]Tiranana County Nursing Order, Tirana Regional Directorate of the Health Care Services Operator.*
*[2]Tirana Regional Directorate of the Health Care Services Operator.*

**Introduction:** In an era where information comes from multiple sources, discussing the challenges and barriers to vaccination is of great importance. The role of midwives in promoting vaccination is a very current and important topic in the field of public health and healthcare. This review will focus on the ways in which pregnant women and midwives can influence the promotion and dissemination of information related to vaccination, as well as the impact that vaccines have on the health of pregnant women and their children. Inaccurate information, fear of side effects, lack of trust in health systems are some of the challenges facing the health service.
**The purpose** of this paper is to analyze the literature to identify the role of midwives in promoting vaccination for pregnant women and infants. As well as the evidence-based recognition of some of the most important interventions to promote vaccination.
**Methodology:** To achieve the goal, a literature review was used based on various studies examining the role of midwives in promoting vaccination.
The methodology includes analyzing education and communication strategies, intersectoral collaboration, and the use of media to promote vaccination.
**Results:** The results show that midwives have an important role in educating pregnant women and providing accurate and understandable information about vaccination. The use of prenatal classes and collaboration with health authorities and the media are effective strategies for promoting vaccination. Midwives help to dispel myths and misconceptions about vaccines.
**Conclusions:** Midwives play a key role in strengthening public health by providing personalized support and advice to pregnant women. Evidence-based interventions, such as education and clear communication, are needed to ensure that women make informed decisions about vaccination. The need for further support and intersectoral collaboration remains essential for promoting vaccination**.**
**Keywords:** *midwifery, vaccination, education, public health.*

# ROLI I KUJDESIT TË MAMIVE NË MBËSHTETJE TË USHQYERJES ME GJI PAS LINDJES

**ARJETA BAJRAKTARI[1]**

[1] *Infermiere pranë Qendrës Shëndetësore Postribë.*

**Hyrja:** Periudha postnatale është një fazë kyçe në zhvillimin dhe mirëqenien e nënës dhe foshnjës, kujdesi dhe mbështetja nga mamitë luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e ushqyerjes me gji. Edhe pse ushqyerja me gji njihet si metoda më e mirë për ushqyerjen e foshnjës, shumë gra hasin vështirësi në arritjen e qëllimeve të tyre. Mbështetja që ofrojnë mamitë për këtë, përfshin udhëzime të specializuara dhe mbështetje emocionale, që synojnë përmirësimin e aftësive të nënës dhe forcimin e besimit të saj në këtë proces. Është e rëndësishme që mbështetja të jetë e personalizuar, duke pasur parasysh faktorët individualë dhe nevojat specifike të gruas. Gjithashtu, mamitë duhet të ofrojnë mbështetje që tejkalon aspektet teknike të ushqyerjes, duke nxitur përvoja pozitive emocionale dhe forcimin e lidhjeve midis nënës dhe foshnjës.

**Metodologjia:** Ne kete studim është përdorur një metodë kualitative, me intervista semi-strukturuara me 20 gra që kanë lindur në gjashtë muajt e fundit dhe kanë marrë mbështetje për ushqyerjen me gji pas lindjes nga mamitë. Intervistat u përqendruan në shqyrtimin e përvojave të grave, sfidave dhe ndikimit të mbështetjes së mamive në suksesin e ushqyerjes me gji. Të dhënat janë analizuar përmes një analize tematike.

**Rezultatet:**

- Mbështetje Teknike dhe Emocionale: Mamitë ofruan mbështetje teknike për lidhjen dhe pozicionimin, si dhe mbështetje emocionale për t'i ndihmuar gratë të menaxhojnë dhimbjet dhe problemet gjatë ushqyerjes.
- Sfidat që Hasin Gratë: Kufizimet e kohës dhe përgjegjësitë e tjera i bënë disa gra të kenë vështirësi në ndjekjen e këshillave të dhëna nga mamitë.
- Ndikimi i Mbështetjes në Suksesin e Ushqyerjes me Gji: Gratë që morën mbështetje të vazhdueshme dhe të personalizuar nga mamitë kishin më shumë mundësi të kishin një përvojë pozitive dhe të arrinin objektivat e tyre.

**Përfundimet:** Kujdesi i mamive gjatë periudhës postnatale është një komponent kyç për suksesin e ushqyerjes me gji. Studimi thekson rëndësinë e një qasjeje të personalizuar dhe të vazhdueshme në ofrimin e mbështetjes për ushqyerjen me gji, e cila duhet të përfshijë jo vetëm aspektet teknike, por edhe emocionale dhe sociale.

**Fjalët Kyçe:** *ushqyerja me gji, kujdesi postnatal, mbështetje emocionale, mbështetje teknike, shëndeti i nënës.*

# THE ROLE OF MIDWIFERY CARE IN POSTNATAL BREASTFEEDING SUPPORT

**ARJETA BAJRAKTARI**[1]

[1]*Nurse at the Postribë Health Center.*

**Introduction:** The postpartum period is a crucial phase for the development and well-being of both the mother and baby, where the care and support provided by midwives play an important role in the breastfeeding process. Although breastfeeding is recognized as the optimal method for infant feeding, many women face challenges in achieving their exclusive breastfeeding goals. The support provided by midwives for breastfeeding includes specialized guidance and emotional support, aimed at improving the mother's skills and strengthening her confidence in the process. It is important that this support is personalized, taking into account the individual factors and specific needs of the woman. Additionally, midwives should offer support that goes beyond the technical aspects of positioning, encouraging positive emotional experiences and strengthening the bond between the mother and baby.

**Methodology:** This study used a qualitative approach, conducting semi-structured interviews with 20 women who gave birth within the last six months and received breastfeeding support from midwives during the postpartum period. The interviews are focused on exploring the women's experiences, challenges, and the impact of midwifery support on breastfeeding success. Data was analyzed through thematic analysis.

**Results:**

- Technical and Emotional Support: Midwives provided technical support on latch and positioning, as well as emotional support to help women manage pain and breastfeeding issues.
- Challenges Faced by Women: Time constraints and other responsibilities made it difficult for some women to follow the advice given by midwives.
- Impact of Support on Breastfeeding Success: Women who received continuous and personalized support from midwives were more likely to have a positive breastfeeding experience and achieve their exclusive breastfeeding goals.

**Conclusions:** Midwifery care during the postpartum period is a key component for successful breastfeeding. This study emphasizes the importance of a more personalized and continuous approach to breastfeeding support, which should encompass not only technical aspects but also emotional and social ones.

**Keywords:** *Breastfeeding, Midwives, Postnatal Care, Emotional Support, Technical Support, Maternal Health.*

# MENAXHIMI DHE TRAJTIMI I ANAFILAKSISË/SHOKUT ANAFILAKTIK NË GRUAN SHTATZËNË

**ELISABETA RISTA[1], SHPRESA MOLLA[1], DELANTINA MULLA[1], SHPRESA BICI[1]**

[1] *Presidente te Qarqeve, Urdhri Infermierit te Shqiperise*

**Hyrje:** Anafilaksia është një reaksion alergjik i rëndë, i cili mund të rezultojë fatal në mungesë të ndërhyrjes së menjëhershme. Tek gratë shtatzëna, kjo gjendje paraqet sfida të veçanta për shkak të ndryshimeve fiziologjike të shtatzënisë dhe ndikimit të mundshëm në fetusin. Njohja e hershme e simptomave, identifikimi i shkaktarëve dhe zbatimi i protokolleve të duhura të menaxhimit janë kritike për parandalimin e komplikacioneve.

**Objektivi:** Ky studim synon të analizojë shenjat dhe simptomat e anafilaksisë tek gratë shtatzëna, të identifikojë shkaktarët kryesorë dhe të përshkruajë strategjitë më të efektshme të menaxhimit dhe trajtimit të kësaj gjendjeje. Gjithashtu, qëllimi është të theksohet rëndësia e referimit në kohë në shërbimet e specializuara për reduktimin e rrezikut maternal dhe fetal.

**Metodologjia:** Ky studim bazohet në një rishikim të literaturës së publikuar në dekadën e fundit (2015-2025) mbi anafilaksinë në shtatzëni. Janë analizuar artikuj shkencorë, udhëzues klinikë dhe studime rastesh të publikuara në databaza të besueshme si PubMed, Scopus dhe Cochrane Library. Përzgjedhja e literaturës është bërë bazuar në rëndësinë klinike, metodologjinë dhe aplikueshmërinë e gjetjeve në praktikën obstetrike.

**Rezultatet:** Anafilaksia në shtatzëni ka një prezantim klinik të ndryshueshëm dhe mund të maskohet nga ndryshimet fiziologjike të shtatzënisë.

Administrimi i menjëhershëm i epinefrinës (0.3-0.5 mg IM) mbetet trajtimi i parë dhe më i rëndësishëm për parandalimin e përkeqësimit të simptomave.

Oksigjenoterapia dhe reanimimi me lëngje janë masa shtesë të domosdoshme për stabilizimin e pacientes.

Antihistaminikët dhe kortikosteroidet mund të ndihmojnë në reduktimin e simptomave të vonshme, por nuk zëvendësojnë epinefrinën.

Referimi i shpejtë në njësi të specializuara është kyç për monitorimin e mëtejshëm dhe menaxhimin e rrezikut për nënën dhe fetusin.

**Konkluzione:** Anafilaksia gjatë shtatzënisë është një emergjencë mjekësore e rrallë, por me rrezik të lartë. Njohja e hershme e simptomave dhe aplikimi i protokolleve të përshtatshme të trajtimit mund të shpëtojë jetën e nënës dhe fetusit. Është e domosdoshme që stafi shëndetësor të jetë i trajnuar për të menaxhuar këtë situatë në mënyrë efektive dhe të sigurojë një kujdes multidisiplinar për pacientet shtatzëna me histori alergjike ose rrezik të lartë për anafilaksi.

**Fjalë kyçe:** *shoku anafilaktik, shtatzënia, epinefrina, trajtimi emergjent.*

# MANAGEMENT AND TREATMENT OF ANAPHYLAXIS/ANAPHYLACTIC SHOCK IN PREGNANT WOMEN

**ELISABETA RISTA[1], SHPRESA MOLLA[1], DELANTINA MULLA[1], SHPRESA BICI[1]**

[1] *President of the Regions, Order of Nurses of Albania*

**Introduction:** Anaphylaxis is a severe allergic reaction that can be fatal without immediate intervention. In pregnant women, this condition presents unique challenges due to physiological changes during pregnancy and potential impacts on the fetus. Early recognition of symptoms, identification of triggers, and implementation of appropriate management protocols are critical to prevent complications.

**Objective:** This study aims to analyze the signs and symptoms of anaphylaxis in pregnant women, identify the primary triggers, and describe the most effective management and treatment strategies for this condition. Additionally, the goal is to emphasize the importance of timely referral to specialized services to reduce maternal and fetal risk.

**Methodology:** This study is based on a review of literature published in the past decade (2015-2025) regarding anaphylaxis in pregnancy. Scientific articles, clinical guidelines, and case studies published in reputable databases such as PubMed, Scopus, and the Cochrane Library were analyzed. The selection of literature was based on clinical relevance, methodology, and applicability of findings in obstetric practice.

**Results:** Anaphylaxis in pregnancy has a variable clinical presentation and can be masked by physiological changes of pregnancy.

Immediate administration of epinephrine (0.5 mg intramuscularly) remains the first and most important treatment to prevent symptom progression.

Oxygen therapy and fluid resuscitation are essential additional measures for stabilizing the patient.

Antihistamines and corticosteroids may help reduce late-phase symptoms but do not replace epinephrine.

Prompt referral to specialized units is key for further monitoring and risk management for both mother and fetus.

**Conclusions:** Anaphylaxis during pregnancy is a rare but high-risk medical emergency. Early recognition of symptoms and application of appropriate treatment protocols can save the lives of both mother and fetus. It is essential that healthcare staff are trained to manage this situation effectively and provide multidisciplinary care for pregnant patients with allergic histories or high risk for anaphylaxis.

**Keywords:** *anaphylactic shock, pregnancy, epinephrine, emergency treatment.*

# VLERËSIMI I NJOHURIVE PËR IST-TË TEK STUDENTËT E FAKULTETIT TË SHËNDETIT PUBLIK (FSHP) DHE FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE (FSHH)

**MAJLINDA RAKIPAJ[1], RUDINA CERÇIZAJ[2], FEROLINDA KODHELI, EMIRJONA KIÇAJ[4], NEADA CAKËRRI[5], DEONA TARAJ[6], ENTELA HAXHILLARI[7]**

*[1]Pedagoge Universiteti "Ismail Qemali Vlorë"*

**Hyrje:** Shërbimi infermieror është bazë mbi themelet e të cilit ndërtohet mjekësia moderne. Në ditët e sotme ky shërbim ka njohur rritje të vazhdueshme duke u bazuar si në përkujdesjet dhe shërbimin cilësor kundrejt të sëmurit, por edhe në percaktimin e qëllimeve dhe objektivave kryesor të tij. Infermierët janë operatorë që kryejnë me autonomi profesionale veprimtari të drejtpërdrejta në parandalimin, kurimin, mbrojtjen e shëndetit individual dhe kolektiv.

**Qëllimi:** Vlerësimi i nivelit të njohurive të studentëve të Fakultetit të Shkencave Humane dhe të atyre në Fakultetin e Shëndetit Publik me qëllim që të hedhim dritë mbi problematikat.

**Metodologjia:** Është një studim cross-sectional. Studimi u realizua në konviktin e universitetit të Vlorës. Në studim u thirrën 200 studentë.100 prej tyre ishin student të FSHP dhe 100 studentë të FSHH që plotësuan pyetësorin e vetadministruar.

**Rezultatet:** Në FSHH vetem 20% e studentëve kishin dijeni për IST më përpara, 80% jo. Në FSHP 94% e studentëve kishin dijeni rreth IST, 3% jo. Në lidhje me shkaqet e IST-ve studentët e FSHP-kanë njouri të mira. Rrugët e përhapjes së IST-ve studentët e të dy fakulteteve 100% FSHP dhe 81% FSHH kanë referuar marrëdhënie seksuale të pambrojtura dhe 99% FSHP dhe 66% FSHH kanë referuar përdorimi i të njëjtës shiringë. Të dy fakultet janë dakort që duhet të marin informacion mbi IST në shkolla.

**Konkluzionet:** Lidhur me njohuritë e studentëve në lidhje me IST siç janë: shkaqet, simptomat, komplikacionet dhe rrugët e përhapjes studentët e FSHH kanë shfaqur njohuri të mangëta, pra 80% referonin se nuk ishin ne djeni te IST. Studentët e FSHH lidhur me njohjen e sëmundjeve te IST-ve, 92% njihnin HIV-in dhe nje pjesë shume e vogel njihte semundjet e tjera. Lidhur me vendin e informimit studentët e FSHH ishin informuar 100% ne internet dhe 66% nga shokët.

**Rekomandimet:** Nga Fakulteti i Shëndetit Publik të ngrihen programe edukimi dhe promocioni në lidhje me ISTnë grupet e riskuara, pasi vetë studentët kanë pohuar se ata duan të informohen më tepër rreth IST-ve dhe duan që këto informacione t'i marrin në shkolla. Shtrirja e një lënde të veçantë në gjithë universitetin në lidhje me parandalimin e IST-ve.

**Fjalët kyçe:** *Studentet, IST, njohuri, qëndrime ndaj IST-ve.*

# ASSESSMENT OF KNOWLEDGE ABOUT STIS AMONG STUDENTS OF THE FACULTY OF PUBLIC HEALTH (FSHP) AND THE FACULTY OF HUMAN SCIENCES (FSHH)

**MAJLINDA RAKIPAJ[1], RUDINA CERÇIZAJ[2], FEROLINDA KODHELI[3], EMIRJONA KIÇAJ[4], NEADA CAKËRRI[5], DEONA TARAJ[6], ENTELA HAXHILLARI[7]**

*[1]Lecturer at University "Ismail Qemali Vlorë"*

**Introduction:** Nursing service is the basis on which modern medicine is built. Nowadays, this service has experienced continuous growth based on both quality care and service towards the sick, but also on the definition of its main goals and objectives. Nurses are operators who carry out direct activities in the prevention, treatment, and protection of individual and collective health with professional autonomy.

**Purpose:** To assess the level of knowledge of students at the Faculty of Humanities and those at the Faculty of Public Health in order to shed light on the issues.

**Methodology:** It is a cross-sectional study. The study was conducted in the dormitory of the University of Vlora. 200 students were invited to the study. 100 of them were students at the Faculty of Humanities and 100 students at the Faculty of Public Health who completed the self-administered questionnaire.

**Results:** At the Faculty of Public Health, only 20% of students had knowledge about STIs before, 80% did not. At the Faculty of Public Health, 94% of students had knowledge about STIs, 3% did not. Regarding the causes of STIs, the Faculty of Public Health students have good knowledge. Ways of STI transmission: 100% FSHP and 81% FSH students from both faculties reported unprotected sexual intercourse and 99% FSHP and 66% FSH reported using the same syringe. Both faculties agree that they should receive information on STIs in schools.

**Conclusions:** Regarding students' knowledge about STIs such as: causes, symptoms, complications and ways of transmission, FSH students showed insufficient knowledge, so 80% reported that they were not aware of STIs. Regarding the knowledge of STI diseases, FSH students knew 92% about HIV and a very small part knew about other diseases. Regarding the place of information, FSH students were informed 100% on the internet and 66% from friends.

**Recommendations:** The Faculty of Public Health should establish education and promotion programs regarding STIs in at-risk groups, as students themselves have stated that they want to be more informed about STIs and want this information to be provided in schools. The extension of a special course throughout the university regarding STI prevention.

**Keywords:** *Students, STIs, knowledge, attitudes towards STIs.*

# MONITORIZIMI FETAL I RITMIT KARDIAK: INTERPRETIMI GRAFIK I KARDIOTOKOGRAFISË (CTG)

**VANGJELI LICE[1] , BLERINA BRACELLARI[2]**

[1]*Kryeinfermiere , "Shtëpia e Lindjes", Korcë, Shqipëri*
[2]*Infermiere , "Shtëpia e Lindjes", Korcë, Shqipëri*

**Hyrje :** Monitorizimi fetal i ritmit kardiak është një komponent thelbësor i kujdesit prenatal dhe gjatë lindjes, duke siguruar të dhëna të vlefshme mbi mirëqenien fetale dhe duke ndihmuar në parandalimin e komplikacioneve obstetrikale. Vlerësimi i funksionit kardiovaskular të fetusit është një tregues kyç i oksigjenimit dhe statusit të tij hemodinamik, duke e bërë këtë një proces vendimtar për menaxhimin e shtatzënive me rrezik të lartë.Kardiotokografia (CTG) është një metodë jo invazive që përdoret gjerësisht për të regjistruar ritmin e zemrës së fetusit dhe kontraktimet uterine, duke mundësuar vlerësimin e statusit fetal dhe identifikimin e shenjave të stresit intrauterin. Ky ekzaminim ndihmon në diagnostikimin e hipoksisë, asfiksisë fetale dhe çrregullimeve të tjera që mund të ndikojnë në shëndetin e fetusit.

**Qëllimi** i këtij prezantimi është të shqyrtojë rëndësinë e përdorimit të CTG në monitorimin e fetuseve gjatë shtatzënisë dhe procesit të lindjes, duke analizuar mënyrat e interpretimit të grafikut për të identifikuar kushte normale dhe anormale. Njohuritë mbi variabilitetin e ritmit kardiak fetal, akcelerimet, decelerimet dhe modelet patologjike janë kyçe për të përcaktuar ndërhyrjet e nevojshme obstetrikale.

**Metodologjia** e prezantimit bazohet në rishikimin e literaturës shkencore dhe analizën e protokolleve të përdorimit të CTG në praktikat klinike bashkëkohore. Përmes një qasjeje të bazuar në evidenca, do të diskutohet roli i CTG në diagnostikimin e hipoksisë fetale, si dhe rëndësia e kombinimit të tij me testet shtesë për të rritur saktësinë diagnostikuese.

**Rezultatet** e studimeve tregojnë se përdorimi i duhur i CTG ka kontribuar në uljen e rrezikut të asfiksisë neonatale dhe komplikacioneve të lidhura me stresin intrauterin. Megjithatë, interpretimi subjektiv dhe numri i lartë i rezultateve false pozitive mbeten sfida të rëndësishme.

**Në përfundim**, CTG është një mjet i rëndësishëm për monitorizimin e ritmit kardiak fetal, por efektiviteti i tij varet nga interpretimi i saktë dhe përdorimi i kombinuar me strategji të tjera diagnostikuese. Përmirësimi i aftësive klinike në interpretimin e këtij ekzaminimi dhe zbatimi i protokolleve të standardizuara janë kyçe për përmirësimin e rezultateve obstetrikale.

**Fjalët kyçe:** *Kardiotokografia, ritmi kardiak fetal, monitorizimi prenatal, hipoksia fetale, menaxhimi obstetrikal.*

# FETAL HEART RATE MONITORING: GRAPHIC INTERPRETATION OF CARDIOTOCOGRAPHY (CTG)

**VANGJELI LICE [1], BLERINA BRACELLARI [2]**

[1]*Head Nurse, "Birth House", Korca, Albania*
[2]*Nurse, "Birth House", Korca, Albania*

**Introduction:** Fetal heart rate monitoring is an essential component of prenatal and perinatal care, providing valuable data on fetal well-being and helping to prevent obstetric complications. Assessment of fetal cardiovascular function is a key indicator of its oxygenation and hemodynamic status, making it a crucial process for the management of high-risk pregnancies. Cardiotocography (CTG) is a non-invasive method widely used to record fetal heart rate and uterine contractions, enabling assessment of fetal status and identification of signs of intrauterine stress. This examination helps in the diagnosis of hypoxia, fetal asphyxia and other disorders that may affect the health of the fetus.

**The purpose** of this presentation is to review the importance of using CTG in monitoring fetuses during pregnancy and the birth process, analyzing the ways of interpreting the graph to identify normal and abnormal conditions. Knowledge of fetal heart rate variability, accelerations, decelerations and pathological patterns are key to determining the necessary obstetric interventions.

**The methodology** of the presentation is based on a review of scientific literature and an analysis of the protocols for the use of CTG in contemporary clinical practices. Through an evidence-based approach, the role of CTG in the diagnosis of fetal hypoxia will be discussed, as well as the importance of combining it with additional tests to increase diagnostic accuracy.

**The results** of the studies show that the appropriate use of CTG has contributed to reducing the risk of neonatal asphyxia and complications related to intrauterine stress. However, subjective interpretation and a high number of false positive results remain significant challenges.

**In conclusion**, CTG is an important tool for monitoring fetal heart rate, but its effectiveness depends on accurate interpretation and use in combination with other diagnostic strategies. Improving clinical skills in interpreting this examination and implementing standardized protocols are key to improving obstetric outcomes.

**Keywords:** *Cardiotocography, fetal heart rate, prenatal monitoring, fetal hypoxia, obstetric management.*

# FIZIOTERAPIA MBESHTET MAMITE NE EDUKIMIN DHE MONITORIMIN E SHTATZENISE PROBLEMATIKE

**FATJON HAJDARI [1] , LORENC CILI [2]**

*[1.] Pedagog, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, FSHMT, Albanian University.*
*[2.] Infermier, Spitali Rajonal Berat*
*[3]. Alma Mater Europaea – University ECM, Maribor, Slloveni*

**Hyrja:** Shtatzënia problematike kërkon një qasje të kujdesshme multidisiplinare për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e nënës dhe foshnjës. Mamia luan një rol kyç në monitorimin dhe edukimin e grave shtatzëna, ndërsa fizioterapia ndihmon në menaxhimin e simptomave fizike dhe parandalimin e komplikacioneve. Ky studim analizon rolin e bashkëpunimit midis mamive dhe fizioterapistëve për të ofruar një kujdes më efektiv për shtatzënitë me rrezik.

**Objektivat:** Të identifikohen përfitimet e fizioterapisë në menaxhimin e shtatzënisë problematike.Të vlerësohet ndikimi i bashkëpunimit midis mamive dhe fizioterapistëve në kujdesin prenatal.Të propozohet një model bashkëpunimi për përmirësimin e edukimit dhe monitorimit të grave shtatzëna.

**Metodologjia:** Ky studim bazohet në një qasje cilësore dhe sasiore, duke përfshirë: Anketimin dhe intervistimin e mamive dhe fizioterapistëve që punojnë me gra shtatzëna. Studimin e rasteve të grave me shtatzëni problematike që kanë përfituar nga ndërhyrjet fizioterapeutike duke analizuar ndikimin e trajtimeve në përmirësimin e simptomave dhe uljen e komplikacioneve. Analizën e protokolleve ekzistuese për kujdesin multidisiplinar gjatë shtatzënisë problematike, si dhe identifikimin e mundësive për përmirësime në këtë fushë.Krahasimin e rezultateve midis grave që kanë marrë dhe atyre që nuk kanë marrë ndërhyrje fizioterapeutike, për të matur efektivitetin e metodave të përdorura.

**Rezultatet:** Të dhënat tregojnë se përfshirja e fizioterapistëve në kujdesin prenatal ndihmon në zvogëlimin e dhimbjeve të mesit dhe legenit, përmirësimin e qarkullimit të gjakut dhe reduktimin e stresit te gratë shtatzëna. Mamia, në bashkëpunim me fizioterapistin, arrin të ofrojë edukim të personalizuar mbi teknikat e relaksimit, ushtrimet dhe menaxhimin e simptomave të shtatzënisë problematike. Ky partneritet përmirëson cilësinë e kujdesit dhe ul rrezikun e komplikacioneve gjatë dhe pas shtatzënisë.

**Konkluzionet:** Bashkëpunimi midis mamisë dhe fizioterapistit është një element i rëndësishëm për përmirësimin e shëndetit të grave me shtatzëni problematike. Integrimi i praktikave fizioterapeutike në kujdesin obstetrik rrit efikasitetin e monitorimit dhe edukimit prenatal, duke ndihmuar në përgatitjen për një lindje më të sigurt dhe një rikuperim më të shpejtë. Rekomandohet forcimi i këtij bashkëpunimi përmes trajnimeve të përbashkëta dhe përfshirjes së fizioterapisë në protokollet e kujdesit prenatal.

**Fjalë kyçe**: *fizioterapia, mamia, shtatzënia problematike, bashkëpunimi ndërprofesional*

# PHYSIOTHERAPY SUPPORTS THE MIDWIFERY IN EDUCATION AND MONITORING OF PROBLEMOUS PREGNANCY

**FATJON HAJDARI [1], LORENC CILI [2]**

*[1.] Lecturer, Department of Nursing and Physiotherapy, FSHMT, Albanian University.*
*[2.] Nurse, Berat Regional Hospital*
*[3]. Alma Mater Europaea – University ECM, Maribor, Slovenia*

**Introduction:** Problematic pregnancy requires a careful multidisciplinary approach to ensure the health and well-being of the mother and baby. Midwives play a key role in monitoring and educating pregnant women, while physiotherapy helps in managing physical symptoms and preventing complications. This study analyzes the role of collaboration between midwives and physiotherapists to provide more effective care for high-risk pregnancies.
**Objectives:** To identify the benefits of physiotherapy in the management of problematic pregnancy. To assess the impact of collaboration between midwives and physiotherapists in prenatal care. To propose a collaboration model to improve the education and monitoring of pregnant women.
**Methodology:** This study is based on a qualitative and quantitative approach, including Surveying and interviewing midwives and physiotherapists working with pregnant women. Studying cases of women with problematic pregnancies who have benefited from physiotherapeutic interventions by analyzing the impact of treatments on improving symptoms and reducing complications. Analysis of existing protocols for multidisciplinary care during problematic pregnancy, as well as identifying opportunities for improvements in this area. Comparison of outcomes between women who have received and those who have not received physiotherapeutic interventions, to measure the effectiveness of the methods used.
**Results:** Data show that the involvement of physiotherapists in prenatal care helps to reduce low back and pelvic pain, improve blood circulation and reduce stress in pregnant women. The midwife, in collaboration with the physiotherapist, manages to provide personalized education on relaxation techniques, exercises and management of symptoms of problematic pregnancy. This partnership improves the quality of care and reduces the risk of complications during and after pregnancy.
**Conclusions:** Collaboration between midwives and physiotherapists is an important element for improving the health of women with problematic pregnancies. The integration of physiotherapeutic practices into obstetric care increases the efficiency of prenatal monitoring and education, helping to prepare for a safer birth and a faster recovery. It is recommended to strengthen this collaboration through joint training and the inclusion of physiotherapy in prenatal care protocols.
**Keywords:** *physiotherapy, midwifery, problematic pregnancy, interprofessional collaboration*

# VLERËSIMI FILLESTAR I NEONATIT

**JONIADA KALTHI[1]**

*[1]Spitali Amerikan 3, Kryeinfermiere në repartin Obsetrik Gjinekologji*

**Hyrje:** Vlerësimi fillestar i neonatit është një hap kritik në menaxhimin e shëndetit të porsalindurve, duke siguruar identifikimin e menjëhershëm të çdo problemi shëndetësor. Ky vlerësim përfshin kontrollin e menjëhershëm pas lindjes, duke përdorur parametrat kryesorë të vlerësimit si rezultati Apgar, vlerësimi fizik dhe stabiliteti hemodinamik i foshnjës. Një vlerësim i plotë dhe i saktë ndikon drejtpërdrejt në mbijetesën dhe zhvillimin e shëndetshëm të neonatit.

**Qëllimi:** Ky studim ka për qëllim të analizojë rëndësinë e vlerësimit fillestar të neonatit në parandalimin e komplikacioneve dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor neonatal. Gjithashtu, synon të evidentojë praktikat më të mira dhe sfidat që hasin profesionistët shëndetësorë në këtë proces.

**Metodologjia:** Studimi bazohet në një analizë sistematike të literaturës mbi vlerësimin e neonatit, duke përfshirë udhëzimet më të fundit nga organizatat ndërkombëtare dhe praktikat klinike më të mira. Për më tepër, janë shqyrtuar studime retrospektive dhe të dhëna nga neonatologët mbi ndikimin e vlerësimit të hershëm në rezultatet shëndetësore të porsalindurve.

**Diskutim:** Vlerësimi fillestar i neonatit përfshin vlerësimin e shenjave vitale, tonusit muskulor, ngjyrës së lëkurës dhe reflekseve të lindjes. Skorja Apgar përdoret për të vlerësuar shëndetin e përgjithshëm të foshnjës brenda minutave të para të jetës. Faktorë të tillë si prematuriteti, distres respirator dhe anomalitë kongjenitale kërkojnë identifikim të menjëhershëm për të filluar ndërhyrjet e duhura.

**Rezultatet:** Studimet tregojnë se një vlerësim i plotë dhe i saktë i neonatit zvogëlon ndjeshëm komplikacionet, përmirëson mbijetesën dhe ul rrezikun e problemeve afatgjata shëndetësore. Implementimi i protokolleve të standardizuara ka rezultuar në një përmirësim të cilësisë së kujdesit neonatal në nivel global.

**Përfundim:** Vlerësimi fillestar i neonatit është një komponent kyç në kujdesin shëndetësor perinatal dhe kërkon trajnime të vazhdueshme për profesionistët shëndetësorë. Përdorimi i metodave të avancuara të monitorimit dhe standardizimi i protokolleve mund të përmirësojnë më tej rezultatet e shëndetit neonatal.

**Fjalë kyçe:** *vlerësimi i neonatit, rezultati Apgar, kujdesi neonatal, prematuriteti, komplikacionet neonatale.*

# INITIAL ASSESSMENT OF THE NEONATE

**JONIADA KALTHI[1]**

*[1]American Hospital 3, Head Nurse in the Obstetrics and Gynecology Department*

**Introduction:** Initial assessment of the neonate is a critical step in the management of newborn health, ensuring the immediate identification of any health problems. This assessment includes immediate postnatal check-up, using key assessment parameters such as Apgar score, physical assessment and hemodynamic stability of the baby. A complete and accurate assessment directly affects the survival and healthy development of the neonate.

**Purpose:** This study aims to analyze the importance of initial assessment of the neonate in preventing complications and improving neonatal health care. It also aims to identify best practices and challenges faced by health professionals in this process.

**Methodology:** The study is based on a systematic review of the literature on neonatal assessment, including the latest guidelines from international organizations and best clinical practices. In addition, retrospective studies and data from neonatologists on the impact of early assessment on newborn health outcomes were reviewed.

**Discussion**: Initial assessment of the newborn includes assessment of vital signs, muscle tone, skin color, and birth reflexes. The Apgar score is used to assess the overall health of the infant within the first minutes of life. Factors such as prematurity, respiratory distress, and congenital anomalies require immediate identification to initiate appropriate interventions.

**Results:** Studies show that a complete and accurate assessment of the newborn significantly reduces complications, improves survival, and lowers the risk of long-term health problems. Implementation of standardized protocols has resulted in an improvement in the quality of neonatal care globally.

**Conclusion:** Initial assessment of the newborn is a key component of perinatal health care and requires ongoing training for health professionals. The use of advanced monitoring methods and standardization of protocols can further improve neonatal health outcomes.

**Keywords***: neonatal assessment, Apgar score, neonatal care, prematurity, neonatal complications.*

# GABIMET NË PROÇEDURAT INFERMIERORE

**VJOLLCA QATIPI[1], GENTJANA SHEMBITRAKU[1],**

[1]*Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë*

**Hyrje:** Gabimet në proçedurat infermierore janë një aspekt thelbësor në sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së kujdesit shëndetësor. Ato mund të ndodhin për shkak të një sërë faktorësh, duke përfshirë mungesën e edukimit dhe trajnimit të duhur, presionin e punës, stresin dhe njëkohësisht përdorimin e teknologjisë dhe pajisjeve të papërshtatshme. Këto gabime mund të kenë pasoja të rënda për pacientët, përfshirë ndërlikime shëndetësore, vonesa në trajtim dhe në raste ekstreme, vdekje.
**Qëllimi:** Të shqyrtojë shkaqet dhe llojet më të zakonshme të gabimeve që ndodhin gjatë proçedurave infermierore, si administrimi i gabuar i medikamenteve, përdorimi jo i duhur i pajisjeve mjekësore, mangësitë në komunikim, gabimet në kujdesin ndaj pacientit si dhe ndikimin e këtyre gabimeve tek pacientët, stafi infermieror dhe institucionet shëndetësore.
**Metodologjia:** Gabimet në procedurat infermierore janë një aspekt shumë i rëndësishëm në kujdesin shëndetësor, sepse ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e pacientëve dhe cilësinë e kujdesit që ofrohet. Gabimet mund të ndodhin për shkak të faktoreve të ndryshëm, përfshirë lodhjen, mungesën e trajnimit të duhur, ngarkesën e madhe të punës, komunikimin e dobët, ose mungesën e mbështetjes. Studimi i gabimeve në procedurat infermierore kërkon një qasje të shumëfishtë dhe përdorimin e metodologjive të ndryshme për të kuptuar më mirë shkaktarët, ndikimet dhe mundësitë për përmirësim. Këto metodologji ndihmojnë në identifikimin e mundësive për të përmirësuar cilësinë e kujdesit dhe për të reduktuar rrezikun e gabimeve që mund të ndikojnë në sigurinë e pacientëve.
**Konkluzione:** Ofrimi i strategjive për parandalimin e gabimeve, përfshirë rëndësinë e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm, përmirësimin e kushteve të punës dhe komunikimit, dhe implementimin e protokolleve të sigurisë. Synimi është që, përmes ndërgjegjësimit dhe veprimeve të drejtuara, të përmirësohet cilësia e kujdesit dhe të rritet siguria për pacientët, duke minimizuar mundësinë e gabimeve në proçedurat infermierore.
**Fjalë Kyçe**: *Gabimet në proçedurat infermierore , strategji për parandalimin e gabimeve, ndërgjegjësim dhe veprime te drejtuara, përmirësimi i cilësisë së kujdesit, siguria për pacientët.*

## ERRORS IN NURSING PROCEDURES

**VJOLLCA QATIPI[1], GENTJANA SHEMBITRAKU[1],**

[1]*Obstetrics and Gynecology University Hospital "Koço Gliozheni" Tirana*

**Introduction:** Errors in nursing procedures are a crucial aspect in ensuring the quality and safety of healthcare. They can occur due to a number of factors, including lack of proper education and training, work pressure, stress and the simultaneous use of inappropriate technology and equipment. These errors can have serious consequences for patients, including health complications, delays in treatment and in extreme cases, death.

**Purpose:** To examine the causes and most common types of errors that occur during nursing procedures, such as incorrect medication administration, inappropriate use of medical equipment, communication deficiencies, errors in patient care, and the impact of these errors on patients, nursing staff, and health institutions.

**Methodology:** Errors in nursing procedures are a very important aspect of health care, because they can directly affect patient safety and the quality of care provided. Errors can occur due to a variety of factors, including fatigue, lack of proper training, heavy workload, poor communication, or lack of support. The study of errors in nursing procedures requires a multifaceted approach and the use of different methodologies to better understand the causes, impacts, and opportunities for improvement. These methodologies help identify opportunities to improve the quality of care and reduce the risk of errors that can affect patient safety.

**Conclusions:** Providing strategies for error prevention, including the importance of ongoing education and training, improving working conditions and communication, and implementing safety protocols. The goal is to improve the quality of care and increase patient safety through awareness and targeted actions, minimizing the possibility of errors in nursing procedures.

**Keywords:** *Nursing procedure errors, error prevention strategies, awareness and directed actions, improving the quality of care, patient safety.*

# EVOLUCIONI I ROLIT TË MAMISE NË KUJDESIN GJATË SHTATËZANISË: RISITË GLOBALE DHE APLIKIMI I ATYRE NË SHQIPËRI PËR NJË SHTATËZANI MË TË SHËNDETSHME DHE TË SIGURTE

**MARINELA SEMA[1], ESTER HOTI[2]**

[1]*Mami SUOGJ" Mbretëresha Geraldinë",*
*semamarinela97@gmail.com,*
[2]*Mami SUOGJ" Mbretëresha Geraldinë" ,*
*esteri.hoti@icloud.com*

**Hyrje :** Roli i mamisë në kujdesin gjatë shtatëzanisë ka evoluar ndjeshëm në dekadat e fundit, duke kaluar nga një qasje tradicionale në një model gjithëpërfshirës të bazuar në prova shkencore. Në shumë vende, risitë teknologjike dhe qasjet e reja të kujdesit kanë përmirësuar ndjeshëm shëndetin e nënave dhe foshnjave. Shqipëria, megjithëse ka bërë përparime në këtë fushë, ende përballet me sfida në përmirësimin e shërbimeve të mamisë dhe përshtatjen me risitë globale. Ky studim analizon mënyrat se si risitë në kujdesin prenatal dhe postnatal mund të integrohen në sistemin shëndetësor shqiptar për të ofruar një shtatëzani më të sigurt dhe të shëndetshme.

**Objektivat:**Të shqyrtohet evolucioni i rolit të mamisë në kujdesin gjatë shtatëzanisë.
Të analizohen risitë më të fundit globale dhe ndikimi i tyre në kujdesin për nënat dhe foshnjat. Të identifikohen sfidat dhe mundësitë për aplikimin e këtyre risive në Shqipëri.Të propozohet një model i përmirësuar i shërbimeve të mamisë.

**Metodologjia:**Studimi është bazuar në një rishikim të literaturës shkencore mbi praktikat më të mira në kujdesin gjatë shtatëzanisë. Janë analizuar të dhëna mbi ndikimin e teknologjisë dhe qasjeve të reja në shëndetin e nënave dhe foshnjave. Gjithashtu, janë mbledhur opinione nga gra shtatezana dhe profesionistë të shëndetit në Shqipëri për të identifikuar sfidat dhe nevojat në këtë sektor dhe cfarë të bëjmë më mirë.

**Rezultatet:**Përdorimi i telemjekësisë dhe monitorimit dixhital të shtatëzanisë ka përmirësuar ndjeshëm kujdesin prenatal në shumë vende dhe mund të adoptohet në Shqipëri. Mbështetja psikologjike dhe edukimi i nënave për përgatitjen emocionale gjatë dhe pas shtatëzanisë ka një ndikim pozitiv në reduktimin e ankthit dhe depresionit post-partum.Rritja e trajnimeve për mamitë dhe fuqizimi i rolit të tyre në vendimmarrje mund të ndihmojë në përmirësimin e shërbimeve.

**Konkluzione:**Rezultatet sugjerojnë se integrimi i risive globale në kujdesin gjatë shtatëzanisë mund të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e shërbimeve në Shqipëri. Fuqizimi i mamisë përmes trajnimeve, përdorimi i teknologjisë dhe mbështetja psiko-sociale janë hapa kyç për të siguruar një kujdes më efektiv dhe të sigurt për nënat dhe foshnjat.

**Fjalë kyc:** *mamia, shtatëzania, risitë, kujdesi, shëndetësia*

# THE EVOLUTION OF THE ROLE OF THE MIDWIFE IN PREGNANCY CARE: GLOBAL INNOVATIONS AND THEIR APPLICATION IN ALBANIA FOR A HEALTHIER AND SAFER PREGNANCY

**MARINELA SEMA[1], ESTER HOTI[2]**

[1]*Mami SUOGJ" Mbretëresha Geraldinë",*
semamarinela97@gmail.com,
[2]*Mami SUOGJ" Mbretëresha Geraldinë",*
esteri.hoti@icloud.com

**Introduction:** The role of the midwife in prenatal care has evolved significantly in recent decades, moving from a traditional approach to a comprehensive model based on scientific evidence. In many countries, technological innovations and new approaches to care have significantly improved the health of mothers and babies. Albania, although it has made progress in this area, still faces challenges in improving midwifery services and adapting to global innovations. This study analyzes the ways in which innovations in prenatal and postnatal care can be integrated into the Albanian health system to provide a safer and healthier pregnancy.

**Objectives:** To review the evolution of the role of midwifery in prenatal care.

To analyze the latest global innovations and their impact on maternal and newborn care. To identify challenges and opportunities for the application of these innovations in Albania. To propose an improved model of midwifery services.

**Methodology:** The study is based on a review of scientific literature on best practices in prenatal care. Data on the impact of technology and new approaches on maternal and newborn health were analyzed. In addition, opinions were collected from pregnant women and health professionals in Albania to identify challenges and needs in this sector and what can be done better.

**Results:** The use of telemedicine and digital pregnancy monitoring has significantly improved prenatal care in many countries and can be adopted in Albania. Psychological support and education of mothers for emotional preparation during and after pregnancy has a positive impact on reducing anxiety and post-partum depression. Increasing training for midwives and strengthening their role in decision-making can help improve services.

**Conclusions:** The results suggest that integrating global innovations in prenatal care can significantly improve the quality of services in Albania. Empowering midwives through training, the use of technology and psychosocial support are key steps to ensure more effective and safe care for mothers and babies.

**Keywords:** *Midwifery, Pregnancy, Innovations, Care, Health*

# ROLI INFERMIEROR NË TEKNOLOGJINË E RIPRODHIMIT TË ASISTUAR

**VALBONA LICI [1], DENISA KOÇI [1]**

[1]*Shërbimi i Gjinekologjisë, Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë*

**Hyrje:** Në proçedurën e fekondimit të asistuar infermierët luajnë një rol kritik dhe vendimtar në mbështetjen e trajtimit të fertilitetit, për të gjitha çiftet që i nënshtrohen kesaj proçedure. Ata jo vetëm që shërbejnë si pika kryesore e kontaktit që ndihmojnë në koordinimin midis mjekëve, embriologëve dhe pacientëve por gjithashtu ofrojnë një edukim gjithëpërfshirës në aplikimin e medikamenteve të stimulimit, duke siguruar që pacientët të kuptojnë çdo hap të udhëtimit të tyre.
**Qëllimi:** Të kuptohet ndikimi i asistencës infermierore në riprodhimin e asistuar.
**Metodologjia:** Studimi është praktik, nëpërmjet analizave statistikore dhe tematike, duke arritur në një konkluzion përfundimtar.
**Rezultate:** Riprodhimi i asistuar është një grup teknologjish dhe procedurash mjekësore të cilat përdoren për të ndihmuar çiftet ose individët që kanë vështirësi për të konceptuar një fëmijë natyrshëm. Këto teknologji mund të përfshijnë një gamë të gjerë procedurash, nga stimulimi i ovulacionit deri te fertilizimi in vitro (IVF), dhe përdoren kur ndodhin probleme me fertilitetin që pengojnë konceptimin e natyrshëm. Teknologjia e riprodhimit të asistuar ka përparuar ndjeshëm gjatë dekadave të fundit. Përmirësimi i teknikave të fertilizimit in vitro dhe rritja e disponueshmërisë së teknologjive si kulturimi i embrioneve dhe testet gjenetike për embrionet kanë bërë që shumë më tepër gra të kenë mundësi të realizojnë ëndrrën për të pasur një fëmijë. Në një kohë tepër sfiduese për të gjitha çiftet që marrin këtë shërbim, infermierët i ndihmojnë të marrin informacionin e duhur për efektet anësore të mundshme që procedura mund të ketë, aplikimin e medikamenteve në mënyrë korrekte, protokollet e stimulimit dhe transfertës embrionale, atë çfarë pritet gjatë proçesit, gjë që është e rëndësishme në menaxhimin e pritjeve dhe koordinimin e orareve me pacientët. Përtej përgjegjësive klinike, infermierët gjithashtu krijojnë një mjedis empatik dhe mbështetës, duke ofruar një suport tepër të madh psikologjik për pacientët, si dhe i ndihmojnë në lehtësimin e stresit psikologjik dhe ankthit me të cilin përballen.
**Fjalët kyçe:** *asistenca infermierore, trajtimi i fertilitetit, informimi i pacientit, mbështetje emocionale, teknologji riprodhuese e asistuar (ART), monitorimi i proçedurave, pajtueshmëria e pacientit, kujdesi holistik, aftësitë e komunikimit.*

# THE NURSING ROLE IN ASSISTED REPRODUCTIVE TECHNOLOGY

**VALBONA LICI [1], DENISA KOÇI [1]**

[1]*Gynecology Service, Obstetrics and Gynecology University Hospital "Koço Gliozheni" Tirana*

**Introduction:** In the assisted fertilization procedure, nurses play a critical and decisive role in supporting fertility treatment, for all couples undergoing this procedure. They not only serve as the main point of contact that helps in the coordination between doctors, embryologists and patients but also provide a comprehensive education in the application of stimulation medications, ensuring that patients understand every step of their journey. Furthermore, they offer their assistance in monitoring the progress of the treatment and performing procedures, such as ultrasound or medication administration, ensuring that patients receive the maximum care tailored to their needs.
**Purpose of the study:** To understand the impact of nursing assistance on assisted reproduction.
**Methodology:** The study is practical, through statistical and thematic analyses, reaching a final conclusion.
**Results:** Assisted reproduction is a group of medical technologies and procedures that are used to help couples or individuals who have difficulty conceiving a child naturally. These technologies can include a wide range of procedures, from ovulation stimulation to in vitro fertilization (IVF), and are used when fertility problems occur that prevent natural conception. Assisted reproductive technology has advanced significantly over the past few decades. Improved in vitro fertilization techniques and the increased availability of technologies such as embryo culture and genetic testing of embryos have made it possible for many more women to realize the dream of having a child. At a very challenging time for all couples receiving this service, nurses help them get the right information about the possible side effects that the procedure may have, the correct application of medications, stimulation and embryo transfer protocols, what to expect during the process, which is important in managing expectations and coordinating schedules with patients. Beyond clinical responsibilities, nurses also create an empathetic and supportive environment, providing a great deal of psychological support to patients, as well as helping them to alleviate the psychological stress and anxiety they face.
They are responsible for ensuring that patients understand the various ART procedures, including hormonal stimulation, egg implantation, embryo implantation and other techniques.
**Keywords:** *nursing care, fertility treatment, patient information, emotional support, assisted reproductive technology (ART), monitoring of procedures, patient compliance, holistic care, communication skills.*

# ABDOMINOPLASTIKA PAS LINDJES CEZARIANE: PËRVOJA E PACIENTËVE DHE ROLI I INFERMIERËVE NË RIKUPERIM

**MARIO GOLEMI[1], ENIS ZORBA[2]**

[1]*Infermier instrumentar ne spitalin jo publik*

[2]*Mjeke në departamentin mjekësi dhe kirurgji në spitalin jo publik*

**Hyrje**: Abdominoplastika është një ndërhyrje kirurgjikale e cila po fiton popullaritet në mesin e grave që kanë kaluar lindje cezariane. Pas shtatzënisë, shumë gra përballen me diastazë të muskujve të barkut dhe lëkurë të varur, të cilat jo vetëm që ndikojnë në aspektin estetik, por mund të shkaktojnë dhe probleme funksionale si dhimbje mesi dhe ulje të cilësisë së jetës. Ky studim ka për qëllim të analizojë përvojën e pacientëve që kanë kryer abdominoplastikë pas lindjes cezariane dhe të vlerësojë rolin e infermierëve në menaxhimin e dhimbjes dhe kujdesin postoperativ.

**Metodologjia**: Një studim retrospektiv u krye në një spital jo publik duke përfshirë 50 paciente që iu nënshtruan abdominoplastikës pas lindjes cezariane gjatë vitit 2024. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori me 13 pyetje, i cili përfshinte të dhëna demografike, arsyet e ndërhyrjes, llojin e operacionit, komplikacionet postoperatore dhe kënaqësinë me kujdesin infermieror. Analiza e të dhënave u realizua me programin SPSS, duke përdorur statistika përshkruese dhe analizë të shpërndarjes së përqindjeve.

**Rezultatet:** 60% e pacienteve ishin në grupmoshën 36-45 vjeç, ndërsa 20% ishin mbi 45 vjeç. 70% e pacienteve kishin kaluar mbi 3 vite pas lindjes cezariane para se të kryenin operacionin. Arsyet kryesore për operacionin ishin lëkura e varur (70%) dhe diastaza e muskujve të barkut (30%).

90% e pacienteve ishin të kënaqura me kujdesin infermieror dhe menaxhimin e dhimbjes.

87% e pacienteve do ta rekomandonin operacionin për të tjerët.

**Konkluzione:** Studimi tregoi se shumica e grave që kryejnë abdominoplastikë pas lindjes cezariane kërkojnë përmirësim estetik dhe funksional. Roli i infermierëve është vendimtar në sigurinë dhe komoditetin e pacienteve gjatë periudhës së rikuperimit. Rezultatet tregojnë nevojën për qasje të integruar infermierore, duke përfshirë menaxhimin e dhimbjes, monitorimin e shenjave të komplikacioneve, dhe mbështetje psikologjike për një rikuperim më të shpejtë dhe më efektiv.

**Fjalë kyçe:** *Abdominoplastikë, lindje cezariane, diastaza abdominale, rikuperimi postoperativ, kujdes infermieror.*

# ABDOMINOPLASTY AFTER CESAREAN DELIVERY: PATIENTS' EXPERIENCE AND THE ROLE OF NURSES IN RECOVERY

**MARIO GOLEMI[1], ENIS ZORBA[2]**

[1]*Instrumental nurse in a non-public hospital*

[2]*Doctor in the department of medicine and surgery in a non-public hospital*

**Introduction:** Abdominoplasty is a surgical procedure that is gaining popularity among women who have undergone cesarean delivery. After pregnancy, many women experience abdominal muscle diastasis and excess skin, which not only affect aesthetics but can also lead to functional problems such as lower back pain and decreased quality of life. This study aims to analyze the experience of patients who have undergone abdominoplasty after cesarean delivery and assess the role of nurses in pain management and postoperative care.

**Methodology:** A retrospective study was conducted in a non-public hospital, including 50 patients who underwent abdominoplasty after the cesarean section in 2024. The data were collected through a 13-question questionnaire, which included demographic data, reasons for the intervention, type of surgery, postoperative complications, and satisfaction with nursing care. Data analysis was performed using the SPSS program, employing descriptive statistics and percentage distribution analysis.

**Results:** 60% of patients were in the age group 36-45 years, while 20% were over 45 years.
70% of patients had undergone surgery more than 3 years after their cesarean delivery.
The primary reasons for surgery were excess skin (70%) and abdominal muscle diastasis (30%). 90% of patients were satisfied with nursing care and pain management.
87% of patients would recommend the surgery to others.

**Conclusions:** The study showed that most women undergoing abdominoplasty after cesarean delivery seek both aesthetic and functional improvements. The role of nurses is crucial in ensuring patient safety and comfort during the recovery period. The findings highlight the need for an integrated nursing approach, including pain management, monitoring for complications, and psychological support, to enhance recovery outcomes.

**Keywords:** *Abdominoplasty, cesarean section, abdominal diastasis, postoperative recovery, nursing care.*

# ROLI I EKOGRAFISË GJATË NDJEKJES SË SHTATZANISË

**ELONA DYBELI [1], ALKET COLLAKU [2], RUDINA DELIALLISI [3], ARMELA KAPAJ[1], ALBANA SULA [1], BRIKENA DUKA [1]**

[1] *Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan*
[2] *Spitali GVM, Tiranë*
[3] *Spitali Universitar i Traumës*
**Autori korrespondent:** elona.dybeli@uniel.edu.al

**Hyrje:** Diagnostika imazherike luan një rol thelbësor në vlerësimin e situatave të ndryshme mjekësore, sidomos gjatë shtatzanisë, ku bëhet i mundur një vlerësim periodik i saj. Ekografia dhe rezonanca magnetike janë dy teknikat imazherike të cilat mund të realizohen gjatë shtatzanisë, për shkak të avantazheve që ato kanë. Ekografia përbën modalitetin bazë të kujdesit para lindjes, duke ofruar një vlerësim të detajuar si për shëndetin e nënës ashtu edhe për zhvillimin e fetusit. Evolucioni teknologjik nga ekografia tradicionale në ekografinë morfologjike ka bërë të mundur rritjen e ndjeshme të precizionit diagnostik duke lejuar zbulimin e hershëm të defekteve dhe orientimin e vendimeve klinike.
**Metodologjia:** Është kryer një studim i kujdesshëm i literaturës përmes PubMed, Scopus dhe Google Scholar, duke përdorur si fjalë kyçe *"ekografi", "shtatzani", "ekografi morfologjike" dhe "fetus"*. U morën në konsideratë artikujt të dhjetë viteve të fundit.
**Rezultatet:** Ekografia konvencionale është thelbësore për monitorimin e rritjes së fetusit, matjen e niveleve të lëngut amniotik dhe evidentimin e anomalive të placentës.
Ekografia 3D ka përmirësuar paraqitjen e strukturave të fetusit, duke lejuar vlerësime më të sakta të tipareve kraniofaciale, zhvillimit të gjymtyrëve dhe anomalive të tjera. Ndërkohë, ekografia morfologjike, e cila zakonisht kryhet ndërmjet javës 18 dhe 22 të shtatzënisë, ofron një vlerësim sistematik të anatomisë së fetusit, duke ndihmuar në zbulimin e hershëm të defekteve kongenitale. Sipas studimeve, kombinimi i këtyre modaliteteve rrit besimin diagnostik dhe lejon ndërhyrje më efikase në shtatzënitë me risk të lartë.
**Konkluzione:** Integrimi i ekografisë 3D dhe asaj morfologjike në kujdesin prenatal përmirëson saktësinë e vlerësimeve të fetusit dhe kontribuon në rezultate më të mira të nënës dhe të porsalindurit. Përfshirja e tyre në protokollet rutinë në diagnostikën prenatale mund të rezultojë në zbulimin më të hershëm të anomalive, vendimmarrje më të informuar dhe kujdes të shtuar para lindjes.

***Fjalë kyçe:*** *ekografia prenatale, ekografia 3D, vlerësimi morfologjik, monitorimi i shtatzanisë*

# THE ROLE OF ULTRASOUND DURING PREGNANCY MONITORING

**ELONA DYBELI [1], ALKET COLLAKU [2], RUDINA DELIALLISI [3], ARMELA KAPAJ [1], ALBANA SULA [1], BRIKENA DUKA [1]**

[1] *Faculty of Technical Medical Sciences, "Aleksandër Xhuvani" University, Elbasan*
[2] *GVM Hospital, Tirana*
[3] *University Hospital of Trauma, Tirana*
Corresponding author: elona.dybeli@uniel.edu.al

**Introduction:** Imaging diagnostics plays a fundamental role in the evaluation of various medical situations, especially during pregnancy, where a periodic assessment of it becomes possible. Ultrasound and magnetic resonance are the two imaging techniques that can be performed during pregnancy, due to the advantages they have. Ultrasound constitutes the basic modality of prenatal care, providing a detailed assessment of both maternal health and fetal development. The technological evolution from traditional ultrasound to morphological ultrasound has enabled a significant increase in diagnostic precision, allowing early detection of defects and guiding clinical decisions.

**Methodology:** A careful literature review was conducted through PubMed, Scopus, and Google Scholar, using the keywords "ultrasound," "pregnancy," "morphological ultrasound," and "fetus." Articles from the last ten years have been taken into consideration.

**Results:** Conventional ultrasound is essential for monitoring fetal growth, measuring amniotic fluid levels, and detecting placental abnormalities. 3D ultrasound has improved the visualization of fetal structures, allowing more accurate assessments of craniofacial features, limb development, and other abnormalities. Meanwhile, morphological ultrasound, which is usually performed between 18 and 22 weeks of pregnancy, provides a systematic assessment of fetal anatomy, helping to detect congenital defects early. According to studies, the combination of these modalities increases diagnostic confidence and allows for more effective interventions in high-risk pregnancies.

**Conclusions:** Integrating 3D and morphological ultrasound in prenatal care improves the accuracy of fetal assessments and contributes to better maternal and newborn outcomes. Their inclusion in routine prenatal diagnostic protocols may result in earlier detection of anomalies, more informed decision-making, and enhanced prenatal care.

**Keywords**: *prenatal ultrasound, 3D ultrasound, morphological assessment, pregnancy monitoring*

# RËNDËSIA E KUJDESIT PARËSOR ANTENATAL NË PARANDALIMIN E KOMPLIKIMEVE TË SHTATZËNISË

**RINORA FETAHU[1]**

*[1]Studente mami, Viti 3, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*
*Email: rinorafetahu40@gmail.com*

**Hyrje:** Kujdesi parësor antenatal përfaqëson një nga elementët më të rëndësishëm të sistemit shëndetësor për gratë shtatzëna, duke luajtur një rol thelbësor në promovimin e shëndetit të nënës dhe foshnjës. Ai mundëson zbulimin dhe menaxhimin e hershëm të faktorëve të rrezikut dhe ndërlikimeve që mund të ndikojnë negativisht në rrjedhën e shtatzënisë dhe lindjes. Përmes monitorimit të rregullt, këshillimit dhe ndërhyrjeve të përshtatshme, kujdesi antenatal ndihmon në reduktimin e komplikimeve si hipertensioni gestacional, preeklampsia, diabeti gestacional dhe lindja e parakohshme.

**Objektivat:** Ky studim synon të vlerësojë efektet e ndjekjes së kujdesit të rregullt antenatal në parandalimin e ndërlikimeve të shtatzënisë, si dhe të nënvizojë rëndësinë e ndërhyrjes së hershme për përmirësimin e rezultateve obstetrike.

**Metodologjia:** Studimi përfshiu 500 gra shtatzëna të ndara në dy grupe: një grup mori kujdes të rregullt antenatal, ndërsa grupi tjetër nuk kishte ndjekje të strukturuar. Të dhënat u analizuan nëpërmjet metodave statistikore për të krahasuar incidencën e komplikimeve në të dy grupet.

**Rezultatet:** Rezultatet treguan një reduktim të ndjeshëm të ndërlikimeve tek gratë që morën kujdes të rregullt antenatal, krahasuar me ato që nuk e ndoqën atë në mënyrë të vazhdueshme. Gratë që kishin ndjekur vizitat prenatale në mënyrë të strukturuar dhe të rregullt kishin një incidencë më të ulët të komplikimeve si hipertensioni gestacional, preeklampsia, lindja e parakohshme dhe rritja e kufizuar intrauterine. Gjithashtu, këto gra raportuan nivele më të larta kënaqësie me përvojën e shtatzënisë dhe ndiheshin më të informuara dhe të përgatitura për lindjen dhe periudhën pas lindjes.

**Konkluzionet:** Kujdesi parësor antenatal është një komponent kyç dhe i pazëvendësueshëm në parandalimin e ndërlikimeve të shtatzënisë. Ndjekja e rregullt e vizitave prenatale jo vetëm që ndihmon në diagnostikimin dhe menaxhimin e hershëm të rreziqeve, por gjithashtu përmirëson ndjeshëm mirëqenien fizike dhe psikologjike të nënës. Ai kontribuon në një shtatzëni më të sigurt, rrit mundësinë për një lindje të suksesshme dhe ndihmon në sigurimin e një fillimi të shëndetshëm për foshnjën. Për këtë arsye, promovimi i aksesit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e kujdesit antenatal duhet të jetë një prioritet i sistemit shëndetësor dhe i politikave të shëndetit publik.

**Fjalë kyçe:** *Kujdesi antenatal, shtatzënia, ndërlikimet obstetrike, shëndeti i nënës, parandalimi.*

# THE IMPORTANCE OF PRIMARY ANTENATAL CARE IN THE PREVENTION OF PREGNANCY COMPLICATIONS

**RINORA FETAHU[1]**

[1] *Midwifery Student, 3rd Year, University of Medicine, Tirana*
*Email: rinorafetahu40@gmail.com*

**Introduction:** Primary antenatal care is one of the most essential components of the healthcare system for pregnant women, playing a key role in promoting maternal and fetal health. It enables early detection and management of risk factors and complications that can negatively impact the course of pregnancy and childbirth. Through regular monitoring, counseling, and appropriate interventions, antenatal care helps reduce complications such as gestational hypertension, preeclampsia, gestational diabetes, and preterm birth.
**Objectives:** This study aims to evaluate the effects of regular antenatal care follow-up in preventing pregnancy complications, as well as to emphasize the importance of early intervention for improving obstetric outcomes.
**Methodology:** The study included 500 pregnant women divided into two groups: one group received regular antenatal care, while the other did not follow a structured care plan. Data were analyzed using statistical methods to compare the incidence of complications between the two groups.
**Results:** The results showed a significant reduction in complications among women who received regular antenatal care compared to those who did not follow it consistently. Women who attended prenatal visits in a structured and regular manner had a lower incidence of complications such as gestational hypertension, preeclampsia, preterm birth, and intrauterine growth restriction. Additionally, these women reported higher levels of satisfaction with their pregnancy experience and felt more informed and prepared for childbirth and the postpartum period.
**Conclusions:** Primary antenatal care is a crucial and irreplaceable component in preventing pregnancy complications. Regular prenatal visits not only assist in the early diagnosis and management of risks but also significantly improve the physical and psychological well-being of the mother. It contributes to a safer pregnancy, increases the likelihood of successful delivery, and supports a healthy start for the newborn. Therefore, promoting access to and awareness of the importance of antenatal care should be a priority for the healthcare system and public health policies.
**Keywords:** *Antenatal care, pregnancy, obstetric complications, maternal health, prevention.*

# FALENDERIME

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë shpreh mirënjohjen dhe falënderimet më të sinqerta për të gjithë kontribuesit shkencorë, të cilët ndanë njohuritë dhe përvojat e tyre profesionale përmes abstrakteve të përfshira në këtë libër. Kontributi juaj është një vlerë e shtuar për përmbajtjen akademike dhe shkencore të këtij kongresi.

Një falënderim i veçantë i drejtohet lektorëve për prezantimet e tyre cilësore dhe frymëzuese, moderatorëve për drejtimin profesional të sesioneve dhe pjesëmarrësve për përfshirjen aktive, diskutimet e vlefshme dhe angazhimin në nxitjen e zhvillimit të profesionit të mamisë.

Vlerësim të veçantë meritojnë edhe institucionet bashkëpunuese dhe të gjitha strukturat që mbështetën në mënyrë profesionale dhe institucionale organizimin e këtij eventi.

Mirënjohje të thellë për ekipin organizativ dhe vullnetarët që, me përkushtim dhe përpjekje të vazhdueshme, siguruan mbarëvajtjen e çdo etape të këtij Kongresi, duke e kthyer atë në një ngjarje me vlera të larta akademike dhe njerëzore.

**BASHKË PËR ZHVILLIMIN E PROFESIONIT DHE CILËSINË E KUJDESIT!**